



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Komuna e Rahovecit**  
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*  
**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**




01 Nr. 01/19  
Rahovec, 18.01.2019

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më  
**28 Janar 2019 (e hënë)** me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

## REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Plotësim ndryshimit të Vendimit 01 Nr.1025 i datës 29.03.2018, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa,
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punë së Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2018,
5. Shqyrtimi i Informatës mbi Planin e punës të Kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2019,
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar i Komunës së Rahovecit për vitin 2018,
7. Shqyrtimi i Informatës të Plani vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm të KK- Rahovec,
8. Shqyrtimi i Planit të veprimit të Rekomandimeve për vitin 2018 nga auditori kombëtar ( të jashtëm) dhe,
9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2018.

  
**KRYESUESI I KUVENDIT**  
  
**Afrim Dina**




Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Komuna Rahovec*  
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës – Predsedin Opštine – Municipality Mayor

# PLANI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE



Rahovec , janar 2019

## PËRMBAJTJA

|                                                                     |    |
|---------------------------------------------------------------------|----|
| ZOTIMI IM NË FILLIM TË MANDATIT .....                               | 3  |
| NJËSITË NË KUADËR TË ZYRËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS .....            | 5  |
| DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME.....                     | 8  |
| DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE .....                | 10 |
| DREJTORIA PËR ARSIM .....                                           | 11 |
| DREJTORIA PËR FINANCË DHE BUXHET .....                              | 13 |
| DREJTORIA PËR EKONOMI ZHVILLIM DHE TURIZËM .....                    | 14 |
| DREJTORIA E URBANIZMIT, PLANIFIKIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT..... | 15 |
| DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË.....                     | 16 |
| DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE.....                                 | 17 |
| DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL .....            | 18 |
| DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE .....                                | 20 |
| DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT .....                         | 22 |
| DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM .....                            | 24 |
| PËRFUNDIM .....                                                     | 25 |

## ZOTIMI IM NË FILLIM TË MANDATIT

Në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, komuna e Rahovecit ka hartuar planin vjetor të punës duke u bazuar në prioritetet strategjike dhe të nevojave të adresuara nga qytetarët e komunës sonë.

**“Krijimi i kushteve më të mira për investime në ekonomi, kthimi i hapësirave nga menaxhimi i APK (Agjencioni Pyjor i Kosovës) në menaxhim nga Komuna, bujqësi e zhvilluar, infrastrukturë të rregulluar, përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies sociale, edukim, arsimim dhe shërbime të cilësisë së lartë për qytetarët tanë”**

## Synime për vitin 2019

- Përmbyllja e ciklit të investimeve në ujësjellës dhe investime në trajtimin e ujërave të zeza
- Investime më të mëdha në bujqësi, në kullimin e tokave bujqësore dhe rritja e përkrahjes direkte për fermerët
- Rugët fushore
- Funksionalitet më i madh i rrjetit të shërbimeve shëndetësore dhe kohëzgjatje e shërbimeve
- Investime në projekte që nxisin zhvillimin e turizmit
- Shtimi i hapësirave të gjelbëruara dhe mirëmbajtja e tyre
- Investime më të mëdha në arsim, kulturë, rini dhe në sport
- Ndërtimi i çerdheve për fëmijë
- Mbrojtje sistematike e mjedisit
- Ndërtimi i parkingjeve të reja, rrugëve, trotuareve, shesheve etj.
- Sinjalizim më i mirë i rrugëve dhe projekte për ndriçimin publik
- Investime në përgatitjen dhe aftësimin e Zonës Ekonomike
- Investime në trashëgimi kulturore dhe historike, restaurime, ndërtimi i muzeve etj.
- Investime në trajtimin dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe përrenjve
- Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe lirimi i trotuareve, pronave e objekteve komunale të uzurpuara
- Plani i veprimit për rritjen e të hyrave komunale
- Plani i veprimit për inkasimin e tatimit në tokë
- Plani i veprimit të KKS-së
- Plani i punës së Kuvendit Komunal
- Plani për transparencë komunale
- Plani i veprimit antikorrupsion
- Plani i prokurimit
- Plani i auditimit të brendshëm
- Plani për menaxhim të mbeturinave dhe për heqjen e deponive ilegale
- Subvencionim më i madh i OJQ-ve, kategorive të caktuara të shoqërisë dhe i veprimtarive të ndryshme komunale
- Vlerësimi strategjik mjedisor, një plan që duhet të aprovohet për Zonën Ekonomike

- Projekte strategjike me fizibilitet, kolektorët, impiantet, rrugët (traseja e autostradës), ujitja e tokave bujqësore, pendat, etj
- Projekte me partneritet publiko-privat
- Mbikëqyrje aktive dhe rritje e cilësisë në investimet publike
- Hartimi i planeve, nxjerrja e akteve dhe rregulloreve të tjera të punës.

#### Prioritetet kryesore për vitin 2019

- Komunë me institucione funksionale, e hapur për qytetarët dhe në shërbim të tyre
- Komunë me performancë të mirë dhe qeverisje demokratike
- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne
- Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarrje pa vonesë
- Organizim më i mirë i punës dhe efikasitet i plotë i administratës komunale
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit
- Realizim i planit të të hyrave komunale
- Zbatimi i planit antikorrupsion
- Bashkëpunim funksional dhe i frytshëm me Qeverinë e Kosovës
- Bashkëpunim i mirë me donatorët e jashtëm
- Komunikim dhe bashkëpunim me OJQ-të
- Bashkëpunim dhe përkrahje për bizneset
- Përgatitja dhe aftësimi i Zonës Ekonomike
- Rritje e përkrahjes financiare nga Qeveria e Kosovës
- Rritje të përkrahjes për bujqësinë dhe për fermerët
- Këshillime me fermerë dhe hartim të projekteve për aplikime të suksesshme
- Komunikimi dhe debati me qytetarët si dhe me grupet e interesit
- Përmirësimi i gjendjes së ujërave të zeza dhe trajtimi i problemeve me ujërat atmosferikë
- Furnizim me ujë të pijshëm
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese
- Mirëmbajtje e hapësirave publike, krijimi i hapësirave të reja për parkingje, mirëmbajtja e rrugëve dhe ndërtimi shesheve dhe rrugicave
- Investime në ndriçimin publik
- Funksionalizim më i madh, rritje e cilësisë dhe kohëzgjatje e shërbimeve nga ana e QKMF-së
- Vizita sistematike shëndetësore nëpër të gjitha shkollat
- Nxitje të investimeve dhe projekteve në turizëm
- Trotuare dhe shtigje të ecjes për këmbësorë e biciklistë
- Rritje e përkrahjes për bujqësinë dhe rritje e përkrahjes direkte për fermerët
- Projekte për kullimin e tokave bujqësore
- Rritje e cilësisë dhe investime në arsim
- Bursa për studentë
- Investime në nyjat sanitare dhe meremetim të shkollave
- Ndërtimi i shkollave të reja
- Eficienca e energjisë në objektet shkollore dhe në objektet e tjera publike
- Hartimi i PZHK-së dhe Hartës Zonale
- Mbrojtje aktive e mjedisit
- Trajtimi i shtretërve të lumenjve dhe përrenjve
- Mirëmbajtja e hapësirave ekzistuese të gjelbëruara dhe krijimi i hapësirave të reja gjelbëruese
- Rritja e rolit dhe shtimi i aktiviteteve të inspektoratit

- Terrene të reja sportive dhe përkrahje sportit
- Aktivitete të planifikuara me të rinjtë
- Përkrahje nismave për më shumë aktivitete kulturore
- Investime në trashëgimi kulturore, si dhe përkrahje aktiviteteve e përkujdesje ndaj figurave kombëtare, objekteve dhe të pozicioneve që kanë të bëjnë me ngjarjet e rëndësishme historike
- Përballje serioze dhe me efikasitet të lartë me çfarëdo situatë që ka të bëjë me emergjencat.

## NJËSITË NË KUADËR TË ZYRËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS

Në kuadër të zyrës së kryetarit të komunës funksionojnë këto njësi:

- Zyra Ligjore,
- Zyra e burimeve njerëzore
- Zyra e prokurimit,
- Zyra për përfaqësim ligjor,
- Zyra për komunikim me publikun
- Zyra e auditim të brendshëm

### Zyra Ligjore

Zyra ligjore e Komunës së Rahovecit është zyrë që sipas Statutit të Komunës me Nr.1005 të dt. 29.03.2017 Nenit 82 bën pjesë në kuadër të zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit, e cila sipas kompetencës së përcaktuar me rregullativën në fuqi ka këto kompetenca:

Plani i Punës së Zyrës Ligjore të Komunës së Rahovecit është dokument i mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, dhe aktet tjera nënligjore.

Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike, i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti dhe aktet tjera nënligjore.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2019, ku Zyra ligjore në Komunën e Rahovecit planifikon:

- Ofrimin e këshillave juridike të rregullta për organet komunale dhe trupave të formuara nga organet komunale, Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal, drejtorët e drejtorive, komiteteve të përhershme dhe konsultative, zyrës së Prokurimit, komisioneve etj.)
- Harton (përpilon) vendime, aktvendime, pëlqime, urdhëresa, memorandume mirëkuptimi, kontrata, marrëveshje, leje pune, leje ndërtimi dhe shkresa të tjera për organet komunale dhe trupat e formuar nga organet komunale.
- Hartimin e Rregullores për realizimin e të drejtave të fëmijëve
- Pjesëmarrjen në komisionet e ndryshme të formuara nga Kryetari i Komunës për çështjet e caktuara.
- Hartimin e rregulloreve sipas kërkesës së drejtorive
- Pjesëmarrje të rregullt në seancat e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

### **Zyra e burimeve njerëzore - personeli**

Njësia e Personelit në kuadër të kompetencave të saj, për periudhën deri në fund të vitit 2019, ka për synim të arrij këto objektiva programore:

- Mbajtjen e nivelit të efektivitetit të shërbimeve të Njesisë së Personelit.
- Implementimin e ndryshimeve të reja ligjore në fushën e resurseve njerëzore .
- Implementimi dhe familjarizimin e punëtorëve dhe menaxhmentit me programin SIMBNJ.
- Monitorimin e prezencës së punëtorëve në punë
- Përkujdesjen për pajisjen e punëtorëve me kartela identifikimi
- Menaxhimi efikas me arkivin e Njesisë së personelit

### **Aktivitetet**

- Mbajtja e ritmit të efektivitetit të punës së Njesisë së personelit në ofrimin e shërbimeve
- Përkujdesja dhe mbështetja administrative komisioneve që prekin resurset njerëzore
- Përcjellja e ligjeve dhe akteve ligjore që prekin resurset njerëzore
- Përdorimi i dokumenteve dhe procedurave standarde të shërbimit civil sipas programit SIMBNJ
- Ofrimi i ndihmës në përdorimin e programit SIMBNJ për punëtorët dhe menaxhmentin
- Azhurnimi i të dhënave në programin SIMBNJ
- Përcjellja e respektimit të orarit të punës së punëtorëve përmes programit elektronikë –SMVP dhe raportimit
- Shkarkimi nga programi PYROLL i listës së pagave dhe pagesave në formë elektronike dhe dërgimi i tyre tek zyrtarët kompetent
- Krijimi i dosjeve pasive, sistemimi i dosjeve si dhe ruajtja e tyre.

### **Zyra e prokurimit**

Plani i punës së zyrës së prokurimit është i ndikuar nga planet e punës së drejtorive komunale. Përmes këtij plani synim i zyrës së prokurimit është që të kryej të gjitha veprimet me kohë, pa vonesa duke u bazuar në planifikimet e drejtorive komunale për projektet kapitale dhe në pajtim me ligjin e prokurimit publik.

### **Zyra për përfaqësime ligjore - avokatura**

Avokati i Komunës konform dispozitave ligjore dhe rregullativës ka hartuar planin e punës për vitin 2019.

Ndër aktivitetet kryesore parashihen të jenë:

- Përfaqësimi i komunës në seanca gjyqësore
- Ushtrimi i padive për palët
- Prapësimet e rasteve duke respektuar afatet ligjore
- Mendime juridike për zyrat e kryetarit dhe të drejtorive komunale.

#### **Zyra për komunikim me publikun**

- Publikimi i Vendimeve të nënshkruara nga kryetari
- Përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e kryetarit dhe drejtorive komunale
- Dërgimi i vendimeve të nënshkruara nga kryetari në MAPL
- Publikimi i raportit të qeverisë komunale për vitin 2018
- Publikimi i planit të punës së qeverisë komunale 2019
- Pranimi i kërkesave për qasje në dokumente publike dhe kthimi i përgjigjes bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike
- Përgatitja e raportit për zyrën për Informim
- Marrja pjesë nëpër takime të cilat kanë të bëjnë me transparencë dhe llogaridhënie
- Pranimi i kërkesave të OJQ-ve të ndryshme
- Përgatitja e raportit për zyrën për Informim
- Përgatitja e njoftimeve për mbajtjen e debateve-konsultimeve publike me qytetarë
- Publikimi i njoftimeve për mbledhjet e kuvendit komunal-KPF-së dhe Komitetit për Komunitete
- Përgatitja e njoftimeve për aktivitete përkujtimore, ngjarje e përvjetorë e për data të rëndësishme
- Publikimi i broshurave të cilat janë në interes të informimit të qytetarëve
- Publikimi i raportit njëvjeçar financiar për vitin 2018
- Publikimi i dokumenteve si rregullore dhe plane të cilat duhet të dalin në diskutim publik me qytetarë
- Publikimi i raporteve të ndryshme
- Fillimi i procedurave për përgatitjen e rregullores për transparencë komunale
- Përgatitja e planit të veprimit për transparencë komunale
- Marrja pjesë nëpër takime-punëtori që lidhen me transparencë komunale
- Publikimi i njoftimeve për gjendjen rrugëve gjatë sezonin dimëror
- Publikime të tjera, sipas nevojës, kërkesave dhe interesave të komunës
- Publikime të tjera sipas nevojës, kërkesave dhe interesave të komunës.

#### **Zyra e Auditimit të Brendshëm**

Gjatë vitit 2019 Njësia e Auditimit të Brendshëm planifikon të auditojë këto Drejtori:

- Drejtorinë e arsimit
- Drejtorinë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural
- Zyrën e personelit
- Drejtorinë për urbanizëm, planifikim hapësinor dhe mbrojtje të mjedisit
- Drejtorinë për ekonomi dhe zhvillim
- Drejtorinë për shëndetësi (QKMF)
- Drejtorinë për administratë të përgjithshme
- Drejtorinë për financa dhe buxhet
- Drejtorinë për shërbime publike komunale
- Zyrën e prokurimit.

## DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

Takim me të gjithë punonjësit e komunës së Rahovecit. Takimet do të jenë sistematike dhe planifikohen të mbahen çdo 3 muaj, ku do të kërkohen nga të gjithë punëtorët e administratës që të respektojnë orarin e punës si dhe të gjitha urdhëresat që do të nxirren nga kryetari i Komunës.

Do të vizitohen të gjitha zyrat e gjendjeve civile në bashkësi lokale, në mënyrë që të planifikohet, të mbahet rendi dhe zyrtarët komunalë të jenë gjithmonë në shërbim të qytetarëve.

Në kuadër të projekteve për administratën e përgjithshme, theksi do të bie në ofrimin e shërbimeve elektronike, ndikim direkt në këtë do të ketë E-kiosku që synojmë ta realizojmë gjatë vitit 2019.

Korriku dhe Gushti do të shpallen si muajt e mërgimtarëve, ku përveç aktiviteteve kulturore e artistike, në administratë do të rriten dhe zgjaten shërbimet për qytetarë, ku do të hapen edhe një numër më i madh i sporteve për shërbime sa më cilësore për mërgimtarët tanë.

Në kuadër të drejtorisë së Administratës së Përgjithshme ekzistojnë këta sektorë:

- Gjendja Civile
- Sektori për punë të përbashkëta
- Zyra për barazi gjinore, të drejtat e njeriut dhe integritet evropiane

### Gjendja Civile

Ofrimi i shërbimeve të shpejta është synim i yni gjatë vitit 2019. Do të kujdesemi që stafi të jetë i përgatitur me njohuri, gjithmonë duke u bazuar në rregulloret dhe ligjet e aplikueshme.

Do të bëhet një ristrukturim i personelit dhe sporteve në mënyrë që funksionaliteti dhe shërbimi të jetë maksimal.

Synim yni për këtë vit do të jetë rritja e shërbimeve edhe nëpër zyrat e gjendjeve civile nëpër bashkësi lokale dhe këtë synojmë ta arrijmë në bashkëpunim me drejtorinë për buxhet dhe financa dhe drejtorinë e bujqësisë.

### Sektori për punë të përbashkëta

Në kuadër të këtij sektori funksionojnë këto zyra:

#### *Zyra e Teknologjisë Informative*

Do të sigurohemi, se të gjithë zyrtarët dhe drejtorët e drejtorive të jenë të pajisur me pajisje të nevojshme për punë administrative në zyrë, me e-mail zyrtar për të gjithë stafin dhe drejtorët e drejtorive, po ashtu edhe për kuvendarët e rinj.

Shfrytëzimi racional dhe suportimi i stafit në aktivizim të Intranetit.

Përditësimi dhe plotësimi i WEB-faqes së komunës së Rahovecit me të gjitha informatat, vendimet, urdhëresat, në mënyrë që transparenca ta ketë fjalën kryesore. Poashtu, do të vendoset një monitor në hapësirën e administratës së komunës, ku do të publikohen informata me rëndësi nga qeverisja komunale.

### ***Zyra për Punë të Kuvendit***

Në kuadër të zyrës për punët e kuvendit parashihet që të përgatiten dhe organizohen seancat e rregullta, seancat e jashtëzakonshme dhe seancat emergjente.

Përgatitja e materialit dhe fletëvotimeve për mbledhjet e Kuvendit, dërgimi i materialit dhe ftesës MAPL-së dhe kuvendarëve me anë të e-mailit dhe ftesave fizike për datën e mbledhjes. Të gjitha vendimet e nxjerra nga kuvendi do të procedohen më tutje sipas rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, të njëjtat do të kujdesemi që të arkivohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Synim yni i qeverisjes komunale do të jetë pajisja e të gjithë kuvendarëve me lap-top.

### **Sektori për barazi gjinore, të drejtat e njeriut dhe integritet evropiane**

Në kuadër të administratës funksionojnë edhe njësit që trajtojnë tema si:

- Njësia për barazi gjinore
- Njësia për të drejtat e njeriut dhe
- Njësia për integritet evropiane.

#### ***Njësia për barazi gjinore***

Punët dhe detyrat e parapara me plan vjetor do të kryhen me efikasitet, përgjegjësi dhe profesionalizëm në harmoni me përcaktimin e detyrave të punës.

Në zyrën për Barazi Gjinore, do të kryhen këto punë:

Do të asistohen të gjitha rastet e të ri-atdhesuarve për plotësimin e dokumenteve për të qenë përfitues të programit të ri-atdhesuar në bashkëpunim me zyrën e punësimit në Rahovec. Gjatë gjithë vitit personat e ri-atdhesuar të cilat përfitojnë grande, do të monitorohen.

Në bashkëpunim me grupin joformal të grave do të bëjmë agjendën në bashkëpunim me zyrën e kryetarit për organizimin e festës së gruas 8 Marsin. Do të organizojmë takime rajonale me OSCE dhe organizata të ndryshme që merren me barazi gjinore.

Gjatë gjithë vitit planifikohet që rastet e dhunës familjare të raportohen në Stacionin Policor në Rahovec.

Bizneset që udhëhiqen nga femrat, planifikojmë t'i vizitojmë gjatë vitit në mënyrë sistematike.

#### ***Njësia komunale për të drejtat e njeriut***

Në planin e punës për periudhën janar – dhjetor 2019, përfshihen aktivitetet që do të realizohen në fushën e të drejtave të njeriut.

Përmbajtja e përfshirë në planin njëvjeçar të cilin po e prezantojmë është bazuar edhe në statistikat e grumbulluara nga bashkëpunëtorët relevant, me të cilët NJKDNJ është në kontakt të vazhdueshëm dhe ka një shkëmbim dhe bashkëpunim të frytshëm, veçmas me Drejtorinë e Arsimit dhe atë të Shëndetësisë/QPS-në, Policinë dhe të tjerët. Nuk do të mungojë bashkëpunimi me zyrtarë të zyrës së Avokatit të Popullit.

Ditët e hapura planifikohet që të mbahen me qytetarë nëpër qendrat në nivel komune, ku do të bëhet promovimi i të Drejtave të Njeriut, gjegjësisht të drejtat e fëmijëve.

I tërë plani nënvizon rëndësinë e nxitjes së koordinimit dhe rritjes së bashkëpunimit me të gjithë akterët e përfshirë në çështjet e të drejtave të njeriut, me qëllim të angazhimit dhe dëshmisë ndaj reagimit të përbashkët ndaj diskriminimit në institucionet komunale dhe hartimin e politikave të reja komunale me fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Njësia për të drejtat e njeriut në Komunën e Rahovecit do të punojë edhe në fushën e ri-integrimit të personave të riatdhesuar.

#### ***Zyra për integritet evropiane***

Zyra për Integritet evropiane do të kryej funksionin dhe detyrat e veta, duke u bazuar në rregulloren nr. 08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për integritet evropian në monitorimin, bashkëpunimin dhe raportimin e rregullt për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamentin për Integritet Evropiane.

Gjatë kësaj periudhe kohore ZKIE do të përgatit të dhënat nga drejtoritë përkatëse në kuadër të komunës për detyrat që dalin nga PKZMSA-ja, dhe do të diskutojmë për obligimet e parapara që janë nën kompetencën e komunave dhe nëse kanë ndonjë vërejtje të bëhen në draft-plan.

Trajnim-Zbatimi i Strategjisë shtetërore për ri-integritet të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022 dhe planin e veprimit 2019-2020. Trajnim-zbatimi i dokumenteve kryesore të Politikave për Ri-integritet.

Roli i komunave në përmbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane si dhe zbatimi i Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026.

Zyrtari për Integritet Evropiane në komunën e Rahovecit do të fokusohet dhe përkushtohet në detyrat dhe funksionet e tij, gjithnjë duke bërë përpjekje që të forcojë dhe përmirësojë bashkëpunimin, monitorimin, këshillimin, si me autoritetet qendrore, ashtu edhe me kabinetin e kryetarit, drejtoritë, zyrat komunale si dhe shoqërinë civile.

### **DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE**

Vlerësimi i nevojave lokale, analizime dhe prioritetet e DSHMS-së për këtë vit:

- Përkujdesje për respektimin e orarit të punës dhe mbajtja e disiplinës në punë
- Përkujdesje për zbatimin e dispozitave pozitive ligjore në fuqi në lëmit përkatëse
- Raportimi i rregullt për nevojat e kryetarit dhe institucioneve tjera që ndërlidhen me drejtori të shëndetësisë
- Ruajtja e fshehtësisë profesionale dhe respektimi i kodit etikë
- Ofrimi i shërbimeve në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët, si dhe gatishmëria për integritetin e minoriteteve
- Organizimi dhe koordinimi i punës në mes të shërbimeve në drejtori
- Përkujdesje për përgjigjen me kohë të të gjitha parashtresave dhe shkresave zyrtare si dhe ofrimi i udhëzimeve për veprimin e të mëtutjeshme

- Identifikimi i nevojave për aftësim profesional të stafit dhe kyçja e tyre në aktivitetet që i mundësojnë implementimin efikas të dispozitave ligjore në fuqi me qëllim që të avancohen shërbimet përkatëse
- Bashkëpunimi me institucion dhe OJQ që ndërlidhen me drejtori të shëndetësisë dhe mirëqenie sociale
- Shfrytëzimi sa më racional i buxhet të DMSHS-së
- Organizimi funksional i shërbimit administrativ dhe ofrimin e shërbimeve sa më cilësore mjekësore në kuadër të kujdesit primar shëndetësor
- Ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare- Emergjencja, si dhe funksionalizimi i saj
- Ndërtimi i QMF-së në fshatin Çifllak
- Furnizimi me barna esenciale
- Funksionalizimi i repartit të Hemodializës
- Furnizimi me pajisje mjekësore.

#### **Rezultate të pritshme**

Realizimi i plotë i planit dhe detyrave të parashtruara , duke u përqendruar edhe në çështjet tjera të cilat nuk janë cekur më lart dhe kanë të bëjmë me DSHMS-në.

#### **Plani i zhvillimit**

Kompletimi i stafit përkatës, pajisja me logjistikë të nevojshëm për stafin e DSHMS dhe ngritja e vazhdueshme profesionale e stafit mjekësor.

#### **Koment**

Angazhimi dhe përkushtim maksimal në punë nuk do të mungojë siç nuk ka munguar deri më tani.

### **DREJTORIA PËR ARSIM**

Drejtorja për Arsim për vitin 2019 planifikon të realizojë aktivitetet e shumta me qëllim të përmirësimit të kushteve infrastrukturore të institucioneve arsimore dhe ngritjes së cilësisë në fushën e arsimit.

Synimet kryesore e DKA-së për vitin në vazhdim janë:

- Themelimi dhe funksionalizimi i Ekipit Profesional Vlerësues dhe Monitorues në kuadër të DKA-së,
- Funksionalizimi i plotë i aktivave profesionale në secilën shkollë
- Zgjerimi i stafit të DKA-së me kuadrin e nevojshëm të pedagogëve dhe psikologëve
- Riparimet dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore
- Investimi në ndërtimin e 3 çerdheve për fëmijë
- Vazhdimi i projekteve për ndërtimin e shkollave të reja të filluara nga viti 2018
- Ndërtimi i shkollave të reja
- Furnizimi i shkollave me libra, pajisja me laboratorë dhe teknologji informative

Në fillim të muajit Janar do të mbahet takimi i parë i këtij viti kalendarik me drejtorët e shkollave. Themelimi dhe funksionalizimi i Ekipit Profesional Monitorues dhe Vlerësues në kuadër të DKA-së do të ndodhë në muajin Janar. Ky ekip do të përbëhet prej 7 deri 9 anëtarëve dhe detyra e këtij ekipi do të jetë përcjellja e vazhdueshme (monitorimi) dhe vlerësimi i punës së mësimdhënësve në secilën shkollë. Poashtu, duke filluar nga ky muaj, në bashkëpunim me Kompaninë Projektuese, do të nisim hartimin e projekteve të parapara të fillojnë në vitin 2019, siç janë ndërtimi i çerdheve dhe shkollave, projektet për ngrohjen qendrore në shkollat e komunës sonë, projektet në drenazhimin dhe hidroizolim të disa shkollave, etj.

Funksionalizimi i plotë i aktiveve profesionale në secilën shkollë, do të jetë një proces që do të ndodhë gjatë muajit shkurt. Brenda këtij muaji, në secilën shkollë do të jenë aktive dhe funksionale aktivitetet profesionale, të cilat do të jenë në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me Ekipin Profesional Monitorues dhe Vlerësues të DKA-së. Në këtë muaj do të nisim procedurat e prokurimit për projektin:

- Ngrohje qendrore për shkollat e komunës së Rahovecit

Në muajin Mars, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, presim të fillojë implementimi i Programit të Masave të Eficiencës së Energjisë në 4 shkolla të komunës sonë, duke filluar me shkollën "Vëllezërit Frashëri" në Drenoc, për të vazhduar pastaj me Shkollën "Milaim Krasniqi" në Pastasel, shkollën "Rilindja në Çifllak dhe në shkollën "Nesimi Elshani" në Nagac. Poashtu, në këtë muaj, do të zhvillojmë aktivitete kulturore për nder të "7 Marsit" – Ditës së Mësuesit. Gjithashtu, në këtë muaj, do të mbahet takimi i dytë me drejtorët e shkollave, për mbarëvajtjen e procesit edukativo arsimor. Gjithashtu, në këtë muaj do të nisim procedurat e prokurimit për projektet:

- Ndërtimin e shkollës fillore në Fortesë
- Drenazhimi dhe hidroizolimi i objekteve shkollore.

Në Muajin Prill, Ekipi Profesional Vlerësues dhe monitorues do të vizitojë të gjitha shkollat, me ç'rast do të koordinojë veprimet me aktivitetet profesionale të shkollave, për t'u siguruar që ecuria e procesit të realizimit të planprogrameve mësimore po ecën mirë. Ky ekip, për herë të parë do të japë vlerësimet profesionale dhe do të përgatisë sugjerimet e nevojshme për të përmirësuar gjendjen në realizimin e planprogrameve mësimore dhe në përdorimin unik të instrumenteve vlerësuese të të nxënësve, në të gjitha shkollat.

Në muajin Maj do të mbajmë gara të diturisë me nxënësit e të gjitha niveleve dhe të shumicës së lëndëve mësimore. Poashtu, në këtë muaj, do të bëhen përgatitjet dhe do të organizohet testi i maturës për nxënësit e klasave të 12-ta dhe testi i arritshmërisë për nxënësit e klasave të 9-ta. Gjithashtu, në këtë muaj do të nisim procedurat e prokurimit për projektin:

- Ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Krushë të Madhe.

Në muajin Qershor do të zhvillojmë takimin e tretë me radhë me drejtorët e shkollave, me ç'rast do të bëhet një analizë e përgjithshme e procesit mësimor gjatë gjithë vitit mësimor. Në këtë muaj do të zhvillojmë procedurat e prokurimit për projektet:

- Ndërtimi i shkollës fillore në Kaznik
- Ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Xërxë

Në fillim të muajit Korrik do të ketë konkurs për regjistrimin e nxënësve në klasat e 10-ta – Afati i Parë. Poashtu, në këtë muaj, parashikojmë të nisin së zbatuari të gjitha projektet e parapara nga Drejtoria Komunale e Arsimit për vitin 2019. Në këtë muaj, do të fillojë edhe planifikimi i kuadrit mësimor për vitin shkollor 2019/2020 si dhe fillimi i përgatitjeve për t'i zotuar mjetet për ngrohje të institucioneve edukativo arsimore. Gjithashtu, DKA, do të fokusohet edhe në riparimin e objekteve shkollore.

Në muajin Gusht, varësisht nga planifikimi i bërë, eventualisht do të ketë konkurs për plotësimin e vendeve të punës me kuadër arsimor, ndërsa nga data 15 Gusht do të fillojë paraqitja në punë e të gjithë mësimdhënësve, për t'i bërë përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit të ri mësimor.

Me fillimin e vitit të ri shkollor në muajin Shtator, të gjitha shkollat fillore të mesme të ulëta do të furnizohen me tekste mësimore dhe do të sigurohemi që janë marrë të gjitha masat e nevojshme që viti i ri shkollor të fillojë mbarë në të gjitha shkollat. Gjatë këtij muaji do të bëhet gati edhe planifikimi i projekteve kapitale për arsim për vitin 2020 nga DKA.

Gjatë muajit Shtator dhe Tetor, do të bëhet furnizimi me lëndë djegëse për ngrohje për të gjitha shkollat dhe institucionet edukativo arsimore të komunës sonë.

Në muajin Nëntor, do të mbahet takimi i radhës me drejtorët e shkollave dhe me koordinatorët e cilësisë për mbarrëvajtjen e procesit edukativo arsimor për periudhën e parë dhe për ecurinë e zbatimit të planprogrameve mësimore.

Në muajin Dhjetor, drejtori i DKA-së do të realizojë takime të njëpasnjëshme me Këshillat e Arsimtarëve të çdo shkolle, ndërsa në fund të dhjetorit do të mbahet edhe një takim me drejtorët e shkollave.

## DREJTORIA PËR FINANCË DHE BUXHET

Plani i veprimeve në DBF deri në përfundim të vitit 2019, veprimet, aktivitetet kryesore të cila duhet të ndërmerren:

- Përgatitja e Pasqyrave Financiare
- Përgatitja e raportit vjetor financiar 2018 për Kuvend
- Përgatitja e dokumentit të rrjedhjes së parasë (cash planit)
- Shpërndarja e faturave të Tatimit në Pronë
- Përgatitja për fillimin e implementimit të Tatimit në Tokë
- Regjistrimi dhe verifikimi i objekteve
- Plani dhe strategjia e realizimit të të hyrave komunale (Tatimi në Pronë, në Toka) në raport me planifikimin (i përfunduar)
- Përgatitja e raportit tremujor financiar 2019, për kuvend dhe për publik
- Përgatitja e KAB-it komunal 2020-2022, sipas qarkoreve buxhetore I dhe II
- Dërgimi i raportit të auditimit për vitin 2018 në Kuvend, i audituar nga ana e Zyrës Kombëtare të Auditimit
- Përgatitja e raportit gjashtëmujor financiar 2019, për kuvend dhe për publik
- Dëgjimet buxhetore me qytetarë nga ekzekutivi dhe nga KPF, periudha qershor-korrik.

- Dorëzimi i KAB-it komunal 2020-2022, i përgatitur për votim në kuvend.
- Futja e të dhënave buxhetore në sistemin PIP dhe BDMS.
- Përgatitja e raportit nëntëmuor financiar 2019, për kuvend dhe për publik.
- Mbyllja e vitit fiskal 2019, me përqindje të lartë të shpenzimit të buxhetit, dhe me një përqindje të lartë të realizimit të të hyrave.

## DREJTORIA PËR EKONOMI ZHVILLIM DHE TURIZËM

Plani i punës bazohet në këto aktivitete:

- Planifikimi dhe regjistrimi i të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2018 dhe regjistrimi në librin e ri të vitit 2019 (janar-shkurt)
- Kalkulimi i ngarkesave për vitin 2019 në formë elektronike
- Përpilimi dhe analizimi i ngarkesave të taksës afariste komunale për vitin 2019 (shkurt –mars).
- Shtypja e Aktvendimeve për të gjithë bizneset që janë të ngarkuara me taksë afariste komunale (janar- qershor)
- Mirëmbajtja e sistemit të pasurisë financiare dhe jo financiare, gjatë gjithë vitit 2019.
- Regjistrimi i aseteve kapitale, gjatë gjithë vitit
- Mbikëqyrja dhe inkasimi i të hyrave në qira, si dhe mbikëqyrja e objekteve afariste komunale përgjatë gjithë vitit, lidhja e kontratave të reja etj.
- Vizitë bizneseve të komunës së Rahovecit
- Vazhdimi i projektit “Shtegu i ecjes” (Maja e Shkodranit), si dhe përfundimi i këtij projekti
- Angazhimi me palë në zyrën e ARBK-së, si dhe shërbime efikase e të shpejta për biznese
- Mirëmbajtja e zyrës së turizmit dhe funksionalizimi i kësaj zyreje me aktivitete të ndryshme për turizëm (bashkëpunimi me verëtarët, vreshtarët, agjencionin zhvillimor rajonal-jug, si dhe të gjitha bizneset e komunës, OJQ-të etj.
- Sinjalizimi i pikave turistike.

### *Investime kapitale për vitin 2019.*

- Tregu i kombinuar
- Investime në infrastrukturë, në Zonën ekonomike
- Shtëpia e pleqve për shërbime ditore
- Investime në turizëm, bujtina

## **DREJTORIA E URBANIZMIT, PLANIFIKIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT**

Duke u bazuar edhe në përvojën e viteve të kaluara, plani vjetor i punës për vitin 2019 është hartuar me kujdes, në mënyrë që të jetë i kompletuar në aspektin e implementimit gjatë tërë vitit.

Funksionimi i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit mbështetet në dy sektorët e saj:

- Sektori për Urbanizëm dhe Planifikim
- Sektorit për Mjedis.

Në kuadër të këtyre sektorëve shqyrtohen kërkesat e qytetarëve siç janë: Lejet ndërtimore, Lejet e rrënimt, Kushtet ndërtimore, Lejet mjedisore komunale, Pëlqimet, Vërtetimet Urbanistike, Njoftime dhe shkresa të ndryshme rreth zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planeve të tjera rregulluese, si dhe mbrojtjes së mjedisit.

Prioritetet dhe synimet e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për vitin 2019 janë:

- Shqyrtimi i kërkesave të palëve në afat minimal ligjor
- Rritja e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore dhe lejeve mjedisore komunale në bashkëpunim me Drejtorinë për Punë Inspektuese.
- Përfundimi i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, i nisur në vitin 2018, në bazë të komponentëve të ligjit të ri për planifikim hapësinor dhe në bazë të programit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit
- Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit
- Rritja e kualitetit të hartimit të projekteve të ndryshme, përmes revidimit ose kontrollit dhe pranimit nga një komision profesional komunal
- Rritja e kualitetit të mbikëqyrjes, rrjedhimisht të punimeve në projektet kapitale, duke punuar ngushtë me organin mbikëqyrës
- Menaxhimi sa më efektiv i projekteve kapitale të menaxhuara nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkëpunim me organin mbikëqyrës
- Aplikimi i masave të EE-së në projekte të ndryshme kapitale
- Konceptimi dhe hartimi i projektit për Sheshin e Rahovecit, me pjesëmarrjen e profesionistëve dhe qytetarëve në përcaktimin e detyrave projektuese
- Trajtimi i objekteve me rëndësi të veçantë, i komplekseve të dëshmorëve e martirëve, rregullimit të varrezave, pllakave përkujtimore, busteve, etj.
- Trajtimi i shtretërve të lumenjve, përmes investimeve kapitale nga Komuna e Rahovecit dhe mbështetjes nga Qeveria e Kosovës
- Krijimi i hapësirave të reja të gjelbëruara, rregullimi i parqeve dhe mbjellja e drunjëve
- Hartimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, me pjesëmarrjen e ekspertëve dhe qytetarëve
- Rritja e përkushtimit në mbrojtjen e mjedisit
- Përkrahja e iniciativave në ruajtjen e mjedisit, shënimi i ditëve ndërkombëtare të tokës, ujit, mjedisit etj.

## **DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË**

Fillimi i vitit të ri, do të fillojë me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak.

Qysh në fillim të vitit 2019 do t'i qasemi punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës së Rahovecit.

### ***Prioritetet e vitit 2019***

Prioriteti kryesor gjatë vitit 2019 do të fokusohet në shërbime cilësore në përputhje me afatet kohore dhe të unifikuara ligjërsh.

Qëllimi kryesor i drejtorisë do të jetë i fokusuar në shërbime konform akteve juridike. Themelimi i komisionit për evidentimin e pronave të uzurpuara në nivel të komunës. Vazhdimi i inventarizimit të dokumentacionit dhe skanimit i dokumentacionit të pa skanuar. Shpronësimi i pronave private për hapje të rrugëve publike në nivel të Komunës.

### ***Sfidat e vitit 2019***

Themelimi i komisionit për komasacion. Migrimi i zonave kadastrale në komasacion të fshatrave: Fortesë, Celinë, Xërxë, Dejnë dhe Dobidol.

Duam të theksojmë se në kuadër të Drejtorisë ekzistojnë dy sektorë:

- **Spektori për Kadastër dhe Pronë dhe**
- **Spektori për Gjeodezi**

Numri i punëtorëve në këtë drejtori është me sa vijon;

Gjithsej 9-të punëtorë, ku prej tyre, një është me përgatitje të lartë shkollore (jurist), pesë janë gjeodetë me përgatitje të mesme, një referent me përgatitje të lartë juridike dhe një vozitës.

### ***Spektori për Kadastër dhe Pronë***

Gjate periudhës një vjeçare parashihet që të pranojmë dhe kryejmë më shumë se 1000 lëndë.

### ***Spektori për Gjeodezi***

Parashihet që të pranojë dhe zgjidhë mbi 400 lëndë.

Duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2019 pritët që të ketë rritje të kërkesave për nxjerrjen e certifikatave pronësore nga ana e fermerëve për aplikim në kuadër të subvencioneve që pritët t'ju ndajë Qeveria e Kosovës. Këtë proces do ta menaxhojmë me shumë kujdes duke e rritur stafin mbështetës, në mënyrë që të jemi në shërbim të qytetarëve me shumë profesionalizëm dhe në kohë reale.

Vlen të përmendet sektori i gjeodezisë për punën e tyre që do ta kenë në terren, si dhe shërbimi pronësor-juridik për angazhimin e dhënë në përgatitjen e akteve, si për nevoja të Kuvendit të Komunës ashtu edhe përgatitjen e akteve për persona fizik dhe juridik.

Do të vazhdojmë me përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me evidentimin e pronave, si ato komunale dhe ato private, që janë vend-rëniet e dëshmorëve të kombit me qëllim që këto parcela t'i shpallim zona me interes të veçantë. Kjo mbetet sfidë që të përfundohet deri në fund të vitit 2019.

Gjatë vitit 2019 nuk do të mungojë edhe qasja ndaj detyrave të tjera, si në sektorin e gjeodezisë ashtu edhe në atë të kadastrës dhe pronës, ku vlen të cekem:

- Propozim-vendimet për seancat e Kuvendit Komunal
- Përgatitja e lëndëve për gjykatë dhe subjekte të tjera të përfshira në zbatimin e ligjit
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe personave juridik
- Punët e gjeodezisë/inxhinierisë për nevojat e Kuvendit Komunal dhe palëve të tjera
- Matjet kadastrale për vërtetimin e uzurpimeve arbitrare
- Përgatitja e aktvendimeve për uzurpimet arbitrare
- Punë të tjera sipas planit.

Me propozim të Kryetarit të Komunës, drejtuar Kuvendit të Komunës, do të bëhet shpallja e interesit të përgjithshëm të pronave komunale për zhvillim ekonomik të komunës.

## DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Për vitin 2019 planifikojmë që të arrijmë këto prioritete sipas planit të punës:

- Pastrimin e rrugëve dhe trotuareve nga bora dhe intervenimet e tjera emergjente (janar-prill 2019)
- Mirëmbajtjen e rrugëve me zhavorr (prill-maj 2019)
- Ndërtimin e rrugëve në qytet dhe fshatrat e komunës sipas prioriteteve (maj-shtator 2019)
- Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe ndërhyrjet emergjente në disa vendbanime të komunës së Rahovecit (mars-tetor 2019)
- Ndërtimin e trotuareve në qytet dhe fshatrat e komunës, sipas prioriteteve (gjatë tërë vitit 2019);
- Ndërtimin e semaforëve të rinj në qytet (qershor 2019)
- Heqjen e deponive ilegale të inerteve (gjatë tërë vitit 2019)
- Analizimin e kontratave dhe përmbushjen e tyre në projektet si: trotuare, rrugë, rreth-rrotullime, hapësira publike, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, të martirëve, të civilëve, poashtu, të shesheve, pllakave përkujtimore, të hapësirave të gjelbëruara etj. (gjatë tërë vitit 2019)
- Zhbllokimin e kanalizimeve të ujërave atmosferik
- Hartimin e projekteve të reja për ndërtimin e rrjeteve të: kanalizimit, rrugëve, ndriçimit publik, trotuareve, etj.
- Mbledhjen e të hyrave nga sipërfaqet publike, sipas rregullores së DSHP-së
- Mirëmbajtjen e hapësirave publike, shesheve, parqeve, varrezave, pllakave përkujtimore, lapidarëve etj.

- Mirëmbajtjen e rregullt të kanaleve të ujërave fekale nga kompania KRU "Gjakova"
- Hapjen e procedurave për disa punë si: rrugët lokale qytet-fshat, përmirësimi i kanalizimeve, furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Zatriq, Pastasel, Baboc, Mrasor dhe Kaznik; mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe atyre në qytet; muret mbrojtëse sipas prioriteteve etj.
- Përfundimin e rrugës (asfaltimin) Krushë e Madhe –Randobravë
- Ndërtimin e rrugës Rahovec-Pataqan, si dhe për Fortesë / faza përfundimtare
- Ndërtimin e rrugëve në Drenoc, si dhe disa pjesëve të kanalizimit
- Pas proceduarve për shpronësim, të kërkohet nga MI që rruga qarkore në Rahovec të kalojë në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës
- Fillimin e punëve me projektin për sinjalizim horizontal dhe vertikal
- Vendosjen e disa pengesave në rrugë sipas standardeve të përcaktuara
- Intervenime emergjente në infrastrukturë
- Inicimin, analizimin e madhësisë dhe dendësisë së qarkullimit në rrugët e qytetit për verifikimin e senseve të lëvizjes
- Ndriçimin publik në qytet dhe fshatrat më të mëdha të komunës sonë
- Trajtimin, largimin e qenve endacakë në bazë të marrëveshjes së AVUK-ut me kompanitë private të licencuara për trajtimin e tyre
- Stacionin e autobusëve, intensifikimi i punës së komisionit dhe gjetja e zgjidhjes
- Menaxhimi i deponisë për mbeturina nga demolimet dhe ndërtimet
- Eliminimin e të gjitha deponive ilegale- inerteve
- Në bashkëpunim me KEDS do të caktojmë prioritetet për shtrirjen e rrjetit elektrik si dhe vendosjes së trafave sipas kërkesave të qytetarëve
- Mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror
- Dekorimin e rrugëve për festat e fundvitit.

#### **DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL**

Drejtoria për BPZHR, për vitin 2019 ka paraparë rritjen e kapaciteteve prodhuese, modernizimin e bujqësisë, tërheqjen e investimeve, zbatimin e projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve, me theks të veçantë fermerëve, rritjes ekonomike dhe të punësimit. DBPZHR këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes:

- Përkrahjes direkte të fermerëve - subvencionimit
- Shërbimeve këshillimore
- Implementimit të projekteve kapitale në bujqësi
- Zbatimin e projekteve të donatorëve dhe mbështetjes direkte në lëmin e bujqësisë për iniciativat e qytetarëve në ngritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimeve bujqësore.

Përveç aktiviteteve të parapara për periudhën kohore janar-dhjetor 2019, stafi i drejtorisë për BPZHR do të jenë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme për mbikëqyrjen dhe pranime teknike të projekteve kapitale pranë kësaj drejtorie, si dhe në komisione të tjera pranë Kuvendit Komunal të Rahovecit.

### **Prioritetet e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, përcjelljen e thirrjeve të MBPZHR-se për skemën e pagesave direkte dhe të grandeve, si dhe detyrave të tjera, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

#### ***Tremujori i parë: janar, shkurt, mars***

Këtë periudhë tremujore do ta karakterizojë kryesisht trajtimi i aplikacioneve për skemën e grandeve dhe pagesave direkte duke u bazuar në thirrjet për aplikime që do të hapen nga MBPZHR. Stafi i drejtorisë synojmë të jetë i gatshëm të përballojë fluksin e fermerëve gjatë kryerjes së procesit të aplikimit.

Poashtu, në këtë periudhë kohore do të iniciohen edhe procedurat e shpalljes së tenderëve për zbatimin e projekteve kapitale si dhe përcjellja e projekteve që janë në vazhdim.

#### ***Tremujori i dytë: prill, maj, qershor***

Periudha kyçe në këtë vit është kjo në të cilën pritet të hapen thirrjet nga komuna për përkrahje të fermerëve me grande. Në këtë periudhë do të hapen thirrje për të përkrahur fermerët në të gjithë sektorët me mekanizëm bujqësor, si: sektori i vreshtarisë, sektori i perimekulturës, blegtorisë, bletarisë etj.

Formimi i komisioneve për përzgjedhje dhe mbikëqyrja e projekteve kapitale do të vazhdojnë ta përcjellin këtë periudhë tremujore.

#### ***Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator***

Korrje-shirjet do ta karakterizojnë periudhën e tretë të vitit. Poashtu, nuk do të mungojë përcjellja e projekteve të investimeve kapitale si dhe shpërndarja në mënyrë të drejtë dhe pa anime e grandeve të vogla nga komuna e Rahovecit.

Në këtë periudhë, theksi do të bie edhe te organizimi i festave të komunës sonë, të cilat promovojnë prodhimet tona cilësore që kultivohen anekënd komunës.

#### ***Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor***

Fokusi i periudhës së fundit të vitit do të jetë përcjellja e mbledhjes së prodhimeve, koordinimi i bodrumeve për grumbullim të rrushit si dhe përpunueseve të perimeve në tërë territorin e komunës sonë.

Sigurisht se prioriteti kryesor do të jetë realizimi i buxhetit, do të kujdesemi që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikëri.

### **Synimet e DBPZHR-së**

Përkushtim i veçantë i DBPZHR-së do të jetë përmirësimi i infrastrukturës bujqësore për fermerët e vyeshëm të komunës sonë. Në kuadër të infrastrukturës parashihet që kujdes i shtuar do të jetë te:

- Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore
- Intervenimi në ndërtimin e kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore
- Zgjerimi i sistemit të ujitjes në pjesët ku mungon
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përroskave, si dhe
- Krijimi i ekipeve mobile të pranimi të aplikacioneve për pagesa direkte në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë.

### ***Sektori i pylltarisë***

Në kuadër të sektorit të pylltarisë fokusi do të jetë:

- Mbrojtja e pyjeve
- Rritja e sipërfaqeve me pyje të reja
- Bashkëpunim i qëndrueshëm me Agjencinë Pyjore të Kosovës për pronat që janë dhënë në shfrytëzim
- Angazhim maksimal në parandalimin e zjarreve në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

### ***Sektori i zhvillimit rural***

Edhe zhvillimit rural do t'i jepet rendësi e veçantë duke u nisur nga fakti se komuna jonë njihet si një zonë me zhvillim të theksuar rural.

Me kujdes të veçantë do të trajtohen aspektet për trajtim dhe mbrojtje të faunës e cila është mjaft e pasur, falë rrjedhave të shumta të ujërave në tërë territorin e komunës sonë.

Gjuetia dhe peshkataria do të jenë dy fusha që do të kenë vëmendje të shtuar në planet tona afatgjate.

## **DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE**

Qëllimi i këtij plani të punës është evidentimi i prioriteteve të drejtorisë së inspeksionit për vitin 2019, objektivat e synuara për realizim gjatë këtij viti, aktivitetet e nevojshme për realizimin e objektivave të përcaktuara, afatet kohore dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera relevante të cilat do të ndihmojnë realizimin e këtij plani të punës.

Ky plan pune synon të rrit nivelin e zbatimit së dispozitave ligjore sipas fushës që mbulojnë sektorët e ndryshëm të cilat veprojnë në kuadër të drejtorisë së inspeksionit.

Mbikëqyrja efektive e zbatimit të ligjeve, akteve nënligjore, rregulloreve komunale dhe dispozitave të tjera relevante sipas fushëveprimit të drejtorisë do të jetë synimi kryesor.

### ***Fushat e mbikëqyrjes dhe inspektimit***

Ky plan pune bazohet në prioritetet e nxjerra nga raportet e punës për vitin paraprak, në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, në parregullsitë e evidentuara në vitin paraprak dhe në obligimet që dalin nga infrastruktura ligjore që mbulon drejtoria e inspeksionit.

### ***Sektori i tregut***

- Inspektimi i regjistrimit të bizneseve
- Inspektimi i lokaleve afariste për pëlqim pune
- Kontrolli i deklarimit të mallit
- Zbatimi i orarit të punës.

### ***Sektori i sanitarisë***

- Kontrolli i kushteve higjienike-sanitare të objekteve afariste
- Kontrollimi i objekteve shkollë, shëndetësore etj,
- Kontrolli i kualitetit të ushqimit (afati skadimit).

### ***Sektori i bujqësisë***

- Mbrojtja e tokave bujqësore nga ndërtimet
- Inspektimi i lokaleve afariste (pesticidet, farërat, plehrat artificial, drithërat).

### ***Sektori i shërbimeve komunale***

- Parandalimi i shfrytëzimit të hapësirave publike pa lejen e komunës
- Parandalimi i kyçjeve ilegale në rrjetin e shërbimeve komunale
- Mbrojtja e hapësirave të gjelbëruara dhe ambienti në përgjithësi.

### ***Sektori i veterinës***

- Inspektimi i thertoreve ku bëhet therja e kafshëve, kontrollimi i procedurës së therjes, damkosja e mishit
- Inspektimi i objekteve ku tregtohet mishi
- Inspektimi i fermave
- Inspektimi i ambulancave veterinare dhe barnatoreve veterinare
- Monitorimi i aksioneve për trajtimin e qenve endacakë.

### ***Sektori i komunikacionit***

- Kontrollimi i transportuesve të udhëtarëve, auto-taxi
- Kontrollimi dhe mbikëqyrja e transportuesve të mallrave.

### ***Sektori i ambientit***

- Mbikëqyrja e Lejeve Mjedisore Komunale
- Mbikëqyrja e çdo shkaktimi të ndotjes së ambientit
- Mbikëqyrja e mbeturinave

Ky plan pune parasheh objektivat vjetore në lëmin e ndërtimit, tregut, sanitari, veterinarisë, ambientit, shërbimeve komunale dhe shërbimeve të komunikacionit.

Përmes këtij plani drejtoria e inspeksionit synon të arrijë objektivat e poshtëshënuara:

- Mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve
- Eliminimin e konkurrencës së padrejtë tregtare
- Mbrojtjen e hapësirave publike
- Krijimin e një ambienti të pastër
- Parandalimin e ndërtimeve ilegale
- Informimin e qytetarëve për domosdoshmërinë e pajisjes me leje të ndryshme që lëshohen nga komuna.

Do të ndërmerren masa konkrete me qëllim të rritjes së disiplinës, sjelljes korrekte të inspektorëve në terren dhe ngritjes së besueshmërisë së qytetarëve në autoritetin e inspektorit.

Do t'i shpeshtojmë inspektimet për mbrojtjen e ambientit me qëllim të ngritjes së vetëdijes së përgjithshme për rëndësinë që ka mbrojtja e ambientit dhe ndëshkimin e të gjithë atyre që qëllimshëm e dëmtojnë ambientin dhe hapësirat publike me gjoba mandatore.

Krijimi i një komunikimi të rregullt institucional me institucione të tjera relevante, duke përfshirë Policinë e Kosovës, inspektorët e institucioneve të tjera qendrore, IKSH, kompanitë publike dhe ato private me të cilat komuna e Rahovecit ka kontratë, si dhe me të gjitha institucionet e tjera me të cilat kemi ndërlidhje kompetencash dhe nevojë bashkëpunimi, është i nevojshëm për realizimin sa më efektiv të këtij plani. Prandaj do të kërkojmë që ky bashkëpunim të rritet në shërbim të interesave të përgjithshëm të qytetarëve.

Ky plan pune mund të plotësohet edhe me objektiva dhe detyra të tjera të cilat mund të shfaqen si të nevojshme e që nuk janë paraparë me këtë plan, si dhe me kërkesën dhe vendimin e Kryetarit të Komunës, varësisht nga nevojat dhe prioritetet që mund të shfaqen gjatë periudhave të ndryshme të vitit.

## **DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT**

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport përbëhet prej këtyre sektorëve; Kulturë, Rini dhe Sport. Në kuadër të sektorit për kulturë përfshihen edhe trashëgimia kulturore-historike (muzeu) dhe biblioteka në Rahovec, Hoçë të Madhe dhe në Krushë të Madhe.

DKRS mbulon fusha me rëndësi të jetës shoqërore, duke organizuar aktivitete të ndryshme artistike, teatër, art figurativ, aktivitete rinore, sportive dhe veprime për ruajtjen e trashëgimisë historike e kulturore.

Përveç buxhetit komunal, do të bëhen përpjekje për gjetjen e burimeve të tjera financiare, duke përfshirë ato qendrore; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar. Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, do jetë synim i vazhdueshëm gjatë vitit 2019.

**Prioritetet për vitin 2019:**

Trajtimi dhe shfrytëzimi i objekteve dhe institucioneve ekzistuese kulturore e sportive në komunën e Rahovecit. Objektet që ofrohen për këto aktivitete janë:

- Shtëpitë e Kulturës në Rahovec, Krushë të Madhe, Ratkoc, Xerxë, Drenoc
- Salla e Sportit në Rahovec, por edhe sallat e shkollave në komunën e Rahovecit
- Biblioteka komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, me nëndegën në Krushë të Madhe.

**Projektet dhe planifikimet vjetore do të fokusohen në këto tema:**

- Përkrahja dhe nxitja e punës vullnetare të të rinjve dhe bashkëpunimi me OJQ-të në Rahovec, të cilët e kanë fokus punën me të rinj.
- Krijimin e programeve që kanë qëllim promovimin më të madh në punësimin e të rinjve.
- Nxitja e bashkëpunimit rreth aktiviteteve kulturore,
- Nxitja e bashkëpunimit me OJQ-të në nivel komunal e më gjerë, me fokus të veçantë organizmi i aktiviteteve tradicionale rinore edhe në zonat rurale,
- Përgatitja e projekteve të trashëgimisë kulturore, kujdesi për objektet në listën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe futja e atyre që duhet të ruhen, evidentimi dhe përkufizimi i vlerave kulturore e historike i objekteve të trashëgimisë kulturore,
- Organizimi dhe përgatitja e ngjarjeve kulturore: takime letrare, prezantime librash, ekspozita arti dhe të vlerave kulturore, shfaqje filmash e video-projektor (sipas mundësive teknike)
- Organizimi i trajnimeve për punëtorët e sektorit të Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Bibliotekës,
- Nxitja e të rinjve nga zonat rurale që të përfshihen në sa më shumë në aktivitete,
- Nxitja e lexueshmërisë dhe hapja e bibliotekave në lokalitete e shkolla të Komunës,
- Organizimi i manifestimit tradicional "Flaka e Janarit",
- Furnizimi me libra i bibliotekës komunale dhe hulumtimi për dhurues të librave,
- Ndarja e subvencioneve për OJQ-të kulturore, sportive, rinore dhe subjekteve individuale
- Shënimi i Ditës Botërore të Monumenteve të Kulturës,
- Shënimi i Ditës Botërore të Tokës,
- Java e Dëshmorëve (shoqatat e dala nga UÇK)
- Shënimi i përvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës (17 shkurt),
- Festivali i folklorit "Anadrinia jehon" në Dejnë (Komuna e Rahovecit dhe Shoqata "Anadrini" Dejnë),
- Shënimi i "21 Marsit-Dita Botërore e Poezisë", (në bashkëpunim me DKA-në),
- Dita e Dëshmorëve të komunës së Rahovecit (12 maj),
- Dita e qendrës së kulturës "Mensur Zyberaj", (28 maj)
- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve (1 qershor),
- Dita e Çlirimit të komunës së Rahovecit (14 qershor),
- Dita Botërore e Rinisë (12 gusht),
- Organizimi i shfaqjeve teatrale,
- Angazhime për formimin e teatrit rinor,

- Organizimi i punës për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e palestrës së sportit “Mizahir Isma”,
- Organizimi i aktiviteteve sportive (në bashkëpunim me OJQ-të),
- Pjesëmarrja dhe kontributi i DKRS në organizimin e Festës së vjeljes së rrushit (Hardh Fest),
- Organizimi i datave dhe ngjarjeve historike me karakter kombëtar (përpilohet kalendari).

## DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Prioritetet dhe synimet e Drejtorisë të parapara me këtë plan të punës janë:

- Inspektimi i lumenjve, përrenjve dhe kanaleve të hapura.
- Plani i Reagimit Emergjent
- Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera
- Ndërmarrja e masave të menjëhershme në ofrimin e ndihmës me rastin e shfaqjes së fatkeqësive elementare dhe aksidenteve
- Konstatimi dhe evidentimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë elementare dhe ndërmarrja e masave adekuate për sanimin e gjendjes
- Blerja e uniformave dhe pajisjeve për zjarrfikësit
- Servisimi i aparateve kundër zjarrit
- Kërkesa të ndryshme për donatorë në ofrimin e ndihmës për nevoja të zjarrfikësve
- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore tek objekti i zjarrfikësve
- Angazhimi në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi
- Verifikimi i përgatitjeve për intervenim të forcave dhe të mjeteve për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë
- Zhvillimi i aktiviteteve propagandistike në edukimin dhe vetëdijesimin e qytetarëve- nxënësve të shkollave nga lëmi i mbrojtjes nga zjarri
- Bashkëpunim me sektorë, shërbime e zyre të ndryshme të cilat janë përgjegjëse për planifikim dhe veprim në raste emergjente
- Regjistrimi i mjeteve teknike të nevojshme për intervenime në raste emergjente
- Planifikimi, evidentimi dhe sistemimi i resurseve njerëzore dhe mjeteve materialo-teknike për nevojat emergjente
- Ngritja e nivelit të gatishmërisë emergjente në komunë
- Përcjellja e gjendjes së gatishmërisë dhe organizimi në hapësirën e mbrojtjes dhe shpëtimit
- Inspektimi i rregullt i objekteve publike, objekteve ekonomike dhe private
- Koordinimi i punëve rreth dhënies së pëlqimeve në dokumentacion investivo-teknik dhe në lokacion, respektimi i standardeve për raste emergjente
- Planifikimi i pjesëmarrjes së zyrtarëve të DMSH, në trajnime me qëllim të ngritjes së nivelit profesional në realizimin e detyrave.

## PËRFUNDIM

*Ky plan i punës përcakton synimet, prioritetet dhe aktivitetet më të rëndësishme të cilat do ta karakterizojnë komunën tonë në vitin 2019. Plani është hartuar me vëmendje, pas këshillimeve dhe analizave të bëra nga të gjitha drejtoritë, informacioneve dhe këshillave që kemi pranuar nga qytetarët, individë me ndikim, subjekte e shoqata, përvojën e marrë përmes komunikimeve të shumta me kuadro të fushave të ndryshme, si dhe përvojës sonë të punës në vitin 2018. Është punuar një kohë të gjatë, në mënyrë që të artikullohet sa më qartë zëri, kërkesat kryesore dhe interesat e qytetarëve tanë për rritjen e mirëqenies së tyre.*

*Plani është real por dhe ambicioz, prandaj, zbatimi i tij kërkon energji të madhe, vullnet veprues dhe dinamikë të lartë pune.*

*Zbërthimi i këtij plani në praktikë është detyrë e përditshme e secilit, e të gjithëve bashkërisht, duke u angazhuar që të punojmë ngushtë, të koordinuar mirë e në partneritet.*

*Sigurisht, se gjatë vitit 2019, në komunën tonë do të kemi edhe plot angazhime dhe zhvillime të tjera të rëndësishme të cilat nuk janë paraparë në këtë plan të punës, porse, ato veçse do ta pasurojnë sfondin e përpjekjeve për më shumë arritje dhe suksese si qeverisje komunale.*

*Shprehim vullnetin, përkushtimin dhe gatishmërinë për realizimin e këtij plani, sepse jemi të bindur për përparime dhe arritje të shumta për të cilat i duam të gjithë.*

04.01.2019  
Rahovec

Kryetari i Komunës

Smajl Latifi





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipal of Rahovec



## PLANI I VEPRIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT

| Komponentët e Auditimit e gjetura                | Rekomandimet                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | Të zbatuara gjatë viti 2018 | Në proces të zbatimit | Të pabatuara |
|--------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|-----------------------|--------------|
| 2.1<br>Pasqyrat Financiare                       | Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikim dhe Theksim të Gëshqjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve kapitale, regjistrimin e të gjitha pasurive kapitale dhe jo kapitale, detyrimeve kontingjente, si dhe të siguroj se komuna ka plotësuar pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar me status të nëpunësit civil. Gjithashtu Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2018 i adreson të gjitha gëshqjet që kanë të bëjnë me pajueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë të identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç se ndaj PVF-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet |                             | PO                    |              |
| 3.2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli (të hyrat) | Kryetari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që të bëhet verifikimi i 1/3 e pronave, në mënyrë që shënimet merrh tatimit në pronë të janë të plotë dhe të maksimizohen përfitimet nga kjo e hyrë. Veprimet shpesh duhet të ndërmerren që të siguroj se zbritjet për 10,000,00 euro të aplikohen për vendbanimet kryesore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                             | PO                    |              |
| 3.2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli (të hyrat) | Kryetari duhet të siguroj një menaxhim efektiv të kontratave të qiradhënies dhe të vendos mekanizma efikas për realizimin e të hyrave komfor kushteve të kontraktuar, përkatesisht zbatimin e afatave për arkëtimin mjeteve nga qiraja.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                             | PO                    |              |


|                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |    |    |  |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|--|
| 3.4 Menaxhimi financiar dhe kontrolli (Menaxhimi i dosjeve/të dhënave të personelit)                               | Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë hapa konkret për përmirësimin mbi dosjet e personelit, në mënyrë që të gjitha dosjet të jenë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm, me qëllim të menaxhimit të statit, si dhe matjes së performancës së tyre (vlerësimi i veprave të punës). Për vlerësimin e performancës, komuna duhet të nxjerrë akt (politikë) të brendshme. |    | PO |  |
| 3.5 Menaxhimi financiar dhe kontrolli (Mallrat dhe Shërbimet, Shërbimet komunale)                                  | Kryetari duhet të sigurojë që është duke aplikuar Ligji i Prokurimit Publik, me qëllim që çdo shërbim të kontraktohet duke u bazuar në konkurrencë                                                                                                                                                                                                                                    |    | PO |  |
| 3.6 Menaxhimi financiar dhe kontrolli (Subvencione dhe transferet)                                                 | Kryetari duhet të sigurojë se pagesat bëhen në llogari zyrtare të përfuturit të subvencionit si dhe të sigurojë se janë marrë masa adekuate për të siguruar se regjistrimi i gjendjes civile është duke u azhurnuar në baza të rregullta.                                                                                                                                             | PO |    |  |
| 3.7 Menaxhimi financiar dhe kontrolli (Investime Kapitale)                                                         | Kryetari duhet të sigurojë kontrole të shtuara të kontraktimit, në mënyrë që para se të hyhet në obligime kontraktuale, fondet buxhetore të jenë të zotuar. Zotimet afatgjata duhet të harmonizohen me dinamikën e projekteve dhe të planifikohen me Komitëën Afatmesme Buxhetore të Komunes.                                                                                         |    | PO |  |
| 3.8 Menaxhimi financiar dhe kontrolli (Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investime kapitale) | Kryetari të sigurohet se është vendosur disiplinë e duhur financiare që faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit dhe mbajtjes në kontroll të obligimeve kontraktuale.                                                                                                                                                                    |    | PO |  |
| 3.9 Menaxhimi financiar dhe kontrolli (Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale)                                          | Kryetari duhet të sigurohet që menaxhimi i pasurisë jo financiare bëhet në përputhje të plotë me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Në këtë aspekt duhet të sigurojë funksionalizimin e plotë të sistemit e pasurisë për regjistrimin e pasurive nën 1000 euro dhe stogëve.                                                                                 |    | PO |  |

|                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |    |    |  |
|-------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|--|
| 3.11 Menaxhimi financiar dhe kontrolli (Obligimet e papaguara)    | Kryetari duhet të forcoj kontrollin lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Duhet të sigurojë se në librin e protokollit do të regjistrohen dhe protokollohet të gjitha faturat e pranuara. Më tej, të krijojë një sistem efektiv të kontrollit në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti të shpalosen në PVF                                                                                                               |    | PO |  |
| 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve                           | Kryetari duhet të sigurojë që zbatimin e planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tremujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen brenda afatit të parapara, të rishikohen dhe të ndërmerrin veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.                                                                                                                                                                               |    | PO |  |
| 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm                              | Kryetari duhet të sigurojë se fushëveprimi i NJAB-së, të mbulojë sa më shumë periudhën aktuale duke ndihmuar aktivitetet operative në vazhdim. Njëkohësisht të sigurohet një fokus më i lartë i menaxhimit në funksionalizimin e KA-së drejtë përmbushjes së këtij qëllimi.                                                                                                                                                                                                                                                                    | PO |    |  |
| 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut | Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara. | PO |    |  |

Kryetari i Komunes  
Smail Latif

Data dhe nënshkrimi

25.07.2018



**REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA E RAHOVECIT**  
**OPSHTINA- RAHOVEC**

**NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

01 Nr. 3242

Rahovec me 07.12.2018

**PLANI VJETOR**

**PËR: NJËSIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

**NË KOMUNËN E RAHOVECIT**

**Periudha kohore e auditimit 2019**

**Data: 07.12. 2018**

## I. HYRJE

Ky Plan Vjetor është përpiluar në bazë të Planit Strategjik të aktiviteteve të auditimit të brendshëm për periudhën e auditimit 2019. Ai përkufizon fushëveprimin, objektivat, kohëzgjatjen dhe burimet e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të auditimit.

NJAB. Bënë përgatitjen e planit strategjik dhe planit vjetor, në bazë të Nenit 25, paragrafit 3.3. Kapitullit III, të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e brendshëm të Financave Publike

Detyrat e auditimit për vitin 2019 ndahen në bazë të burimeve njerëzore që ekzistojnë në NJAB.

Bazuar në LIGJI Nr. 06/L-021 Për kontrollin e brendshëm të financave publike, Ligjin Nr. 03/L-048 mbi menaxhimin me financa Publike dhe Përgjegjësi, dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L221, Nr. 04/L- 194 dhe Nr. 05/L-163. Udhëzimet Administrative, Instruksionet financiare në fuqi, si dhe nevojën e Komunës për kryerjen e auditimit të brendshëm për vitin kalendarik 2019, NJAB do ta bëjë auditimin e brendshëm të bazuar në standardet ndërkombëtare më të përparuara sipas planit dhe dinamikës së paraparë.

Plani Vjetor duhet të rishikohet rregullisht gjatë vitit dhe të azhurnohet sipas nevojës, në mënyrë që t'i pasqyrojë ndryshimet e rëndësishme që ndodhin në organizatë apo në mesin e anëtarëve të NJAB, dhe çdo detyrë shtesë që propozohet nga udhëheqësi i organizatës.

Çdo ndryshim i Planit Vjetor do të aprovohet nga Kryetari i Komunës së Rahovecit .

## II. AKTIVITETET E NJËSIS SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Në vitin 2019 NJAB i planifikon realizimin e detyrave dhe aktiviteteve në vijim, për arritjen e objektivave të përshkruar në Planin Strategjik:

| Nr | Objektivat kryesore për vitin vitit 2019                                                                                                       | Aktivitetet për përmbushjen e objektivave                                                                   | Detyrat e NJAB.                  |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------|
| 1  | Përcaktimi i "universit të Auditimit" që përfshin të gjitha fushat/Aktivitetet në Komunë, të cilat mund të nënshtrohen auditimit të brendshëm. | Rishikimi i fushave/aktiviteteve të Komunës, duke ofruar vlerësime objektive dhe rekomandime për përmirësim | Dhënja e sigurtisë së arsyeshme. |
| 2  | Pajtuueshmëri me politikat relevante, si dhe me legjislaturën që ekziston, apo që do të nxirret në të ardhmen.                                 | Rishikimi komentimi si dhe rekomandimi në nxerjen e legjislaturës.                                          | Dhënja e sigurtisë së arsyeshme  |
| 3  | Ritja e numrit të kontrollit të brendshëm të Komunës, duke ofruar vlerësim objektiv dhe rekomandime për përmirësimin e efikasitetit.           | Rishikimi i vlerësimit objektiv për përmirësimin e kontrollit të brendshëm.                                 | Dhënja e sigurtisë së arsyeshme  |
| 4  | Përmirësimi i të kuptuarit të funksionit të kontrollit të brendshëm                                                                            | Rishikimi dhe vlerësimi i të kuptuarit dhe funksionit të kontrollit të brendshëm nga menaxhmenti.           | Dhënja e sigurtisë së arsyeshme  |

|   |                                                                          |                                                                         |                                |
|---|--------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|
| 5 | Të ndihmohet Komuna në përmirësimin e procesit për menaxhimin e rizikut. | Rishikimi i vlerësimit që të formojë proceset për menaxhimin e rizikut. | Dhënja e sigurisë së arsyeshme |
|---|--------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|

### III. DETYRAT E AUDITIMIT

#### 3.1. Detyrat e pa zbatuara nga vitit i kaluar

#### 3.2. Auditimet e njësive/sistemeve strukturore që janë duke u zhvilluar

#### 3.3. Llojet e detyrave të auditimit

### IV. Radhitja e detyrave të planifikuara të auditimit dhe koha efektive për planin vjetor 2019.

Pas analizës së bërë sistemeve nga NJAB në Rahovec janë përzgjedhur detyrat me rrezikueshmëri të lartë, të mesëm dhe të ultë për vitin 2019 sipas shkallës së rrezikut. Detyrat e auditimit të planifikuara në planin strategjik dhe planin vjetor për Njësinë e Auditimit të Brendshëm janë si vijon:

| Nr | Njësiti e synuara të auditimit                                                               | Treguesi i rrezikut | Prioritizimi | Numri i detyrave për 2019 | Nr. i ditëve të punës për person sipas strategjisë | Gjithsejt për vitin 2019 | Nr. i detyrave për 2020 | Nr. i ditëve të punës për person sipas strategjisë | Gjithsejt për vitin 2020 | Nr. i detyrave për 2021 | Nr. i ditëve të punës për person sipas strategjisë | Gjithsejt për vitin 2021 |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|--------------|---------------------------|----------------------------------------------------|--------------------------|-------------------------|----------------------------------------------------|--------------------------|-------------------------|----------------------------------------------------|--------------------------|
|    |                                                                                              | 2                   | 3            | 4                         | 5                                                  | 6                        | 7                       | 8                                                  | 9                        | 10                      | 11                                                 | 12                       |
| 1  | <b>Drejtoria Komunale e Arsimit</b><br><br><b>Menaxhimi i të hyrave, Shpenzimet, e tjera</b> | M                   | 2            | 1                         | 15                                                 |                          | 1                       | 15                                                 |                          | 1                       | 15                                                 | 45                       |
| 2  | <b>Drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural</b>                                    | M                   | 2            | 1                         | 15                                                 |                          | 1                       | 15                                                 |                          | 1                       | 15                                                 | 45                       |

### 3.2. Auditimet e njësive/sistemeve strukturore që duhet të zhvillohen.

| Indeksi i rrezikut | Lloji i detyrës                                                                                                          | Njësia strukturore                                | Objektivi i detyrës                                                                | Fushëveprimi i detyrës                                                              | Periudha e Auditimit                               |
|--------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|
| 1.75               | Shërbim sigurie<br>Shërbime këshilluese<br>Krahasimi<br>Vëzhgimi<br>Barazimi<br>Përputhshmëria<br>Përcjellja e rekomand. | Drejtoria Komunale e Arsimit                      | Menaxhimi i të hyrave dhe Shpenzimet.                                              | Për gjashtëmuajt orshin e dytë të vitit 2018, dhe tremujorshin e parë të vitit 2019 | Prej datës 02.03 gjër 22.03. 2019<br>Muajin Mars   |
| 1.75               | Shërbim sigurie<br>Shërbime këshilluese<br>Krahasimi<br>Vëzhgimi<br>Barazimi<br>Përputhshmëria<br>Përcjellja e rekomand. | Drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural | Menaxhimi i të hyrave taksat për shëndrrimin e tokës bujqësore në tokën ndërtimore | tremujorshin e parë të vitit 2019                                                   | Prej 27.04. gjërë 15.05.2019<br>Muajin Prill - Maj |
| 1.80               | Shërbim sigurie<br>Shërbime këshilluese<br>Krahasimi<br>Vëzhgimi<br>Përputhshmëria<br>Përcjellja e rekomand.             | Zyra e Përsoneleit                                | Menaxhimi i personelit) në administratën e përgjithshme komunale                   | Rishikimi i Dosjes së Punëtoreve                                                    | Prej 20.05 – 10.06.2019<br>Muajin Maj - Qershor    |

|      |                                                                                                                               |                                                                                      |                                                                                                                                                                                                |                                                      |                                              |
|------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|----------------------------------------------|
| 1.90 | Shërbim sigurie<br>Shërbime këshilluese<br>Vëzhgimi<br>Barazimi<br>Përputhshmëria<br>Përcjellja<br>rekomandimeve              | Drejtoria për<br>Urbanizëm,<br>Planifikim<br>Hapsinor dhe<br>Mrojtje të<br>Mjedisit. | Menaxhimi i të<br>hyrave nga taksat<br>për lëshimin e lejeve<br>për ndërtim dhe<br>rregullimin e tokës<br>ndërtimore.<br>Dhe Shpenzimet.                                                       | Për<br>pesëmujori<br>n e parë të<br>vitit 2019       | Prej 15.06 –<br>05.07.2019<br>Muajin Qershor |
| 2.55 | Shërbim sigurie<br>Shërbime këshilluese<br>Vëzhgimi<br>Krahasimi<br>Barazimi<br>Përputhshmëria<br>Përcjellja e rekomand       | Drejtoria për<br>Ekonomi dhe<br>Zhvillim                                             | Menaxhimi i të<br>hyrave nga Qiraja.<br>Menaxhimi i të<br>hyrave nga taksat<br>vjetore për<br>ushtrimin e<br>afarizmit,<br>publikimin e firmës.<br>Menaxhimi dhe<br>mirëmbajtja e<br>pasurisë. | Për<br>gjashtëmuj<br>orin e parë<br>të vitit<br>2019 | Prej 10.07 –<br>30.07.2019<br>Muajin korrik  |
| 2.60 | Shërbim sigurie<br>Shërbime këshilluese<br>Vëzhgimi<br>Krahasimi<br>Barazimi<br>Përputhshmëria<br>Përcjellja<br>rekomandimeve | Drejtoria për<br>Shëndetësi<br>dhe Mirëqenje<br>Sociale<br>(QKMF).                   | Menaxhimi i të<br>hyrave nga<br>Participimi<br>Menaxhimi i<br>personelit<br>Menaxhimi i Stokëve<br>nga Barnat esenciale<br>e tjera                                                             | Tetëmuji<br>n e parë të<br>vitit 2018                | Prej 02.08 –<br>30.08.2019<br>Muajin Gusht   |

|      |                                                     |                                     |                                                                        |                                   |                              |
|------|-----------------------------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|------------------------------|
| 1.75 | Shërbim sigurie<br>Shërbime këshilluese<br>Vëzhgimi | Drejtoria për<br>Administratë<br>të | Menaxhimi i të hyrave<br>nga tarifat për lëshimin e<br>vërtetimeve dhe | Për<br>Nëntëmuji<br>të vitit 2019 | Prej 02.09 – 25<br>.09. 2019 |
|------|-----------------------------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|------------------------------|

|      |                                                                                                                               |                                                   |                                                                                                                                                                      |                                        |                                                            |
|------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|------------------------------------------------------------|
|      | Krahasimi<br>Barazimi<br>Përputhshmëria<br>Përcjellja<br>rekomandimeve                                                        | Përgjithshme                                      | dokumenteve zyrtare.<br><br>Menaxhimi dhe<br>mirëmbajtja e<br>automjeteve<br><br>Dhe Shpenzimet                                                                      |                                        | Muajin Shtator                                             |
| 2.75 | Shërbim sigurie<br>Shërbime këshilluese<br>Vëzhgimi<br>Krahasimi<br>Barazimi<br>Përputhshmëria<br>Përcjellja<br>rekomandimeve | Drejtoria për<br>Financa dhe<br>Buxhet            | Menaxhimi I proceseve të<br>tatimit mbi prone dhe<br>menagjimi I të hyrave<br>nga tatimi mbi pronë.<br><br>Dhe Shpenzimet.                                           | Për<br>Nëntëmujorshin<br>të vitit 2018 | Prej 25.09 –<br>15.10.2019<br><br>Muajin Shtator<br>-Tetor |
| 1.60 | Shërbim sigurie<br>Shërbime këshilluese<br>Vëzhgimi<br>Krahasimi<br>Barazimi<br>Përputhshmëria<br>Përcjellja<br>rekomandimeve | Drejtoria për<br>Shërbime<br>publike,<br>Komunale | Menaxhimi i të hyrave<br>nga taksat për<br>shfrytëzimin e<br>përkohshëm të hapësirës<br>publike dhe për dhënjën<br>me qira të hapësirës<br>publike.<br>Dhe Shpenzime | Për<br>nëntëmujorshin<br>të vitit 2018 | 20.10 –<br>10.11.2019<br><br>Muajin Tetor -<br>Nëntor      |
| 2.80 | Shërbim sigurie<br>Shërbime këshilluese<br>Vëzhgimi<br>Krahasimi<br>Barazimi<br>Përputhshmëria<br>Përcjellja<br>rekomandimeve | Zyra e<br>Prokurimit.                             | - Inicimi i aktiviteteve të<br>Prokurimit<br>- Proceset e Prokurimit<br>për Mallra dhe Shërbime.<br>- Prokurimi i Investimeve<br>Kapitale                            | Për<br>nëntëmujorshin<br>të vitit 2018 | Prej 15.11 –<br>30.12.2019<br><br>Muajin<br>Nëntor- Dhetor |
|      |                                                                                                                               |                                                   |                                                                                                                                                                      |                                        |                                                            |
|      |                                                                                                                               |                                                   |                                                                                                                                                                      |                                        |                                                            |

#### IV. RADHITJA E DETYRAVE TË PLANIFIKUARA TË AUDITIMIT ME STRATEGJINË E AUDITIMIT

Detyrat e auditimit të planifikuara për vitin 2019 në Planin Strategjik dhe Planin Vjetor për NjAB-në janë si vijon:

| Nr. | Njësia e synuar e auditimit                                                                                                                                                                               | Indeksi i rrezikut | Prioriteti | E planifikuar për vitin 2019 | Nr. i detyrës së auditimit |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|------------|------------------------------|----------------------------|
| A.  | B.                                                                                                                                                                                                        | C.                 | D.         | E.                           | F.                         |
| 1   | <b>Drejtoria Komunale e Arsimit</b><br><br>Menaxhimi i të hyrave dhe Shpenzimet, e tjera                                                                                                                  | 1.75               | I Mesëm    | X                            | 2                          |
| 2   | <b>Drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural</b><br><br>Të hyrat nga taksat dhe Shpenzimet.                                                                                                      | 1.75               | I Mesëm    | X                            | 2                          |
| 3   | <b>Zyra e Përsoneelit</b><br><br>Menaxhimi i personelit)në s\administratën e përgjithshme komunale                                                                                                        | 1.90               | I mesëm    | X                            | 2                          |
| 4   | <b>Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapsinor dhe Mrojtje të Mjedisit.</b><br>Menaxhimi i të hyrave nga taksat për lëshimin e lejeve për ndërtim dhe rregullimin e tokës ndërtimore.<br>Dhe Shpenzimet. | 1.80               | I Mesëm    | X                            | 2                          |
| 5   | <b>Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.</b><br><br>Menaxhimi i të hyrave nga Qiraja.<br>Menaxhimi i të hyrave nga taksat vjetore për ushtrimin e afarizmit, publikimin e firmës.                           | 2.55               | I Lartë    | X                            | 2                          |

|  |                                                                                                                                  |  |  |  |  |
|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|--|
|  | - Inicimi i aktiviteteve të Prokurimit<br>- Proceset e Prokurimit për Mallra dhe Shërbime.<br>- Prokurimi i Investimeve Kapitale |  |  |  |  |
|  |                                                                                                                                  |  |  |  |  |
|  |                                                                                                                                  |  |  |  |  |
|  |                                                                                                                                  |  |  |  |  |

Detyrat e auditimit të planifikuara për vitin 2019 përputhen me strategjinë e aprovuar të auditimit. Raporti në mes të detyrave të planifikuara në Planin Strategjik dhe në Planin Vjetor tregohet në tabelë dhe është si vijon:

| Llojet e detyrave të auditimit    | Numri i detyrave për vit | Numri i përgjithshëm i ditëve për person | Detyrat e auditimit sipas Planit Strategjik | Zbatimi i planit i shprehur në përqindje |
|-----------------------------------|--------------------------|------------------------------------------|---------------------------------------------|------------------------------------------|
| Detyrat për shërbimet e sigurisë  |                          |                                          |                                             |                                          |
| Rrezik i lartë                    | 3                        | 60                                       | 9                                           | 100%                                     |
| Rrezik i mesëm                    | 7                        | 105                                      | 21                                          | 100%                                     |
| Sipas kërkesës                    | x                        | 6                                        | x                                           | x                                        |
| Përcjellja e rekomandimeve        |                          | 28                                       |                                             |                                          |
| Detyrat për shërbimet këshilluese |                          | 20                                       |                                             |                                          |
| <b>Totali</b>                     | <b>10</b>                | <b>219</b>                               | <b>30</b>                                   | <b>100%</b>                              |

Arsyet e devijimeve nga Plani Strategjik: për vitin 2019 nuk kemi parapa devijim nga plani strategjik pasi që ditët efektive të punës i kemi marrë fikse 181 dhe i kemi shpërndarë për detyrat e punës për vitin 2017 . Kapaciteti i pamjaftueshëm për përmbushjen e planit strategjik 2019-2021 do të reflektohen në vitet vijuese.

## V. PROKURIMI I BURIMEVE DHE NDARJA E DETYRAVE TË AUDITIMIT

### 5.1. Koha efektive e punës

Koha efektive e punës kalkulohet për secilin auditor nga NjAB-ja në pajtueshmëri me strategjinë e auditimit si vijon:

### 5.2. Orari kohor për detyrat e auditimit dhe ndarja e punonjësve të NjAB-së në detyrat e auditimit.

| Tre- | Detyra e Auditimit | Prioriteti i | Ditë | Udhë |
|------|--------------------|--------------|------|------|
|------|--------------------|--------------|------|------|

| mujori |   |                                                                                                            | njësish të synuar të auditimit   | për person | heqësi i Ekipit | Anëtarët e ekipit |                        |                         |
|--------|---|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------|------------|-----------------|-------------------|------------------------|-------------------------|
| I      |   |                                                                                                            |                                  |            | BM              | Auditori          | Emri:<br>BINAK KRYEZIU | Emri:<br>RUZHDI KABASHI |
|        |   |                                                                                                            |                                  |            |                 |                   | x                      | x                       |
|        | 1 | Drejtoria Komunale e Arsimit.<br><br>Menaxhimi i të hyrave dhe Shpenzimet e tjera.                         | Rrezik i mesëm                   | 15         | 15              | 15                | x                      | x                       |
|        |   |                                                                                                            |                                  |            |                 |                   |                        |                         |
|        |   |                                                                                                            | Përcjellja e rekomandimeve       | 5          | 5               | 5                 | x                      | x                       |
|        |   |                                                                                                            | Detyrat për shërbimet këshillues | 3          | 3               | 3                 |                        |                         |
|        |   | Totali i Diteve                                                                                            |                                  | 23         | 23              | 23                |                        |                         |
| II     |   | -                                                                                                          |                                  |            |                 |                   |                        |                         |
|        | 2 | Drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural<br><br>Menaxhimi i të hyrave nga taksat dhe Shpenzimet. | Rrezik i mesëm                   | 15         | 15              | 15                |                        |                         |
|        |   |                                                                                                            | Rrezik i ulët                    | -          | -               | -                 |                        |                         |
|        |   |                                                                                                            | Përcjellja e rekomandimeve       | 5          | 5               | 5                 |                        |                         |
|        |   |                                                                                                            | Detyrat për shërbimet këshillues | 3          | 3               | 3                 |                        |                         |
|        |   | Totali i diteve                                                                                            |                                  | 23         | 23              | 23                |                        |                         |
| III    | 3 | Zyra e Personelit<br><br>Menaxhimi i personelit) në s\administratën e                                      | Rrezik i mesëm                   | 15         | 15              | 15                |                        |                         |

|    |   |                                                                                                                                                                                                    |                                    |    |    |    |  |  |
|----|---|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|----|----|----|--|--|
|    |   | përgjithshme komunale                                                                                                                                                                              |                                    |    |    |    |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                                    | Përcjellja e rekomandimeve         | 5  | 5  | 5  |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                                    | Detyrat për shërbimet këshillues e | 3  | 3  | 3  |  |  |
|    |   | Totali i diteve                                                                                                                                                                                    |                                    | 23 | 23 | 23 |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                                    |                                    |    |    |    |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                                    |                                    |    |    |    |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                                    |                                    | -  | -  | -  |  |  |
| IV | 4 | Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapsinor dhe Mrojtje të Mjedisit.<br>Menaxhimi i të hyrave nga taksat për lëshimin e lejeve për ndërtim dhe rregullimin e tokës ndërtimore.<br>Dhe Shpenzimet. | Rrezik i mesëm                     | 15 | 15 | 15 |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                                    | Rrezik i Mesëm                     |    |    |    |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                                    | Përcjellja e rekomandimeve         | 5  | 5  | 5  |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                                    | Detyrat për shërbimet këshillues e | 3  | 3  | 3  |  |  |
|    |   | Totali i diteve                                                                                                                                                                                    |                                    | 23 | 23 | 23 |  |  |

|   |   |                                                                                                                                                         |                |    |    |    |  |  |
|---|---|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|----|----|----|--|--|
| V | 5 | Drejtorin për Ekonomi dhe Zhvillim<br><br>Menaxhimi I të hyrave nga qiraja e pronës komunale<br>Menaxhimi I të hyrave nga tarifë ngarkesat e subjekteve | Rrezik i lartë | 20 | 20 | 20 |  |  |
|---|---|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|----|----|----|--|--|

|    |   |                                                                                                                                                                                           |                                         |    |    |    |  |  |
|----|---|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|----|----|----|--|--|
|    |   | afariste.<br>Menaxhimi dhe mirëmbajtja e<br>Pasurisë                                                                                                                                      |                                         |    |    |    |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                           | Rrezik i<br>Lartë                       |    |    |    |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                           |                                         | -  | -  | -  |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                           | Përcjellja e<br>rekomandi<br>meve       | 5  | 5  | 5  |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                           | Detyrat për<br>shërbimet<br>këshilluese | 3  | 3  | 3  |  |  |
|    |   | Totali i diteve                                                                                                                                                                           |                                         | 28 | 28 | 28 |  |  |
| VI | 6 | Drejtoria për Shëndetësi dhe<br>Mirëqenje Sociale.(QKMF)<br><br>Menaxhimi i të hyrave nga<br>Participimi<br>Menaxhimi i personelit<br>Menaxhimi i Stokëve nga<br>Barnat esenciale e tjera | Rrezik i<br>lartë                       | 20 | 20 | 20 |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                           | Rrezik i<br>Lart                        |    |    |    |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                           |                                         |    |    |    |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                           | Përcjellja e<br>rekomandi<br>meve       | 5  | 5  | 5  |  |  |
|    |   |                                                                                                                                                                                           | Detyrat për<br>shërbimet<br>këshilluese | 3  | 3  | 3  |  |  |
|    |   | Totali I ditëve                                                                                                                                                                           |                                         | 28 | 28 | 28 |  |  |

|     |   |                                                                                                                                                                                                                             |                |    |    |    |  |  |
|-----|---|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|----|----|----|--|--|
| VII | 7 | Drejtoria e Administratës<br>të Përgjithshme.<br><br>Menaxhimi i të hyrave nga<br>tarifat për lëshimin e<br>vërtetimeve dhe<br>dokumenteve zyrtare.<br><br>Menaxhimi dhe<br>mirëmbajtja e automjeteve<br><br>Dhe Shpenzimet | Reziku i Mesëm | 15 | 15 | 15 |  |  |
|-----|---|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|----|----|----|--|--|

|  |  |                        |                                   |           |           |           |  |  |
|--|--|------------------------|-----------------------------------|-----------|-----------|-----------|--|--|
|  |  |                        |                                   |           |           |           |  |  |
|  |  |                        | Përcjellja e rekomandimeve        | 5         | 5         | 5         |  |  |
|  |  |                        | Detyrat për shërbimet këshilluese | 3         | 3         | 3         |  |  |
|  |  | <b>Totali I ditëve</b> |                                   | <b>23</b> | <b>23</b> | <b>23</b> |  |  |

|             |          |                                                                                                                                                                  |                                   |           |           |           |  |  |
|-------------|----------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|-----------|-----------|-----------|--|--|
| <b>XIII</b> | <b>8</b> | <b>Drejtoria për Financa dhe Buxhet</b><br><br>Menaxhimi I proceseve të tatimit mbi prone dhe menagjimi I të hyrave nga tatimi mbi pronë.<br><br>Dhe Shpenzimet. | <b>Reziku I Lartë</b>             | <b>20</b> | <b>20</b> | <b>20</b> |  |  |
|             |          |                                                                                                                                                                  | <b>Reziku I Lartë</b>             |           |           |           |  |  |
|             |          |                                                                                                                                                                  | Përcjellja e rekomandimeve        | 5         | 5         | 5         |  |  |
|             |          |                                                                                                                                                                  | Detyrat për shërbimet këshilluese | 3         | 3         | 3         |  |  |
|             |          | <b>Totali I diteve</b>                                                                                                                                           |                                   | <b>28</b> | <b>28</b> | <b>28</b> |  |  |

|           |          |                                                                                                                                                                                                           |                            |           |           |           |  |  |
|-----------|----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|-----------|-----------|-----------|--|--|
| <b>IX</b> | <b>9</b> | <b>Drejtoria për Shërbime publike, Komunale</b><br><br>Menaxhimi I të hyrave nga taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike dhe për dhënjën me qira të hapësirës publike.<br>Dhe Shpenzime | <b>Reziku I Mesëm</b>      | <b>15</b> | <b>15</b> | <b>15</b> |  |  |
|           |          |                                                                                                                                                                                                           |                            |           |           |           |  |  |
|           |          |                                                                                                                                                                                                           | Përcjellja e rekomandimeve | 5         | 5         | 5         |  |  |
|           |          |                                                                                                                                                                                                           | Detyrat për shërbimet      | 3         | 3         | 3         |  |  |

|  |  |                        |             |           |           |           |  |  |
|--|--|------------------------|-------------|-----------|-----------|-----------|--|--|
|  |  |                        | këshilluese |           |           |           |  |  |
|  |  | <b>Totali I ditëve</b> |             | <b>23</b> | <b>23</b> | <b>23</b> |  |  |

|           |           |                                                                                                                                                             |                                   |           |           |           |  |  |
|-----------|-----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|-----------|-----------|-----------|--|--|
| <b>X</b>  | <b>10</b> | <b>ZYRA E PROKURIMIT</b><br>- Inicimi i aktivitetve të Prokurimit<br>- Proceset e Prokurimit për Mallra dhe Shërbime.<br>- Prokurimi i Investimeve Kapitale | <b>Reziku I Lartë</b>             | <b>20</b> | <b>20</b> | <b>20</b> |  |  |
|           |           |                                                                                                                                                             |                                   |           |           |           |  |  |
|           |           |                                                                                                                                                             | Përcjellja e rekomandimeve        | 5         | 5         | 5         |  |  |
|           |           |                                                                                                                                                             | Detyrat për shërbimet këshilluese | 3         | 3         | 3         |  |  |
|           |           | <b>Totalo i diteve</b>                                                                                                                                      |                                   | <b>28</b> | <b>28</b> | <b>28</b> |  |  |
| <b>XI</b> | <b>11</b> | <b>Sipas Kërkesës</b>                                                                                                                                       |                                   | <b>6</b>  | <b>6</b>  | <b>6</b>  |  |  |

|                                                                           |            |            |            |  |  |
|---------------------------------------------------------------------------|------------|------------|------------|--|--|
| Planifikimi vjetor 2019                                                   | 171        | 171        | 171        |  |  |
| <b>Numri i përgjithshëm i ditëve për aktivitetet e auditimit për NjAB</b> | <b>251</b> | <b>251</b> | <b>251</b> |  |  |

#### 5.4 Rezultatet nga vlerësimi i rrezikut

Tabela nr.1

| Tabela e përkufizimit të faktorit të rrezikut |                                                                                                |
|-----------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Të dhënat e faktorit të rrezikut              | Përshkrimi i faktorëve të përkufizuar të rrezikut (referohuni në Pjesën “faktorët e rrezikut”) |
| FRR1                                          | Qarkullimi i personelit                                                                        |
| FRR2                                          | Ndryshimet e aktiviteteve dhe strukturën e organizatës                                         |
| FRR3                                          | Amendamentet e rregulloreve statusore                                                          |
| FRR4                                          | Kompleksiteti i rregulloreve statusore                                                         |
| FRR5                                          | Buxheti                                                                                        |

|      |                       |
|------|-----------------------|
| FRR6 | Kontrolli i brendshëm |
|      |                       |

| Ran<br>gim<br>i | Faktori i rrezikut                                                            | FRI  | FRR2 | FRR3 | FRR4 | FRR5 | FRR6 | GJITHSEJ |
|-----------------|-------------------------------------------------------------------------------|------|------|------|------|------|------|----------|
|                 | Rëndësia                                                                      | 0.15 | 0.1  | 0.2  | 0.15 | 0.25 | 0.15 | 1        |
|                 | Fushat e auditimit<br>(referohun në<br>pjesën "Fushat e<br>auditimit")        |      |      |      |      |      |      |          |
| 1               | Proceset e<br>prokurimit për<br>mallra dhe<br>shërbime,<br>Komunalit          | 3    | 3    | 3    | 3    | 3    | 3    | 2.80     |
| 1               | Prokurimi i<br>investimeve<br>kapitale                                        | 3    | 3    | 3    | 2    | 3    | 2    | 2.60     |
| 2               | Menaxhimi i<br>personelit)në<br>s\administratën e<br>përgjithshme<br>komunale | 2    | 2    | 1    | 1    | 2    | 2    | 1.65     |
| 2               | Menaxhimi i<br>personelit në<br>drejtorit                                     | 3    | 3    | 1    | 1    | 3    | 3    | 2.3      |
| 2               | Menaxhimi i<br>personelit në<br>Drejtorin e<br>shëndetësisë                   | 3    | 3    | 1    | 1    | 3    | 3    | 2.3      |
| 4               | Të hyrat nga<br>participimi<br>shëndetësor i<br>qytetarëve                    | 2    | 2    | 2    | 3    | 3    | 3    | 2.6      |
| 3               | Të hyrat nga<br>participimi                                                   | 2    | 2    | 2    | 3    | 3    | 3    | 2.6      |
| 5               | Të hyrat nga<br>tarifë ngarkesat                                              | 2    | 2    | 2    | 3    | 2    | 3    | 2.3      |
| 2               | Të hyrat nga<br>taksat komunale                                               | 3    | 2    | 1    | 2    | 3    | 2    | 2.2      |
| 5               | Të hyrat nga<br>donacionet                                                    | 1    | 2    | 1    | 2    | 2    | 2    | 1.65     |
| 4               | Të hyrat nga<br>shërbimet<br>administrative                                   | 1    | 1    | 1    | 2    | 2    | 2    | 1.55     |
| 3               | Subvencionet dhe<br>transferet                                                | 1    | 1    | 1    | 3    | 2    | 2    | 2.5      |
| 1               | Shpenzimet                                                                    | 2    | 3    | 2    | 3    | 3    | 3    | 2.7      |
| 5               |                                                                               | 2    | 2    | 3    | 3    | 3    | 2    | 2.6      |

|   |                          |   |   |   |   |   |   |     |
|---|--------------------------|---|---|---|---|---|---|-----|
|   | transferet               |   |   |   |   |   |   |     |
| 1 | Shpenzimet               | 2 | 3 | 2 | 3 | 3 | 3 | 2.7 |
| 5 |                          | 2 | 2 | 3 | 3 | 3 | 2 | 2.6 |
| 4 | Menaxhimi i autommjetrve | 2 | 2 | 2 | 3 | 3 | 2 | 1.6 |
| 2 | Paraja e gatshme         | 1 | 2 | 2 | 2 | 2 | 1 | 1.7 |


|                          |     |  |  |     |  |     |  |
|--------------------------|-----|--|--|-----|--|-----|--|
| KEP për secilin auditorë | 251 |  |  | 251 |  | 251 |  |
| Drejtori i NJAB          | 1   |  |  | 1   |  | 1   |  |
| Numri i Auditoreve       | 1   |  |  | 1   |  | 1   |  |

Nga koha për zbatimin e detyrave të auditimit sipas planifikimit strategjik 2019-2021, për vitin 2019 të cilat janë 251 ditë, për auditim.


Njësia e auditimit të brendshëm planifikon 60% të kohës efektive të punës.

Në rast të kërkesës për ndonjë auditim nga Zyrtari Kryesor Administrativ, Njësia e auditimit të brendshëm do të bëjë ndryshim/plotësimin e planit vjetor varësisht se në cilën periudh kohore bëhet kërkesa.

Sugjerohet se një mori detyrash të auditimit janë të përfshira në planin vjetor.

  
(Nënshkrimi i Udhëheqësit të NJAB)

  
( Nënshkrimi i Kryetarit të Komunës)

  
(Nënshkrimi i Udhëheqësit të KA)



## PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.12.2018** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi. **Kryesuesi** – Përsëritet për kryetarin e komunës z. Smajl Latifi, nënkryetarin e komunës z. Fatmir Iska, për monitoruesit e LMT-së, monitoruesit e OSBE-së, përfaqësuesit e mediave, drejtorët e drejtorive komunale, delegatët e kuvendit komunal dhe gjithë të pranishmit. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

## REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit që të jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për hapjen e rrugës publike “Edit Durham”,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2019,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i plotësim ndryshimit të Rregullores për Taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoha dhe,
7. Shqyrtimi i Raportit të komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave lokal.

**Kryesuesi** – Në shenjë të respektit dhe nderimit për policin e vrarë në detyrë z. Izet Demaj ju kërkoj që të mbajmë një minutë heshtje, Lavdi veprës së policit Izet Demaj. Tani të nderuar e qes në votim rendi e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

### 1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar.

A ka dikush ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në aprovim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar Procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

### 2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

**Kryesuesi** – A ka ndonjëri nga drejtorët që nuk ju është përgjigjur pyetjeve nga mbledhja e kaluar, nëse ka atëherë mundeni të dilni që të ju përgjigjeni pyetjeve të parashtruara nga kuvendarët, sipas zyrarit të zyrës së kuvendit disa drejtor përgjigjet kuvendarëve ju kanë përcjellë me anë të emailit. Fjalën e keni ju kuvendarë që të parashtroni pyetje ekzekutivit.

**Afrim Berisha** – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, do ja drejtoj një kërkesë Drejtorit të Shërbimeve Publike z. Përparim Krasniqi, i nderuar drejtor nxënësit të cilët vijojnë mësimin në shkollën e mesme

“12 Maji” në fshatin Ratkoc, relacioni Dejnë – Ratkoc, ndjehen të rrezikuar gjatë shkuarjes për në shkollë pasi kjo rrugë nuk ka as trotuare e as ndriçim publik. Kërkoj nga ju i nderuar që të keni parasysh këtë kërkesë. Pyetjen e dytë do ja drejtoj z. Avni Morina Drejtorit të DKA-së, pyetje ime ka të bëjë rreth krijimit të Aktivëve Profesionale të Mësimdhënësve, kisha dashur të di se cili është qëllimi i themelimit.

**Fehmi Cena** – Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike, konkretisht për rrugën “Dëshmorët e Pashtrikut”. I nderuar në këtë rrugë janë vendosur shtyllat për ndriçim publik, po ashtu edhe ndriçimi është në rregull, por janë të hapura disa gropa të thella tek çdo shtyllë gati deri 1m<sup>2</sup>, dhe si pasojë e kësaj është vështirësuar kalimi si për automjete ashtu edhe për këmbësorë. Kërkoj nga Drejtori i Shërbimeve Publike që këtë punë të mos ja pranojë punëkryesit sepse nuk është kryer komforë standardeve dhe ka nevojë për rekonstruktim. Gjithashtu kjo rrugë në një vend ka nevojë edhe për një kanale të shkurtë kullues për ujërat atmosferike sepse sa herë që bije shi grumbullohet uji dhe një pjesë e kësaj rruge bëhet sikurse liqen, pastaj kalimi në këtë rrugë nga këmbësorët e sidomos nga fëmijët bëhet e pakalueshme. Jam i gatshëm që të i dalë në ndihmë kompanisë që të i tregojë saktësisht se ku ka nevojë kjo rrugë të rinovohet sepse është rruga në të cilën edhe unë banojë.

**Florida Bajraktari** – Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike, rruga e cila të shpije nga Rahoveci për në fshatrat Drenoc, Senoc dhe fshatrat e tjerë, ka disa muaj që janë evidentuar disa shenjë në rrugë për tu vendosur vijat e bardha, jam duke kaluar shumë shpesh në këtë rrugë dhe ende deri më tani nuk është përfunduar kjo punë, tani në stinën e dimrit është shumë e rrezikshme të kalohet në këtë rrugë nëse nuk ka sinjalizues, pyetje ime është kur do të përfundoj kjo punë.

**Përparim Krasniqi** – Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, I nderuari z. Afrim Berisha për këtë vite është mbyllur gjithçka sepse është mbyllur viti fiskal 2017-2018, në buxhetin e këtij viti nuk është paraparë ajo pjesë, por ne për vitin e ardhshëm e kemi parasysh se çka do të bëjmë me këtë rrugë, besoj se këtë rrugë do të fusim në planifikim për vitin 2019. Sa i përket ndriçimit publik edhe fshati Dejnë është përfshirë në kontratën ekzistuese, por ne nuk kemi mundur deri përfundojmë këtë vit për arsye se kemi një investim që e kemi filluar në fshatin Xërxë nuk mundemi që të fillojmë me vendbanime të tjera. Kurse sa i përket pyetjes së z. Fehmi Cena, po i nderuar ne në rrugën “Dëshmorët e Pashtrikut” kemi bërë një investim në rrjetin e ri të ndriçimit publik, e dimë që ka disa defekte ose lëshime, por për shkak të ngricave ne nuk mundemi tani të i sanojmë këto defekte, por ne i nderuar nuk do ja pranojmë punën punë kryesit deri në atë moment që e bije rrugën në nivelin e duhur. Sa i përket çështjes së ujërave atmosferikë i kisha lutë këshillat e lagjeve që ti bëjnë kërkesat zyrtare, dhe me ato kërkesa të i drejtohen drejtorisë, pastaj ne si drejtori do të dalim në teren ku do e verifikojmë gjendjen dhe do ta shohim se çka mundemi të bëjmë në Pranverë. E nderuara

znj. Florida Bajraktari është e vërtetë ne i kemi vendosur pikat orientuese në rrugën Rahovec – Sarosh, por për arsye të temperaturave të ulëta nuk kemi mundur që ti vendosim shenjëzimin horizontal, sepse nëse e bëjmë në këtë kohë ka mundësi që të shlyhen shumë shpejtë. Por me ngritje të temperaturave ne do të i vendosim edhe këto shenjëzime që na kanë mbetur në të gjitha segmentet rrugore. Ne këtë vite edhe pse kemi pasur mungesë të buxhetit, ne i kemi bërë disa shenjëzime në qytet dhe në disa vendbanime të tjera, të gjitha këto kompania i ka kryer pa asnjë pagesë, sepse ene nuk kemi pasur mjete për këtë vit.

**Avni Morina** - Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari z. Afrim Berisha themelimi i aktiveve profesionale në nivelin e DKA-së, kjo është një punë të cilën e kemi nisur dje, ideja ka qenë që në nivel të DKA-së të formojmë një ekip për monitorim dhe vlerësim të cilësisë në arsim, siç e dimë se në kuadër të tërësisë së programeve e cila quhet Korikulë janë të përfshirë 7 fusha dhe në secilën nga këto fusha ne dje kemi formuar shtatë aktive profesionale dhe një tjetër aktiv profesional i cili përfshin nivelin para fillor dhe nivelin fillor të ulët. Qëllimi i themelimit të këtyre aktivëve profesionale është se kryesuesit e këtyre aktive profesionale do të jenë pjesë e ekipit profesional për monitorim dhe vlerësim, të cilët do të mbikëqyrën dhe drejtohen nga i DKA-ja, në mënyrë që realizimi i plan programeve mësimore të bëhet në mënyrë unike në të gjitha shkollat. Kjo ka qenë nevojë domosdoshme për të themeluar këtë mekanizëm për arsye se gjatë vizitave që kemi pasur nëpër shkolla e kemi vërejtur se realizimi i plan programeve nuk bëhet dhe ka

laramani të plan programeve, ne jemi që të bëhet një sistem unik i plan programeve dhe në këtë mënyrë do të ngritet një sistem i sigurimit të cilësisë përmes monitorimit direkt nga DKA-ja. Sa për dijeninë tuaj Prishtina është e parë që e ka formuar këtë ekip, kurse ne si komunë jemi të dytët, tjera komuna nuk e kanë.

**Kryesuesi** – Ju faleminderit për pyetjet e bërë, po ashtu i falënderoj edhe drejtorët e drejtorët për përgjigjet e dhëna. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

### **3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit që të jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për hapjen e rrugës publike “Edit Durham”.**

**Afrim Oruçi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, para jush keni propozim vendimin e Kryetarit të komunës që të i jepet pëlqimi që të iniciohet procedura për shpronësimin e pronës së paluajtshme private në interes të përgjithshëm për hapje të kësaj rruge. Kjo rrugë faktikisht është e hapur dhe e qarkullueshme, është shtruar para disa viteve, kjo rrugë gjendet në dalje të Rahovecit tek rruga “Xhelal Hajda” afër rrethit, kjo pronë është private numri kadastral është 06163/1, në emër të Anife Hajredin Rama, sipërfaqja e përgjithshme e kësaj parcele është 25 ari e 33m<sup>2</sup>, nga kjo sipërfaqe të pronës private ju është marrë një pjesë prej 1 ari e 48m<sup>2</sup> për rrugë në mirëbesim në atë kohë. Pala në fillim ka bërë kërkesë në drejtori, më vonë ju është drejtuar edhe agjensionit, pasi që ka marr nga këto dy organe vendime negative, ju është drejtuar gjykatës themelore në Prishtinë ku pastaj e njëjta e ka fituar kontestin, ku pastaj gjykata ka kërkuar nga ne që ta rishqyrtojmë vendimin tonë. Kërkoj nga ju që pasi të rishqyrtoni ta përkrahni këtë propozim vendim në mënyrë që të zhvillohen procedurat për shpronësim.

**Rasim Fazliu** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kjo pikë është shqyrtuar edhe në KPF, drejtori na informojë se kjo rrugë është hapur para disa viteve dhe tani është funksionale, por tani ajo që na ka mbetur është që të bëhet shpronësimi sepse pala e ka fituar kontestin gjyqësor dhe të drejtën për shpronësim. Ne gjithsesi që duhet të marrim një vendim si kuvend komunal, por ajo që më intereson mua është: A ka pasur marrëveshje paraprake mes palës dhe komunës, apo nuk ka pasur fare dhe cila është arsyeja që tani pala kërkon kompensim, apo një herë kanë kërkuar që ti rregullohet rruga dhe pastaj kanë kërkuar kompensim, ashtu siç jemi mësuar ne. Do ju jepja një sugjerim ose këshill siç do ti pranoje, por kishte me qenë mirë që në të ardhmen pavarësisht ku shtrohet një rrugë, së pari të i shikojë procedurat se mos është pronë private apo publike, pastaj të fillohet me meremetim ose zgjerim të rrugëve.

**Dervish Çadraku** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne kemi biseduar edhe më herët rreth kësaj teme në KPF, por megjithatë unë edhe më herët e kam theksuar se nuk është mirë që në çdo mbledhje të na vinë pikat e këtij lloji, kishte me qenë mirë që pikat e kësaj natyre të vinë si pako në një mbledhje të kuvendit dhe në këtë mënyrë ne nuk do të humbim shumë energji ne si kuvendarë. Pastaj ajo që mua më bënë më shumë përshtypje është se marrëveshjet kur bëhen me palët kishte me qenë mirë që të bëhen me shkrim, në mënyrë që pastaj të mos kenë mundësi të lëvizin nga marrëveshjet e bëra, sepse hapja e kësaj rruge nuk do të shpërbej vetëm për një familje por do ti shërbej të gjithë qytetarëve. Ndërsa tani këtu na dele se në atë kohë janë pajtuar që të hapet rruga, kurse tani është duke kërkuar kompensim nga komuna, sipas kësaj në fillim ata ju kanë drejtuar Drejtorisë së Kadastrës, pastaj në artë kërkesë na dele që ata nuk kanë ditur që ti drejtohen atyre që janë kompetentë dhe i kthehet ankesa si e pabazë, pastaj ata fillojnë që të merren me procedura më serioze, e kush fiton këtu, fiton pala kurse humbë komuna, sepse kur të shkojë në procedura gjyqësore kjo teme normalisht dikush duhet të paguaj ato shpenzime.

**Fehmi Cena** – Pajtohem me parafolësit rreth asaj se duhet të bëhet marrëveshje në fillim në mes palës dhe komunës, kjo është një rrugë që ne të gjithë e dimë ku është dhe e kemi të qartë, në bazë të skicës shihet se është një rrugë vërtet publike dhe i lidhë dy rrugët kryesore të qytetit. Prandaj mendoj se kur janë në pyetje këso rrugë të cilat kanë interes publikë, mendoj se komuna duhet që të angazhohet edhe për kompensim nëse ka nevojë sikurse që është ky rast.

**Afrim Oruçi** – I nderuari z. Rasim Fazliu komuna nuk ka pasur kurrfarë marrëveshje me këtë palë, po ashtu nuk ka pasur marrëveshje as me palët e tjera të cilat kufizohen me ke këtë rrugë, të cilët i kanë lëshuar në

mirëbesim parcelat për zgjerim të kësaj rruge. Ne para se me vendos që të kërkojmë nga ju pëlqim për shpronësim kemi dalë në vendin e ngjarjes me gjeodetë, ku kemi menduar se në rast se rruga me pronë publike i plotëson e një rruge të mirë të kalueshme atëherë ne ju kishim drejtuar palës dhe i kishim thënë se ne nuk kemi nevojë për pronën tënde dhe ne kishim vazhduar me pjesën publike. Por neve na ka dalë që pjesa publike e rrugës pak më shumë se 2m, prandaj ne jemi detyruar që në mënyrë kjo rrugë të jetë funksionale ta iniciojmë këtë procedurë. Sa i përket marrëveshjeve të tjera brenda kësaj qeverisje 1 vjeçare, ne kemi zhvilluar edhe punë të tjera siç është kanali në fshatin Celinë, ku kemi mare shumë prona private, por asnjë centimetër nuk e kemi hapur pa bërë marrëveshje me shkrim me palët, se të njëjtët janë duke u akorduar dhe pajtuar me ne që janë duke na lëshuar me vullnet të tyre pronën private, në të mirë të fshatit dhe janë deklaruar se në të ardhmen nuk do të kërkojnë asnjë lloje shpronësimi. Pra është parim i qeverisjes sonë që në të ardhmen çdo rrugë ose kanal që kemi të bëjmë me pronë private së pari të bëjmë një marrëveshje me shkrim dhe do të kërkojmë nga pronari që ta kthejë pronën nga prona private në atë publike, pastaj të fillojmë me punime. I nderuari z. Dervish Çadraku këto pika nuk mundën të vinë në kuvend si pako, sepse ne nuk e dimë se si do na vinë në të ardhmë vendimet nga gjykata. Kjo palë ka drejtuar një ankesë në mandatin e kaluar në zyrat e gjeodezisë, ne gjithashtu edhe palëve të tjera i deklarohemi se nuk kemi mundësi shpronësimi sepse këto kushtojnë dhe komuna nuk ka buxhet, të njëjtën përgjigje ja ka dhënë edhe agjensioni kadastral i Republikës së Kosovës, por pala ka pas të drejtë ankese dhe ju ka drejtuar gjykatës administrative.

**Dervish Çadraku** – Pyetje lindë nëse ne këtë pikë nuk e kalojmë çka di të ndodhë, prandaj jam duke thënë se nuk ka nevojë që të shkojnë këtë gjëra deri në gjykatë sepse prapëseprapë komuna është ajo që duhet të ja kompensoj, për këtë e kisha unë fjalinë se ne nuk mundemi ta kundërshtojmë vendimin e gjykatës.

**Kryesuesi** – E qes në votim Propozim vendimin e Kryetarit që të jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për hapjen e rrugës publike “Edit Durham”: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tretë (3) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

#### **4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit.**

**Samir Mustafa** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Duke u bazuar në nenin 11, nenin 13 dhe nenin 58, shkronja (j) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040 dhe nenit 9, nenit 40, nenit 74 dhe nenit 92, të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës I propozon Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit me të cilin i lejohej Kryetarit të Komunës, që në interes të qytetarëve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit të lidh marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e Komunës së Rahovecit, pakoja e shërbimeve primare të definohet në marrëveshje të re dhe ajo nuk mund të ketë koston më të lartë se 190 euro për një rast, ndërsa për shërbime të tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes, qytetarët do t'i sigurojnë ato personalisht. Shërbimet të cilat do të jenë pjesë e marrëveshjes, në asnjë rast nuk mund të kushtëzohen me pagesat e anëtarësive fetare apo të tjera. Pagesat nga shërbimet e varrimit do të kryhen nga kodi i Mallrave dhe Shërbimeve, prandaj të nderuar ju ftoj që ta përkrahni këtë propozim vendim.

**Rasim Fazliu** – Që nga momenti që komuna e Rahovecit gjegjësisht kuvendi komunal ka marr vendim që ti mbulojë shpenzimet e varrimit mendoj se është një vendim shumë i mirë, kjo ka dëshmuar edhe në teren sepse të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit kanë qenë të kënaqur, dhe besoj se kjo ka qenë e mirëseardhur për të gjithë. Por ajo që desha të them është se nga qeverisja në qeverisje është duke u bërë pak si lojëra nëse me lejohej kështu të them, do të ishte mirë që një vendim të jetë për të gjithë i njëjtë pasi merret për çdo vit, por shërbimi është shërbim, ne në fillim kemi mare një venim që të paguhet nga 200.00 €, pastaj asi erdhe qeverisja e juaj është mare vendim 180.000 €, tani ju jeni duke kërkuar që të bëhet 190.000, vitin e ardhmë do kërkonin që të bëhet 200.00 € e kështu me radhë. Për vete nuk kam qenë pro i këtyre lëvizjeve në çmime, për neve është shumë me rëndësi që të bëhen shërbimet cilësore në mënyrë që të ndahen të kënaqur të gjithë. Tek neni 3 i vendimit më duket pak si imponim, kurse në fakte ky duhet të jetë

një propozim nga kryetari, po e citoj nenin 3: Pakoja e shërbimeve primare të definohet në marrëveshje të re dhe ajo nuk mund të ketë koston më të lartë se 190 euro për një rast, konsideroj se kuvendi është ai i cili merë vendim se sa duhet të jetë kostoja për një rast vdekje, mendoj fjalimi tek neni 3 është dashur të formulohet pak më ndryshe, përndryshe si vendim është në rregull dhe nuk kemi arsye që ta kundërshtojmë.

**Ali Morina** – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, kam zhvilluar disa biseda me qytetarët e anadrinisë dhe komunitetin fetar të asaj ane, ata kanë shprehur pakënaqësi sa i përket përmbushjes së marrëveshjes në disa raste e cila bëhet mes komunës dhe Bashkësisë Islame, jo në të gjitha rastet atë e bëjnë transportin e kufomave nga shtëpia deri tek vend falja, dhe nga vend falja e deri tek varrezat, ka raste kur ata e refuzojnë që të bëjnë transportin nga shtëpia e deri tek vend falja, por e bëjnë nga vend falja deri tek varrezat, kurse në venim është e përcaktuar që të bëhet në të dyja rastet. Po ashtu tek pika e 8 e llojit të shërbimeve ceket se qytetarëve ju ofrohen afishet apo fletë lajmërimi deri në 20 copa, ndoshta edhe kjo është mënyra e mirë e informimit por tek ne në komunën tonë praktikohet pak, sepse ne të gjithë e dimë formën e informimit se si bëhet tek ne pra përmes hoxhallarëve në xhamitë tona, arsyeja pse e them këtë është se ndoshta qytetorët i marrin këto afishe dhe nuk i shfrytëzojnë ato. Sugjerimi imë është që këto mjete prej 10.00 € që janë të parapara për këtë kategori të ndryshohet dhe të ju sigurohet qytetarëve letra e zezë, kjo letër e zezë nuk ofrohet por vetë familjarët janë të detyruar që të paguajnë shumën prej 10.00 €, konsideroj se kishte me qenë më në interes për qytetorët që të ju ofrohet letra e zezë se sa këto afishe.

**Kryetari** – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, e përcolla me vëmendje diskutimin e z. Rasim Fazliu, e vërteta është se ne e patëm lutur Bashkësinë Islame në Rahovec që për vitin 2018 të kenë pak konsideratë për sa i takon shumës, sepse natyrisht është një kosto e këtyre shërbimeve, kurse ne si komunë ndoshta kemi pasur nevojë që të zbret kjo shumë ndoshta edhe për 10.00 € më pak, në negociatat që i kemi pasur ka qenë një dakordim që 180.00 € - 190.00 € të jetë shuma. Kurse tani ne jemi akorduar me Bashkësinë Islame në Rahovec që për vitin 2019 të jetë shuma 190.00 €, prandaj aty është duke u cekur se mundet të arrihet një marrëveshje e re. Shërbimet e varrimit besoj se kanë nevojë që të avancohen në vazhdimësi nga viti në vit, ka nevojë ndoshta të korrigjohet edhe ndonjë mungesë të cilën munden ta shprehin familjet tona, prandaj ne pasi të mirët vendimi i kuvendit nga ana e juaj do të ulemi me Këshillin e Bashkësisë Islame ku do të shohim se çka duhet të përmirësohet në këto shërbime. Por për një gjë jam i bindur se të gjithë jemi të pajtimit se ky bashkëpunim duhet të vazhdojë, është një traditë që është materializuar për herë të parë në qeverisjen e kaluar dhe duhet të vazhdojë në çdo qeverisje deri sa të zgjidhet një zgjidhje në shkallë republike. Edhe ne i kemi disa vërejtje sepse kishte me qenë mirë ndoshta pak të avancohet shërbimi, por meqenëse tradita nuk është shumë e gjatë, por me siguri më të madhe e them se ky shërbim do të ketë avancim në të ardhmen. Ju ftoj që të aprovoni këtë Propozim vendim me këtë shumë, por përsëri ju jeni ata që vendosni se duhet të jetë shuma.

**Kryesuesi** – E qes në votim Propozim vendimin e Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e katërt (4) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

##### **5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2019.**

Të nderuar kuvendar/e anëtarët e KPF-së si dhe anëtarët e Komitetit për Komunitete në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorive Komunale në bashkëpunim me OSBE0-në e cila ka qenë edhe organizatore e kësaj punëtorie me datë 04.12.2018, kemi mbajtur një punëtori rreth hartimit të Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2019. Gjatë kësaj punëtorie kemi diskutuar dhe jemi pajtuar që për vitin 2019 të kemi këtë Plan të Punës që e keni secili para vete, nëse ka dikush të shtoj diçka sa i përket këtij plani fjala është e juaja.

Meqenëse nuk kemi të lajmëruar asnjë kuvendar/e për të marrë fjalën rreth Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2019, atëherë e qes në aprovim Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2019: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e pestë (5) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

**6. Shqyrtimi dhe aprovimi i plotësim ndryshimit të Rregullores për Taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.**  
**Fatmir Iska** - Përsëritet për të gjithë të pranishmit në sallë, kjo pikë është diskutuar edhe në KPF, kemi të bëjmë me një taksë që është zbatuar edhe më herët, kjo rregullore është e certifikuar nga MAPL-ja, është një taksë që ngarkohen qytetarët kur e bëjnë regjistrimin e automjeteve, por për shkak të një gabimi teknik është bërë në kohën kur është aprovuar nuk është përfshirë kjo taksë në këtë rregullore. Ne e kemi shikuar procesverbalin e mbledhje kur është aprovuar kjo rregullore me datë 28.02.2018 dhe askush nuk ka diskutuar rreth kësaj rregullore ose me saktë rreth kësaj takse. Ne sot kemi propozuar që të përmirësohet ky gabim teknik dhe këtë vendim ne e dërgojmë përsëri në MAPL dhe me këtë e plotësojmë këtë rregullore me këtë taksë.

**Rasim Fazliu** – Të nderuar besoj se edhe për këtë nuk kemi se çka të bisedojmë, kjo i ka munguar rregullores aktuale që është në fuqi, mendoj se është mirë që është vërejtur ky lëshim, ne si grup i PDK-së jemi pro këtij plotësimi të kësaj rregullore.

**Kryesuesi** – E qes në votim Plotësim ndryshimit të Rregullores për Taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e gjashtë (6) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

**7. Shqyrtimi i Raportit të komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave lokal.**

**Rexhep Oruçi** – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, të nderuar do raportoj në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave lokal. Ky komision është formuar po nga ky kuvend, po nga kjo legjislaturë, përbërja e këtij komisioni është: unë z. Rexhep Oruçi përfaqësues i PDK-së, z. Faton Ramadani përfaqësues i LDK-së, z. Afrim Berisha përfaqësues i AAK-së, z. Përparim Krasniqi Drejtor i Shërbimeve Publike i deleguar nga ana e Kryetarit të Komunës, znj. Saranda Sellteku Drejtoresh e Administratës së Përgjithshme po ashtu e deleguar nga ana e Kryetarit të Komunës, z. Adnan Rexha, përfaqëson Shoqërinë civile SHHL- Kosova- Rahovec, po ashtu në secilin fshat kemi pasur nga një përfaqësues. Ky komision ka punuar me punë intensive që nga data 16.11.2018 deri me 14.12.2018, paraprakisht rreth zgjedhjes së këshillave lokalë së pari qytetarët janë informuar përmes zyrës së informimit për orarin dhe vendin e mbajtjes së takimeve publike për secilin fshat dhe lagje urbane. Mendoj se në përjashtim të disa mjediseve ku kryetaret e fshatrave të cilët nuk i kanë informuar banorët por edhe ata vetë nuk anë qenë të angazhuar sa duhet, por në shumicën e fshatrave është kryer me sukses, ku janë zgjedhë këshillat dhe kryetarët e këshillave si të fshatrave ashtu edhe të lagjeve urbane të qytetit të Rahovecit. Një ndihmesë të jashtëzakonshme e kemi pasur nga znj. Nora Boshnjaku, e cila e ka kryer funksionin e procesmbajtjes dhe administres së këtij komisioni. Është tentuar që të përfaqësohet edhe struktura gjinore në ato vendbanime ku ka pasur mundësi si në ato fshatra më të mëdha që janë, mendoj se është bërë një punë e mirë, mundet të ketë ndonjë gabim teknik në këtë raport për megjithatë mendoj se është bërë një punë e mirë. Falënderoj anëtarët e komisionit, po ashtu edhe Kryesuesin e Kuvendit sepse është angazhuar maksimalisht në shumicën e tubimeve në çdo mjedis ka qenë prezent.

**Kryesuesi** – Personalisht ju përgëzoj për punën e bërë si komision, e di që e keni pasur një aktivitet bukur shumë të ngjeshur, por mendoj se e keni kryer jashtëzakonisht me sukses.

**Rasim Fazliu** – I falënderoj për punën e bërë, e di vetë se si është sepse kam qenë në mandatin e kaluar vetë i përfshirë në këtë komision, kryetari i komisionit z. Rexhep Oruçi na informojë rreth punës së këtij komisioni, por pyetje ime për z. Rexhep Oruçin është: Përveç këtij dokumentacioni ose raport që na keni ofruar, a ka edhe ndonjë material tjetër ose dosje e këtij komisioni të cilën nuk keni mundur ta sillni këtu, apo ky është material i vetëm i punës së këtij komisioni për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave lokal. Në rregullore shkruan qartë se duhet të jenë procesverbalet nga secila mbledhje, pastaj nënshkrimet e pjesëmarrësve etj. ne në këtë raporte këtë nuk e kemi të bashkangjitur.

**Rexhep Oruçi** – I nderuar materiali ka qenë tejet voluminoz, ne e kemi mbajtur evidencë të saktë të çdo qytetari i cili ka marrë pjesë në këto tubime me emër dhe mbiemër, pastaj janë të evidentuar çdo këshill i

fshatrave, ka qenë e pamundur që i gjithë materiali të përfshihet, përndryshe i gjithë materiali është i arkivuar në zyrat kuvendit.

**Ali Morina** – Falënderoj anëtarët e komisionit për punën që e kanë bërë, sepse e kanë bërë një punë shumë intensive dhe të mundimshme, por ajo që kisha kërkuar unë nga ekzekutivi i komunës që të gjendet një formë e pagesës për kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, ngase deri më tani të gjithë punën që e kanë bërë e kanë bërë në baza vullnetare. Prandaj një pagesë sado simbolike do të rriste efikasitetin e punë së tyre, po ashtu do ti stimulonte për punë më të madhe.

**Fehmi Cena** – Sa raportit është një raport mjaftë i qartë dhe gjithëpërfshirës edhe pse është goxha voluminoz, përgëzoj komisionin për punën që e ka bërë dhe në veçanti për këtë raporte të qartë që na kanë sjellë. Kisha me i përmend disa gjëra por njëherën z. Ali Morina e potencoi sa i përket pagesës së mëditjeve për kryetarët e këshillave. Ne e kemi cekë këtë problem edhe më herët se kryetarët e këtyre këshillave nuk paguhën fare, përderisa e kemi Këshillin e Hoçës së Madhe që paguhet jo vetëm Kryetari por edhe anëtarët e këtij këshilli, e di që kjo është e bërë me një ligj të veçantë, por edhe ne si kuvend duhet të bëjmë të mundur që së paku kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane të kompensohen në emër të shpenzimeve. Një tjetër element që desha të ceki është ajo që e përmendi z. Rexhep Oruçi sa i përket kuotës gjinore, e cila në këtë zgjedhje lenë shumë për tu dëshiruar. Diçka tjetër që desha të ceki është se gjatë këtyre tubimeve qytetarët kanë pasur pak vërejtje rreth kushteve të organizimit, pra rreth vendeve ku janë mbajtur tubimet, propozoj që në të ardhmen në ato vende ose lokalitete ku ka mundësi, sikurse në qytet dhe në disa fshatra ku ka shtëpi të kulturës të organizohen aty zgjedhjet sepse janë kushtet më të mira.

**Kryesuesi** – Të nderuar shfrytëzoj rastin që të gjithëve të ja uroj vitin e ri 2019 dhe të ju falënderoj për kontributin e dhënë në mbledhjen e sodit, me kaq përfundon mbledhja mirupafshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 14:45

01 Nr.

Rahovec, 28.12.2018

Procesmbajtësi

---

Skender Hamza

K R Y E S U E S I

---

Afrim Dina




Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo  
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipal of Rahovec



Drejtoria për Buxhet dhe Financa  
Odeljenje za Finansije i Budzet  
Department of Finance and Budget

---



# RAPORT FINANCIAR

## JANAR – DHJETOR 2018

JANAR 2019

**Përmbajtja**

|                                                                                                       |           |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>HYRJE.....</b>                                                                                     | <b>3</b>  |
| <b>1. TË HYRAT VETANAKE .....</b>                                                                     | <b>4</b>  |
| 1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2017/2018. ....                       | 4         |
| 005 | SERVISIMI I APARATEVE PËR SHUARJEN E ZJARREVE                                                                                                      | 23.02.2018                                  | 13.03.2018                                  | 22.03.2018                                  | 22.03.2018 - 21.03.2019                                                        | 22.03.2018 - 21.03.2019                                                           | 21.03.2019                                                                   | € 4,302.50                      | € 3,890.00                                              | € 0.00                                                        |
| 006 | FURNIZIM ME PAISJE, VEGLA PËRCJELLESE DHE UNIFORMA PËR ZIARRËFIKËS - Loto II - FURNIZIM ME UNIFORMA PËR ZIARRËFIKËS                                | 12.03.2018                                  | 06.04.2018                                  | 04.05.2018                                  | 04.05.2018 - 03.05.2019                                                        | 04.05.2018 - 03.05.2019                                                           | 03.05.2019                                                                   | € 4,300.00                      | € 4,013.00                                              | € 0.00                                                        |
| 006 | ZIARRËFIKËS - Loto I - BLERIA E PAISIEVE DHE VEGLAVE PËRCJELLESE PËR ZIARRËFIKËS                                                                   | 21.06.2018                                  | 18.07.2018                                  | 07.08.2018                                  | 07.08.2018 - 07.02.2019                                                        | 07.08.2018 - 07.02.2019                                                           | 07.02.2019                                                                   | € 10,700.00                     | € 10,560.00                                             | € 0.00                                                        |
| 007 | SHËRBIET E TRANSMETIMIT TË KUVENTIT DHE SHËRBIME TË TJERA PËR KOMUNËN E RAHOVECIT                                                                  | 19.03.2018                                  | 06.04.2018                                  | 19.04.2018                                  | 19.04.2018 - 18.04.2019                                                        | 19.04.2018 - 18.04.2019                                                           | 18.04.2019                                                                   | € 5,004.00                      | € 4,608.00                                              | € 0.00                                                        |
| 008 | FURNIZIM ME MATERIAL HIGJENIK                                                                                                                      | 22.03.2018                                  | 18.04.2018                                  | 07.05.2018                                  | 07.05.2018 - 06.05.2019                                                        | 07.05.2018 - 06.05.2019                                                           | 06.05.2019                                                                   | € 15,000.00                     | € 12,779.45                                             | € 0.00                                                        |

|     |                                                                                                                                            |            |            |            |                         |            |              |              |        |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|------------|------------|-------------------------|------------|--------------|--------------|--------|
| 009 | FURNIZIM ME UNIFORMA PËR DREJTORINË PËR PUNË INSPEKTUESE                                                                                   | 30.03.2018 | 13.04.2018 | 24.04.2018 | 24.04.2018 - 23.01.2019 | 23.01.2019 | € 5,100.00   | € 3,498.00   | € 0.00 |
| 010 | FURNIZIM ME TV LED DHE DVD PLAYER PËR ÇERDHEN E FËMIJËVE "TULIPANET"                                                                       | -          | -          | 21.03.2018 | 21.03.2018 - 21.06.2018 | 21.06.2018 | € 370.00     | € 368.00     | € 0.00 |
| 011 | NDERTIMI I RUGËS KRUSHË E MADHE - RANDOBRAVË                                                                                               | 26.04.2018 | 10.07.2018 | 17.07.2018 | 17.07.2018 - 17.07.2019 | 17.07.2019 | € 548,494.38 | € 444,000.23 | € 0.00 |
|     | FURNIZIM ME MATERIAL LABORATORIK, STOMATOLOGJIK DHE BARNA EMERGJENTE - Loto I - Furnizim me material reagjens shpenzues për Laborator      | 27.04.2018 | 21.06.2018 | 03.07.2018 | 03.07.2018 - 03.07.2019 | 03.07.2019 | € 8,055.10   | € 7,920.00   | € 0.00 |
|     | FURNIZIM ME MATERIAL LABORATORIK, STOMATOLOGJIK DHE BARNA EMERGJENTE - Loto II - Furnizim me material shpenzues për Stomatologji           | 27.04.2018 | 21.06.2018 | 03.07.2018 | 03.07.2018 - 03.07.2019 | 03.07.2019 | € 5,989.60   | € 4,998.50   | € 0.00 |
| 012 | FURNIZIM ME MATERIAL LABORATORIK, STOMATOLOGJIK DHE BARNA EMERGJENTE - Loto III - Furnizim me Barna ampullore emergjente, material sanitet | 27.04.2018 | 21.06.2018 | 04.07.2018 | 04.07.2018 - 04.07.2019 | 04.07.2019 | € 15,006.00  | € 13,770.00  | € 0.00 |
| 013 | FURNIZIM ME VESHËMBATHJE - UNIFORMA PËR PERSONELIN E QKMF - së                                                                             | 30.04.2018 | 18.05.2018 | 28.05.2018 | 28.05.2018 - 28.09.2018 | 28.09.2018 | € 4,390.00   | € 3,272.00   | € 0.00 |
| 014 | FURNIZIM ME REKUZITAT SPORTIVE PËR SHKOLLA                                                                                                 | 30.04.2018 | 01.08.2018 | 08.08.2018 | 08.08.2018 - 08.08.2019 | 08.08.2019 | € 22,755.00  | € 17,858.30  | € 0.00 |
| 015 | FURNIZIM ME KËND TË LOJRAVE NË SHKOLLA FILLORE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT                                                                     | 30.04.2018 | 18.05.2018 | 28.05.2018 | 28.05.2018 - 28.08.2018 | 28.08.2018 | € 4,000.00   | € 3,650.00   | € 0.00 |
| 016 | FURNIZIM ME KASETA PËR FILMA TË RENTGENIT PËR QKMF                                                                                         | -          | -          | 19.04.2018 | 19.04.2018 - 29.06.2018 | 29.06.2018 | € 990.00     | € 980.00     | € 0.00 |
| 017 | BLERJA E VESHJEVE KOMBTARE PËR SH.K.A. "BAJRAM CURRI" - KRUSHË E MADHE                                                                     | -          | -          | 26.04.2018 | 26.04.2018 - 29.06.2018 | 29.06.2018 | € 990.00     | € 985.00     | € 0.00 |
| 018 | NDËRTIMI I SERAVE ME PARTIÇIPIM (80 % : 20 %) - RITENDERIM                                                                                 | 27.08.2018 | 10.10.2018 | 18.10.2018 | 18.10.2018 - 18.10.2020 | 18.10.2020 | € 350,000.00 | € 287,593.90 | € 0.00 |
| 019 | FURNIZIMI I BIBLIOTEKAVE ME LIBRA                                                                                                          | 07.05.2018 | 20.07.2018 | 08.08.2018 | 08.08.2018 - 08.02.2019 | 08.02.2019 | € 10,000.00  | € 9,480.00   | € 0.00 |
| 020 | RREGULLIMI DHE RRETHIMI I FUSHËS SË SPORTIT NË RATKOC                                                                                      | 07.05.2018 | 04.07.2018 | 17.07.2018 | 17.07.2018 - 17.07.2019 | 17.07.2019 | € 14,349.50  | € 8,926.00   | € 0.00 |
| 021 | SHTIGJET E ECJES NË RAHOVEC                                                                                                                | 10.05.2018 | 10.07.2018 | 17.07.2018 | 17.07.2018 - 17.07.2019 | 17.07.2019 | € 218,588.50 | € 129,744.00 | € 0.00 |
| 022 | FURNIZIM ME MATERIAL PËR RREGULLIMIN E KLASAVE NË SH. F. "BEKIM SYLKA" NË RAHOVEC                                                          | -          | -          | 07.05.2018 | 07.05.2018 - 29.06.2018 | 29.06.2018 | € 900.00     | € 896.60     | € 0.00 |
| 023 | MERENETIMI I RUGËVE DHE TROTUAREVE - Lot I - Meremetimi i rrugëve me asfalt në Komunën e Rahovecit                                         | 21.05.2018 | 08.08.2018 | 20.08.2018 | 20.08.2018 - 20.08.2020 | 20.08.2020 | € 252,625.00 | € 149,418.40 | € 0.00 |
| 023 | MERENETIMI I RUGËVE DHE TROTUAREVE - Lot II - Meremetimi i rrugëve dhe trotuares me kubëza në Komunën e Rahovecit                          | 21.05.2018 | 08.08.2018 | 15.08.2018 | 15.08.2018 - 15.08.2020 | 15.08.2020 | € 148,650.00 | € 87,765.00  | € 0.00 |
| 023 | MERENETIMI I RUGËVE DHE TROTUAREVE - Lot III - Ndërtimi e mureve mbrojtëse                                                                 | 21.05.2018 | 08.08.2018 | 15.08.2018 | 15.08.2018 - 15.08.2020 | 15.08.2020 | € 172,460.00 | € 128,110.00 | € 0.00 |
| 024 | SINJALIZIMI VERTIKAL DHE HORIZONTAL I RUGËVE                                                                                               | 14.05.2018 | 10.07.2018 | 19.07.2018 | 19.07.2018 - 19.07.2020 | 19.07.2020 | € 101,000.00 | € 54,852.50  | € 0.00 |
| 025 | FAZA E TRETË - NDËRTIMI I PALESTRËS SPORTIVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT                                                                        | 14.05.2018 | 04.06.2018 | 18.06.2018 | 18.06.2018 - 31.12.2018 | 31.12.2018 | € 896,327.50 | € 628,545.28 | € 0.00 |
| 026 | KRUIIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE - MBIJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV                                                                          | 18.05.2018 | -          | 18.07.2018 | -                       | -          | € 62,161.50  | -            | -      |
| 027 | RRENIMI I OBJEKTEVE PA LEJE SI DHE OBJEKTEVE TË VIETRA NË KOMUNËN E RAHOVECIT - RITENDERIM                                                 | 03.08.2018 | 05.09.2018 | 10.09.2018 | 10.09.2018 - 10.09.2019 | 10.09.2019 | € 40,234.50  | € 39,701.50  | € 0.00 |
| 028 | BLERJA E NJË VETURE PËR NEVOJAT E DSHPS                                                                                                    | -          | -          | -          | -                       | -          | € 18,000.00  | -            | -      |
| 029 | HARTIMI I HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT                                                                                            | -          | -          | -          | -                       | -          | € 110,000.00 | -            | -      |
| 030 | SIGURIMI I AUTOMJETEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT                                                                                             | 28.05.2018 | 04.09.2018 | 07.09.2018 | 07.09.2018 - 07.09.2019 | 07.09.2019 | € 12,000.00  | € 10,948.09  | € 0.00 |
|     | FURNIZIM ME MATERIAL PËR RREGULLIMIN E UJËSIELSIT PËR AMF POLLUZHË                                                                         | -          | -          | 25.05.2018 | 25.05.2018 - 31.12.2018 | 31.12.2018 | € 990.00     | € 989.00     | € 0.00 |
| 031 | TRANSPORTIMI I ADMINISTRUES NË RELACIONIN RAHOVEC - GJAKOVË                                                                                | -          | -          | -          | -                       | -          | € 200.00     | € 197.60     | € 0.00 |
| 032 | DHE ANASIELLTAS PËR TEST KOMBETAR TË MATURËS                                                                                               | -          | -          | 29.05.2018 | 29.05.2018 - 31.12.2018 | 31.12.2018 | € 44,360.14  | € 31,452.68  | € 0.00 |
| 033 | RIPARIMI I OBJEKTEVE SHËNDETËSORE                                                                                                          | 04.06.2018 | 01.08.2018 | 08.08.2018 | 08.08.2018 - 08.08.2019 | 08.08.2019 | € 14,000.00  | € 0.00       | € 0.00 |
| 034 | FURNIZIMI DHE INSTALIMI I KAMERAVE NË QKMF, QMF DHE AMF - të                                                                               | -          | -          | 31.08.2018 | -                       | -          | € 408,000.00 | € 206,701.10 | € 0.00 |
| 035 | NDËRTIMI I NDËRÇIMIT PUBLIK NË KOMUNËN E RAHOVECIT                                                                                         | 25.06.2018 | 22.08.2018 | 19.09.2018 | 19.09.2018 - 19.09.2020 | 19.09.2020 | € 217,000.00 | € 128,526.00 | € 0.00 |
| 036 | MIRËMBALJTA E NDËRÇIMIT PUBLIK NË KOMUNËN E RAHOVECIT                                                                                      | 28.06.2018 | 19.09.2018 | 26.09.2018 | 26.09.2018 - 26.09.2020 | 26.09.2020 | € 285,000.00 | € 178,086.10 | € 0.00 |
| 037 | ULJA E NIVELETËS SË PËRROIT NË FSHATIN CELINE                                                                                              | 02.07.2018 | 04.09.2018 | 06.09.2018 | 06.09.2018 - 06.09.2020 | 06.09.2020 | € 80,000.00  | € 59,940.63  | € 0.00 |
| 038 | FURNIZIM ME MATERIAL TEKNIK PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT                                                                             | 02.07.2018 | 04.09.2018 | 06.09.2018 | 06.09.2018 - 06.09.2020 | 06.09.2020 | € 80,000.00  | € 59,940.63  | € 0.00 |
| 039 | FURNIZIM ME DRU, THËNGJILL DHE PELET PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT - Lot I - Furnizim me dru për nevojat e Komunës së Rahovecit       | 09.07.2018 | 05.09.2018 | 17.09.2018 | 17.09.2018 - 17.09.2021 | 17.09.2021 | € 326,000.00 | € 324,864.00 | € 0.00 |

|     |                                                                                                                                                 |            |            |            |                         |            |                |              |        |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|------------|------------|-------------------------|------------|----------------|--------------|--------|
| 039 | FURNIZIM ME ORU, THËNGJILL DHE PELET PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT -<br>shkollat e Komunës së Rahovecit<br>Lot III - Furnizim me pelet për | 09.07.2018 | 05.09.2018 | 28.09.2018 | 28.09.2018 - 28.09.2021 | 28.09.2021 | € 27,000.00    | € 19,305.00  | € 0.00 |
| 040 | NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS NËNTOKËSORE DHE MBITOKËSORE TEK OBJEKTET ZIARPKËSË                                                                   | 16.07.2018 | 04.09.2018 | 13.09.2018 | 13.09.2018 - 13.09.2019 | 13.09.2019 | € 48,740.20    | € 31,115.80  | € 0.00 |
| 041 | RIPARIMI I RENGJENIT NË QKMF                                                                                                                    | -          | -          | 17.07.2018 | 17.07.2018 - 31.12.2018 | 31.12.2018 | € 900.00       | € 900.00     | € 0.00 |
| 042 | INVESTIMI DHE MIRËMBALJA E HAPËSIRAVE GJELBËRUESE, PARQË, VARREZAT E DËSHMORËVE DHE CIVILE NË KOMUNËN E RAHOVECIT -<br>Loto I                   | 23.07.2018 | 04.09.2018 | 06.09.2018 | 06.09.2018 - 06.09.2019 | 06.09.2019 | € 16,981.86    | € 16,709.28  | € 0.00 |
| 042 | INVESTIMI DHE MIRËMBALJA E HAPËSIRAVE GJELBËRUESE, PARQË, VARREZAT E DËSHMORËVE DHE CIVILE NË KOMUNËN E RAHOVECIT -<br>Loto II                  | 23.07.2018 | 04.09.2018 | 06.09.2018 | 06.09.2018 - 06.09.2019 | 06.09.2019 | € 21,596.96    | € 21,359.06  | € 0.00 |
| 043 | FURNIZIMI DHE MONTIMI I DYERVE TË KLASAVE PËR SHKOLLAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT                                                                   | 26.07.2018 | 05.09.2018 | 21.09.2018 | 21.09.2018 - 21.03.2019 | 21.03.2019 | € 9,490.00     | € 7,988.20   | € 0.00 |
| 044 | KRUIIMI I HAPËSIRAVE GJELBËRUESE - MBIJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV - RITENDERIM                                                                  | 03.08.2018 | 25.09.2018 | 28.09.2018 | 28.09.2018 - 28.09.2019 | 28.09.2019 | € 128,873.50   | € 72,912.55  | € 0.00 |
| 045 | HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDËRSHME                                                                                                                | 13.09.2018 | -          | 01.11.2018 | -                       | -          | € 120,000.00   | € 0.00       | € 0.00 |
| 046 | MBIKËQYRIA E INVESTIMEVE KAPITALE                                                                                                               | 13.08.2018 | 06.11.2018 | 09.11.2018 | 09.11.2018 - 09.11.2020 | 09.11.2020 | € 80,000.00    | € 36,108.00  | € 0.00 |
| 047 | BLERJA E NË AUTOAMBLANCE PËR NEVOJAT E QKMF - së                                                                                                | 23.08.2018 | 25.09.2018 | 28.09.2018 | 28.09.2018 - 28.03.2019 | 28.03.2019 | € 32,848.00    | € 31,450.00  | € 0.00 |
| 048 | NDËRTIMI I OBJEKTIT TË CËRDHËS SË FËMIJËVE NË FSHATIN RATKOC                                                                                    | 27.08.2018 | 13.11.2018 | 20.11.2018 | 20.11.2018 - 20.11.2020 | 20.11.2020 | € 631,033.37   | € 468,292.23 | € 0.00 |
| 049 | FASADIMI I OBJEKTIT KOLEKTIV TË BANIMIT NË RAHOVEC                                                                                              | 10.09.2018 | 31.10.2018 | 06.11.2018 | 06.11.2018 - 06.11.2020 | 06.11.2020 | € 110,609.37   | € 77,968.50  | € 0.00 |
| 050 | NDËRTIMI I SHMFU "HERONIET E KOSOVËS" NË HOQË E VOGËL - BRESTOC                                                                                 | 31.08.2018 | 20.11.2018 | 26.11.2018 | 26.11.2018 - 26.11.2020 | 26.11.2020 | € 880,450.00   | € 464,298.82 | € 0.00 |
| 051 | BLERJA E NËJE KOSITSE STANDARDE PËR FUSHA SPORTIVE                                                                                              | 13.09.2018 | 17.10.2018 | 24.10.2018 | 24.10.2018 - 22.02.2019 | 22.02.2019 | € 5,000.00     | € 2,334.72   | € 0.00 |
| 052 | NDËRTIMI I QENDRËS KYRËSORE TË MIKËSISË FAMILJARE - EMERGENCA - FAZA E DYTË                                                                     | 10.09.2018 | 13.11.2018 | 15.11.2018 | 15.11.2018 - 15.11.2020 | 15.11.2020 | € 954,502.82   | € 486,915.39 | € 0.00 |
| 053 | RIPARIMI I SHITËPISË SË KULTURËS NË RATKOC                                                                                                      | 13.09.2018 | 06.11.2018 | 15.11.2018 | 15.11.2018 - 15.11.2020 | 15.11.2020 | € 188,018.25   | € 115,957.80 | € 0.00 |
| 054 | Lot I - BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN ZATRIQ - RAHOVEC DHE ANASIELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2018/2019                                           | 07.09.2018 | 25.09.2018 | 01.10.2018 | 01.10.2018 - 01.07.2019 | 01.07.2019 | € 5,100.00     | € 5,098.41   | € 0.00 |
| 054 | Lot II - BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN MRASOR - KRAMOVIK DHE ANASIELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2018/2019                                         | 07.09.2018 | 25.09.2018 | 01.10.2018 | 01.10.2018 - 01.07.2019 | 01.07.2019 | € 4,500.00     | € 4,498.11   | € 0.00 |
| 054 | Lot III - BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN RAKOVIN - KRAMOVIK DHE ANASIELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2018/2019                                       | 07.09.2018 | 25.09.2018 | 01.10.2018 | 01.10.2018 - 01.07.2019 | 01.07.2019 | € 7,500.00     | € 7,499.61   | € 0.00 |
| 054 | Lot IV - BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN KAZNIK - PASTASEL DHE ANASIELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2018/2019                                         | 07.09.2018 | 25.09.2018 | 01.10.2018 | 01.10.2018 - 01.07.2019 | 01.07.2019 | € 4,770.00     | € 4,769.28   | € 0.00 |
| 054 | Lot V - BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN HOQË E MADHË - RAHOVEC DHE ANASIELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2018/2019                                     | 07.09.2018 | 25.09.2018 | 01.10.2018 | 01.10.2018 - 01.07.2019 | 01.07.2019 | € 3,520.00     | € 3,519.00   | € 0.00 |
| 054 | Lot VI - BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN GURI I KUQ - KRAMOVIK DHE ANASIELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2018/2019                                     | 07.09.2018 | 25.09.2018 | 01.10.2018 | 01.10.2018 - 01.07.2019 | 01.07.2019 | € 4,500.00     | € 4,498.11   | € 0.00 |
| 054 | Lot VII - BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN RETI E POSHTIME - PIRANË DHE ANASIELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2018/2019                                 | 07.09.2018 | 25.09.2018 | 01.10.2018 | 01.10.2018 - 01.07.2019 | 01.07.2019 | € 4,500.00     | € 4,498.11   | € 0.00 |
| 055 | KULLIMI I TOKAVE BUJQËSORE NË XËRXË                                                                                                             | 14.09.2018 | 31.10.2018 | 02.11.2018 | 02.11.2018 - 02.11.2020 | 02.11.2020 | € 266,000.00   | € 148,325.14 | € 0.00 |
| 056 | HARTIMI I PROJEKTIT PËR KOMPLEKSIN MUZEAL TË UKSHIN HOTIT NË KRUSHË TË MADHË                                                                    | 12.10.2018 | -          | 27.11.2018 | -                       | -          | € 15,000.00    | € 0.00       | € 0.00 |
| 057 | RIPARIMI I MONUMENTEVE KULTURORE HISTORIKE                                                                                                      | 24.09.2018 | 13.11.2018 | 15.11.2018 | 15.11.2018 - 15.11.2020 | 15.11.2020 | € 108,000.00   | € 78,846.46  | € 0.00 |
| 058 | RETHIMI I CYRATË TË VENDIT DHE RREGULLIMI I OBORREVE                                                                                            | 24.09.2018 | 20.11.2018 | 22.11.2018 | 22.11.2018 - 22.11.2019 | 22.11.2019 | € 17,641.00    | € 10,810.50  | € 0.00 |
| 059 | PUNIMI I BUSTIT TË DËSHMORIT "MUSTAFA IBISHI" NË KRAMOVIK                                                                                       | 09.10.2018 | 29.11.2018 | 03.12.2018 | 03.12.2018 - 03.12.2019 | 03.12.2019 | € 7,900.00     | € 7,450.00   | € 0.00 |
| 060 | NDËRTIMI I RUGËVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT                                                                                                        | 05.10.2018 | 29.11.2018 | 03.12.2018 | 03.12.2018 - 03.12.2020 | 03.12.2020 | € 368,833.00   | € 271,388.20 | € 0.00 |
| 061 | NDËRTIMI I TROTUARËVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT                                                                                                    | 08.10.2018 | 29.11.2018 | 30.11.2018 | 30.11.2018 - 30.11.2020 | 30.11.2020 | € 231,281.54   | € 157,961.53 | € 0.00 |
| 062 | FURNIZIMI DHE INSTALIMI I KAMERAVE NË OBJEKTET E KOMUNËS SË RAHOVECIT                                                                           | 08.10.2018 | 20.11.2018 | 27.11.2018 | 27.11.2018 - 27.11.2019 | 27.11.2019 | € 23,599.10    | € 16,165.53  | € 0.00 |
| 063 | NDËRTIMI I KANALIZIMEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT                                                                                                  | 08.10.2018 | 27.11.2018 | 03.12.2018 | 03.12.2018 - 03.12.2020 | 03.12.2020 | € 497,896.00   | € 441,155.89 | € 0.00 |
| 064 | BLERJA E PAISJEVE SPORTIVE PËR K.F. "RAHOVECIN" NË RAHOVEC                                                                                      | -          | -          | 05.10.2018 | 05.10.2018 - 31.12.2018 | 31.12.2018 | € 900.00       | € 873.00     | € 0.00 |
| 065 | BLERJA E PAISJEVE MIKËSORE PËR NEVOJA TË QKMF - së                                                                                              | 08.10.2018 | 22.11.2018 | 29.11.2018 | 29.11.2018 - 28.02.2019 | 28.02.2019 | € 8,000.00     | € 7,690.00   | € 0.00 |
| 066 | INVESTIMI NË ZONËN EKONOMIKE NË OPTERUSHË                                                                                                       | 12.10.2018 | 06.11.2018 | 09.11.2018 | 09.11.2018 - 09.03.2019 | 09.03.2019 | € 7,500.00     | € 4,360.00   | € 0.00 |
| 067 | PUNIMI I MURIT MBROJTES TEK QENDRA RINORE NË RAHOVEC                                                                                            | 11.10.2018 | 07.11.2018 | 09.11.2018 | 09.11.2018 - 09.03.2019 | 09.03.2019 | € 9,742.00     | € 7,995.90   | € 0.00 |
| 068 | RREGULLIMI I SHITRETËRVE TË LUMENIËVE DHE PËRQAKËVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT                                                                      | 22.10.2018 | 05.12.2018 | 06.12.2018 | 06.12.2018 - 06.12.2021 | 06.12.2021 | € 1,106,897.24 | € 765,095.30 | € 0.00 |
| 069 | NDËRTIMI I SHKOLLËS FILLORE NË RETI                                                                                                             | -          | -          | -          | -                       | -          | € 457,787.96   | -            | -      |

|     | FURNIZIM ME USHQIM DHE PUE PËR ÇERDHEN E FËMIJËVE "TULIPANËT"            | 25.10.2018 | 05.12.2018 | 07.12.2018 | 07.12.2018 - 07.12.2019 | 07.12.2019 | € 14,667.00          | € 12,958.57         | € 0.00        |
|-----|--------------------------------------------------------------------------|------------|------------|------------|-------------------------|------------|----------------------|---------------------|---------------|
| 070 | NË RAHOVEC                                                               |            |            |            |                         |            |                      |                     |               |
| 071 | FURNIZIMI DHE RREGULLIMI I XHAMAVE NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË            | 29.10.2018 | 20.11.2018 | 04.12.2018 | 04.12.2018 - 04.12.2019 | 04.12.2019 | € 5,510.00           | € 5,480.00          | € 0.00        |
| 072 | MESME NË KOMUNËN E RAHOVECIT                                             | 29.10.2018 | 13.12.2018 | 21.12.2018 | 21.12.2018 - 20.12.2019 | 20.12.2019 | € 3,000.00           | € 1,700.00          | € 0.00        |
| 073 | FURNIZIM ME SHKUMESA PËR SHKOLLAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT                 | 26.11.2018 | 26.12.2018 | 04.01.2019 | 04.01.2019 - 04.01.2020 | 04.01.2020 | € 59,450.00          | € 59,259.53         | € 0.00        |
| 073 | MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS RRUGORE GIATË SEZONËVE - Loto I            | 26.11.2018 | 26.12.2018 | 04.01.2019 | 04.01.2019 - 04.01.2020 | 04.01.2020 | € 45,419.00          | € 45,279.70         | € 0.00        |
| 073 | MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS RRUGORE GIATË SEZONËVE - Loto II           | 22.11.2018 | 11.12.2018 | 18.12.2018 | 18.12.2018 - 03.01.2019 | 03.01.2019 | € 5,000.00           | € 4,425.00          | € 0.00        |
| 074 | RREGULLIMI I KALLDAJËS SË NGROHJES QËNDRORE TË SHKOLLËS                  |            |            |            |                         |            |                      |                     |               |
| 075 | PASTIRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJENIKE TË OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT |            |            |            |                         |            | € 250,000.00         |                     |               |
| 076 | RIPARIMI I PLAKËS PËRKUTIMORE TË DËSHMOREVE NË PATAQAN TË ULËT           | -          | -          | 03.12.2018 | 03.12.2018 - 31.12.2018 | 31.12.2018 | € 1,000.00           | € 999.00            | € 0.00        |
| 077 | DEKORIMI I QYTETIT PËR FESTAT E FUND VITIT                               | 04.12.2018 | -          | 20.12.2018 | -                       |            | € 8,380.00           | € 0.00              | € 0.00        |
| 078 | FURNIZIM ME INVENTAR PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT                  | 17.12.2018 | 03.01.2019 | 03.01.2019 | 03.01.2019 - 03.01.2022 | 03.01.2022 | € 120,000.00         | € 118,645.00        | € 0.00        |
| 079 | FURNIZIM ME ELEMENTE DEKORUESE PËR FESTAT E FUNDVITIT                    | -          | -          | 20.12.2018 | 20.12.2018 - 31.12.2018 | 31.12.2018 | € 999.00             | € 996.50            | € 0.00        |
| 080 | RREGULLIMI I FIGURAVE TË NDËRSHME DEKORATIVE NË QYTET                    | -          | -          | 20.12.2018 | 20.12.2018 - 31.12.2018 | 31.12.2018 | € 1,000.00           | € 993.00            | € 0.00        |
|     | <b>TOTALI</b>                                                            |            |            |            |                         |            | <b>11,401,390.39</b> | <b>7,086,775.49</b> | <b>€ 0.00</b> |

## 4.1 Raporti i obligimeve financiare

| Kodi Organizativ | Organizata Buxhetore | Mallra dhe shërbime | Shpenzime Komunale | Subvencionet dhe Transferet | Investimet kapitale | Gjithsej     |
|------------------|----------------------|---------------------|--------------------|-----------------------------|---------------------|--------------|
| 623              | Rahovec              | 118,611.65          | 592.25             | 720.00                      | 1,272,236.76        | 1,392,160.66 |

Drejtori për Buxhet dhe Financa

Afrim Limani



Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe / Savet sela Velika Hoča

Lënda: Raporti i Kryetarit të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe

Për: Kryesuesin e kuvendit të komunës së Rahovecit.

Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe është themeluar me 30.07.2018. Nga themelimi e deri në dhjetor të vitit 2018 janë mbajtur 5 (pesë) mbledhje të cilat janë kryesuar nga kryetari i këshillit për fshatin Hoçë e Madhe.

Në mbledhjen konstituive të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe ka marr pjesë kryesuesi i kuvendit të komunës së Rahovecit, Afrim Dina. Për kryetar të këshillit të fshatit për Hoçë të Madhe është zgjedhur Bojan Pavloviq. Në mbledhje, anëtarët janë njoftuar me Rregulloren e punës dhe udhëzimin administrativ për punën e këshillit.

- Janë vendosur qëllimet afatshkurtra dhe afatgjate të punës së këshillit për Hoçë të Madhe.
- Është aprovuar propozim buxheti për funksionimin e këshillit për Hoçë të Madhe.
- Për nënkryetar të këshillit për Hoçë të Madhe është zgjedhur Nenad Stashiq

Me kërkesë të inspektoratit të ndërtimtarisë, me paraqitjen e qytetarëve, këshilli ka formuar komisionin për vërtetimin e gjendjes faktike në lokacion – parcela nr. 02584/0.

- Është kërkuar plotësimi i dokumentacionit, lidhur me mundësin e dhënies së pëlqimit për ndërtimin e objektit.

Është dhënë pëlqimi për ndërtimin e fushës sportive në shkollën “Svetozar Markoviq”.

- Projekti është financuar nga IOM-i dhe Komuna e Rahovecit, me kërkesë të komunitetit.

Gjatë javëve të kaluara këshilli për Hoçë të Madhe ka shqyrtuar:

- Mbjelljen e pishave në vendin ku më parë janë hedhur mbeturina, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare.
- Shqyrtimi i mundësisë për përpilimin e planit rregullues (Master Planit) i cili është i nevojshëm për funksionimin e këshillit.
- Është marr iniciativa për renovimin e pjesës së ndërtesës së Shtëpi së Kulturës në Hoçë të Madhe. Është përgatitur projekti, ndërsa në takim me anëtarët e KFOR-it dhe CIMIC-ut, na është premtuar realizimi i këtij projekti.
- Pastrimi i dopinisë së mbeturinave mbi ujëmbledhës.

**Raporti financiar nuk është shqyrtuar sepse nuk është dërguar nga ana e drejtorisë së financave.**

Vërejtje: Për arsye administrative nuk është shfrytëzuar komplet buxheti i miratuar për punën e këshillit për Hoçë të Madhe.

Mbi të gjitha faktet e përmendura, duke marr parasysh periudhën e shkurt kohore të themelimit të këshillit, mund të konstatojmë si një vit të suksesshëm. Me këtë rast duam t' ju falënderojmë të gjithë atyre të cilët ndihmuan në punën e këshillit, në veçanti kryesuesin e kuvendit, drejtorin komunale për urbanizëm, si dhe anëtarët e OSBE –së.

Me datë:

**21.12.2018**

**Kryesuesi i Këshillit  
për Hoçë të Madhe**

---

**Bojan Pavloviq**




Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit


*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*

---



# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

JANAR - DHJETOR



# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## PËRMBAJTJA

|                                                             |    |
|-------------------------------------------------------------|----|
| KRYETARI I KOMUNËS.....                                     | 3  |
| Zyra Ligjore.....                                           | 5  |
| Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Rahovecit..... | 6  |
| Zyra për Informim.....                                      | 6  |
| Zyra e Prokurimit.....                                      | 7  |
| Zyra për KKK.....                                           | 7  |
| Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut.....               | 8  |
| Njësia e Personelit.....                                    | 9  |
| Zyra për përfaqësim Ligjor.....                             | 11 |
| DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME.....             | 15 |
| DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET.....                       | 17 |
| DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE.....         | 17 |
| DREJTORIA PËR ARSIM.....                                    | 18 |
| DREJTORIA PËR EKONOMI ZHVILLIM DHE TURIZËM.....             | 21 |
| DREJTORIA E URBANIZMIT, PLANIFIKIMIT DHE MJEDISIT.....      | 24 |
| DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË.....             | 26 |
| DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE.....                         | 27 |
| DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL.....     | 29 |
| DREJTORIA PËR PUNËT INSPEKTUESE.....                        | 33 |
| DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT.....                  | 37 |
| DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM.....                     | 38 |
| PËRFUNDIM.....                                              | 39 |

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## KRYETARI I KOMUNËS

Raporti vjetor pasqyron përkushtimet, aktivitetet, punët dhe angazhimet tona, të cilat i kemi realizuar gjatë gjithë vitit kalendarik 2018. Përmbajtja e raportit reflekton planet tona dhe përmasën e realizimit të prioriteteve qeverisëse, me qëllim të përparimit dhe zhvillimit të gjithmbarshëm të komunës sonë.

Në raport ju do të gjeni të përmbledhur hapat dhe veprimet të cilat janë ndërmarr për të gjetur zgjidhje për problemet e shumta, në të gjitha fushat e kompetencave të qeverisjes lokale. Raportin vjetor të punës e karakterizon vëmendja jonë për të theksuar aspektet më të rëndësishme ku është përqendruar angazhimi ynë.

Pavarësisht se raporti është i zgjeruar, sepse secila drejtori komunale, njësi apo zyrë janë subjekt i raportimit, megjithatë, mund të kemi harruar ndonjë gjë e cila mund të përfshihej.

## Synimet politike në qeverisje

- Qeverisje të mirë, të përgjegjshme, të qëndrueshme, të hapur me qytetarët, demokratike dhe të suksesshme;
- Qeverisje me plane dhe shikim kah e ardhmja;
- Qeverisje që gjen zgjidhje, sado sfiduese dhe komplekse janë problemet;
- Qeverisje me plane të qarta dhe ambicioze;
- Qeverisje që përballet me guxim dhe kryen punë me dinamikë të lartë e nuk vonohet;
- Qeverisje që afirmon vlerat kombëtare, historike, të trashëgimisë, të kulturës dhe vlerat e tjera;
- Qeverisje e re dhe energjike që mobilizon resurse dhe përfshin në veprime investuese e zhvillimore punën në partneritet;
- Qeverisje e cila vlerëson, motivon dhe mbështet talentin dhe të arriturat e qytetarëve tanë të të gjitha shtresave;
- Qeverisje ndërtuese që promovon gjithë-përfshirjen në vendimmarrje të forcave me ndikim në shoqëri, si: forcat politike, Kuvendin Komunal, bashkësitë fetare, shoqërinë civile, bizneset, individët, të rinjtë dhe grupet e ndryshme të interesit;
- Qeverisje që mobilizon qytetarët të marrin rolin që ju takon në të gjitha çështjet që janë në interesin e tyre;
- Qeverisje për të gjithë, pa dallim.

## Prioritetet

- Rregulli dhe disiplina në institucione
- Mbarëvajtja e punëve dhe rritja e efikasitetit të punonjësve
- Kontakti i rregullt dhe komunikimi i hapur me qytetarët e të gjitha shtresave;
- Ide dhe projekte të reja në të gjithë sektorët komunalë
- Palestra e sporteve në qytet
- Themelimi i Zonës Ekonomike dhe projekte në Zonën Turistike
- Mirëmbajtja e mjedisit dhe hapësirave publike
- Regjistrimi, vlerësimi dhe vendosja e bar-kodeve në inventarin, regjistrimi i pasurisë jo-financiare nën vlerën 1000 euro që ndodh për herë të parë pas luftës,

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

- Riorganizim i QKMF-së dhe puna në dy ndërrime në dy QMF (Krushë e Madhe dhe në Ratkoc)
- Përgatitje me kohë e planeve vepruese për funksionim më të mirë dhe për arritje të komunës si rezultat i qeverisjes
- Përgjigje pa vonesa ndaj shkresave dhe adresimeve të ndryshme që i vijnë komunës
- Bashkëpunim të mirë e të suksesshëm me qeverinë dhe donatorët e huaj për më shumë përkrahje të proceseve zhvillimore të komunës
- Themelimi i Tryezës Këshilluese me Bizneset
- Politika të qarta dhe veprime të koordinuara në fushën e arsimit

## Aktivitete të rëndësishme

- Procesi demokratik i transferimit të përgjegjësisë nga Kryetari Vehapi dhe qeveria e tij tek unë dhe qeveria e re komunale;
- Thirrja e seancës përruruese dhe zgjedhja e Kryesuesit të KK;
- Takimet e rregullta me kryetarë të këshillave të lagjeve të qytetit dhe të fshatrave;
- Përballja me sezonin e dimrit dhe ndërhyrjet e shumta në pastrimin e rrugëve nga bora, krahas kësaj, edhe trajtimin emergjent të problemeve evidente në infrastrukturën rrugore dhe të ujërave të zeza, ndërhyrje që kanë vazhduar edhe në pranverë;
- Përgatitja e dokumenteve të shumta të rëndësishme për aprovim nga Kuvendi Komunal;
- Hartimi i planit vjetor të prokurimit dhe aprovimi i tij;
- Hartimi i planit vjetor të punës së Kryetarit dhe qeverisë komunale;
- Hartimi i planit kundër korrupsionit;
- Hartimi i planit që rregullon sistemin e pagesave;
- Hartimi i planit për rritjen e të hyrave komunale;
- Hartimi i planit për mbrojtje nga ethet hemorragjike (Krime Kongo);
- Fillimi i hartimit të PZHK-së dhe i Hartës Zonale, të cilat po vazhdojnë;
- Regjistrime të reja të shtëpive që obligohen të paguajnë tatimin në pronë;
- Nxjerrje e urdhëresave, vendimeve dhe akteve të shumta në interes të komunës dhe të qytetarëve tanë;
- Aprovimi nga Qeveria Haradinaj i kërkesës sonë për shpronësimin e tokës ku është ndërtuar Shtëpia Muze e Ukshin Hotit;
- Elaborati i përgatitur dhe adresimi për shpronësim i pronarëve private, për nevoja të ndërtimit të rrugës transite mbi qytet;
- Raporti i përgatitur nga punonjësit e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës i cili tregon për statusin e pronave të lira, atyre të AKP-së, APK-së, si dhe atyre pronave që janë të uzurpuara;
- Verifikim i ecursisë së projekteve dhe vazhdimi i kujdesshëm i kontratave që i kemi trashëguar;
- Ballafaqime të vazhdueshme për një administrim të mirë e të përgjegjshëm që të tejkalohen më lehtë situatat e vështira me borxhet e gjetura;
- Adresimi i shkresave në Qeverinë e Kosovës për përkrahjen e komunës së Rahovecit;
- Rritja e bashkëpunimit me Qeverinë e Kosovës;
- Përqendrim i presionit për qartësimin e projektit të palestrës së sporteve në qytet dhe tejkalimi i vonesave të gjata rreth saj;
- Riorganizimi i administratës dhe hapja e sportelit të veçantë për mërgimtarët;

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

- Angazhime këmbëngulëse me Qeverinë e Kosovës për themelimin e zonës ekonomike në Opterushë;
- Vendosja e komunikimit të hapur dhe aktiv me grupet e interesit, OJQ-të etj;
- Vizita pune në të gjitha institucionet që veprojnë në komunën tonë;
- Takime me fermerët dhe shoqatat e tyre;
- Takime të hapura me bizneset dhe formimi i tryezës për bizneset e komunës;
- Përkrahje klubeve sportive, OJQ-ve dhe kërkesave për subvencione të DKRS-së, sipas kritereve që përmbante thirrja për aplikim;
- Dhënia e 63 bursave për studentë;
- Takime direkte me qytetarë dhe debate të hapura me ta;
- Për herë të parë është bërë regjistrimi, verifikimi, vlerësimi dhe vendosja e bar-kodeve i pasurisë, duke përfshirë edhe pasurinë jo-financiare nën 1000 euro;
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në të gjithë sektorët;
- Disiplina dhe rregulli në të gjithë sektorët;
- Vizita sistematike në terren dhe përballje me shqetësimet e qytetarëve;
- Angazhime të vazhdueshme për një mjedis të pastër, të gjelbëruar e të mirëmbajtur;
- Përpertime të dukshme në shëndetësinë parësore, aktivizimi i ndërrimeve të dyta në dy QMF, Krushë e Madhe dhe në Ratkoc;
- Përqendrim i vëmendjes dhe veprime e masa në arsim si: regjistrimi i shqetësimeve në infrastrukturën e objekteve shkollore dhe hapësirave të shkollave, takime me drejtorë me qëllim të rritjes së përkushtimeve dhe seriozitetit që të kemi më shumë cilësi në mësimdhënie dhe mësim-nxënie, më pak mungesa të nxënësve e më shumë suksese në shkollat e komunës sonë;
- Janë mbajtur debate që kanë prioritet arsimin ku kanë dalë përfundime dhe rekomandime të rëndësishme për rritjen e cilësisë dhe të sukseseve në arsim;
- Janë organizuar shumë gara komunale në shumë lëndë, ku kemi marrë vlerësime pozitive dhe që kanë pasur ndikim të mirë jo vetëm në shkolla, por edhe jashtë tyre.

## Zyra Ligjore

Zyra ligjore, në kuadër të ushtrimit të përgjegjësiave, autorizimeve si dhe në funksion të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore, për periudhën janar - dhjetor, është përpjekur të bëjë një punë cilësore, duke kryer harmonizimin, plotësim ndryshimin dhe hartimin e akteve nënligjore, që janë propozuar nga Kryetari i Komunës, Kuvendi dhe Drejtorët e Drejtorive në Komunën e Rahovecit. Sektori Ligjor është marrë me këto aktivitete:

- Udhëheqja me procedurë administrative sipas lëndëve.
- Aktivitetet si, ofrimi i këshillave, opinioneve ligjore për Kryetarin e Komunës, Drejtorive Komunale, sektorëve dhe zyrave në Komunën e Rahovecit.
- Hartimi dhe harmonizimi i rregulloreve, hartimi dhe harmonizimi i akteve juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi, hartimi i vendimeve, urdhëresave, marrëveshjeve dhe shkresave të ndryshme përcjellëse për Kryetarin e Komunës dhe për drejtorët e drejtorive në Komunën e Rahovecit.
- Arkivimi dhe sistemimi i dokumenteve të zyrës ligjore si dhe përcjellja e vazhdueshme e ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve që dalin nga institucionet qendrore.

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## Objektivat e arritura

Sektori ligjor për vitin 2018, ka dhënë kontribut edhe në fushën e opinioneve ligjore për të gjitha nevojat e administratës në Komunë përfshirë edhe Kuvendin e Komunës dhe ka qenë pjesë aktive edhe në komisionet e formuara nga Kryetari i Komunës.

|                                                                                            |            |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| Rregullore                                                                                 | 1          |
| Vendime për Kryetarin                                                                      | 411        |
| Vendime për Kuvend                                                                         | 60         |
| Urdhëresa                                                                                  | 87         |
| Autorizime                                                                                 | 34         |
| Kërkesa                                                                                    | 25         |
| Opinione Ligjore                                                                           | 8          |
| Marrëveshje                                                                                | 18         |
| Propozime për Kuvend                                                                       | 48         |
| Akte përcjellëse                                                                           | 10         |
| Kontrata                                                                                   | 43         |
| Konsultime                                                                                 | permanente |
| Përgjigje në kërkesë                                                                       | 33         |
| Njoftime                                                                                   | 4          |
| Plane veprimi                                                                              | 2          |
| <b>Totali i akteve të hartuara për periudhën janar-nëntor 2018 nga zyra ligjore është:</b> | <b>784</b> |

## Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Rahovecit

Gjatë këtij viti, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet është bazuar kyesisht në Planin Vjetor të Punës, i cili ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit. Vlerësimi i objektivave për auditime sipas shkallës së rrezikshmërisë është bërë në Planin Strategjik të NJAB-së për vitet 2018 – 2020, plan ky i aprovuar po ashtu nga Kryetari i Komunës.

## Vlerësimi përmbyllës

Në këtë vit NJAB-ja ka arritur objektivat e planifikuara me Planin Vjetor për vitin 2018, meqë ka arritur ti kryej dhjetë auditime dhe një auditim ad-hoc (me kërkesë të Kryetarit), të cilat kanë pasur një fushëveprim mjaft të gjerë dhe kompleks, një auditim është në proces. Në secilin auditim të kryer, pos të gjeturave, menaxhmentit të drejtorisë së audituar i janë dhënë 47 rekomandime për përmirësimin e proceseve dhe sistemeve, duke u bërë në vazhdimësi përcjellja e zbatueshmërisë së atyre rekomandimeve. Pra, është arritur të krijohet një bashkëpunim produktiv në mes të NJAB-së dhe menaxhmenteve komunale.

## Zyra për Informim

Gjatë vitit 2018, Zyra për Informim në komunën e Rahovecit, është angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale.

Gjatë kësaj periudhe, u janë dërguar ftesa mediave lokale dhe atyre qendrore për përcjelljen e aktiviteteve të kryetarit të komunës, solemnitete e manifestime si dhe përrurime projektsh nga terreni i komunës sonë për të njoftuar publikun e gjerë për zhvillimet e gjithmbarshme në komunën e Rahovecit. Të gjitha këto

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

aktivitete, janë pasqyruar në publikim në Web faqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/rahovec/>, si dhe në rrjetin social Facebook.

Zyra për Informim, ka përcjellur të gjitha seancat e Kuvendit Komunal, për të cilat me kohë janë njoftuar edhe gazetarët. Gjithashtu, ka përcjellur edhe të gjitha mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, për të cilat janë njoftuar me kohë edhe gazetarët.

Gjatë gjithë vitit 2018, janë publikuar vendimet e nënshkruara të kryetarit në uebfaqe zyrtare. Në vazhdimësi vendimet e nënshkruara nga Kryetari janë dërguar tek zyrtari përgjegjës për pranimin e vendimeve në MAPL. Deri në këtë periudhë raportuese janë publikuar 351 vendime në uebfaqen zyrtare të komunës.

## Zyra e Prokurimit

Gjatë periudhës raportuese, zyra e prokurimit ka proceduar 80 aktivitete të prokurimit. Vlera e parashikuar e këtyre aktiviteteve është: 11,401,390.39 €

Deri më tani në zyrën e prokurimit janë nënshkruar 71 kontrata të llojeve të ndryshme, si: punë, furnizime, shërbime, ku vlera e kontratave të nënshkruar është: 7,086,775.49 €.

Gjatë këtij viti gjashtë procedura të prokurimit janë anuluar për arsye të ndryshme, kurse edhe tri të tjera janë në shqyrtim.

Në kuadër të zyrës së prokurimit janë proceduar: 1160 “urdhërblerje”, pagesa të ndryshme të investimeve kapitale dhe mallra dhe shërbime, ku vlera e pagesave është: 4,878,109.12 €.

Vërejtje:

Në përputhje me nenin 87.2.12. të Ligjit Nr.04/L042 për Prokurim Publik në Kosovë, janë publikuar të gjitha kontratat të lidhura në zyrën e prokurimit.

## Zyra për KKK

Brenda vitit kjo zyrë i ka kryer rregullisht punët e saja në fushëveprimin e saj, si:

- Të drejtat e komuniteteve dhe qasja e shërbimeve.
- Kthimi i personave të zhvendosur.
- Regjistrimi i personave të riatdhesuar.
- Aktivitete të ndryshme.

## Të drejtat e komuniteteve dhe qasja e shërbimeve

ZKKK (në tekstin e mëtejme Zyra), është koordinuar me të gjitha drejtoritë komunale me qëllim të ofrimit të shërbimeve administrative të të gjithë komuniteteve pakicë lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetit. Ajo ka qenë e hapur gjatë gjithë kohës për të gjitha komunitetet e komunës sonë. Qasja e komunitetit pakicë në shërbimet publike dhe sociale në komunën tonë është e plotë dhe nuk kemi pasur ankesa gjatë ushtrimit të çfarëdo shërbimi.

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## Të ndryshme

Në programin e IOM-it për stabilizim të komuniteteve, këtë vit janë aprovuar katër projekte për vetëpunësim dhe të gjitha janë realizuar me sukses. Po ashtu, në bashkëpunim me IOM-in dhe zyrën tonë është realizuar projekti i ndërtimit të fushës sportive shumë funksionale në shkollën fillore në fshatin Hoçë e Madhe.

## Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut

Gjatë vitit 2018, Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut ka organizuar fushata sensibilizuese sa i përket të drejtave të njeriut, vizita institucioneve lokale, shënimin e ditëve ndërkombëtare gjatë gjithë vitit, takime të rregullta, debate, përgatitja dhe shpërndarja e fletpalosjeve me informacione sa i përket të drejtave të njeriut dhe ditëve ndërkombëtare, pjesëmarrje e zyrtarëve të NJKDNJ-së në tryeza, trajnime, debate, punëtori etj.

### Aktivitetet kryesore të kësaj njësie ishin:

- Bashkëpunimi i Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut me Institucionet Lokale dhe ato Qendrore, OJQ-të, etj..
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve të zyrtarëve të NJKDNJ-së me Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme;
- Komisioni për Hartimin e Planit të Veprimit për Banim Social 3 vjeçar, ku është duke u punuar për rritjen e mundësive për përmirësimin e jetës me banime sociale në Komunën e Rahovecit.
- Shënimi i Ditëve Ndërkombëtare
- Bashkëpunim i NJKDNJ-së dhe Policisë së Kosovës, organizimi i takimeve të shpeshta dhe bashkëbisedimi sa i përket rasteve të ndryshme për të mitur dhe dhunës në familje.
- Bashkëpunim i ndërsjelltë i NJKDNJ-së me Avokatin e Popullit. Avokati i Popullit ka organizuar ditë të hapura (një herë në muaj takim me qytetarë) ku qytetarët kanë patur rastin të paraqesin ankesat e tyre.

## Barazia gjinore

Edhe pse në Komunën tonë sfidë në vetvete mbetet implementimi i Ligjit për Barazi Gjinore dhe arritja e barazisë gjinore, prapë se prapë, falë mbështetjes komunale, organizatave të ndryshme ndërkombëtare si dhe angazhimit të përbashkët të të gjithë akterëve por edhe i ZBGJ-së, kemi arritur të realizojmë një pjesë të madhe të aktiviteteve të parapara për këtë vit kalendarik dhe njëherit të bazuara në Planin Vjetor të Punës për arritjen e Barazisë Gjinore.

## Aktivitetet e riadhesimit

Lëshimi i vërtetimeve si dhe regjistrimi i personave të riadhesur në sistemin elektronik të të dhënave të punuara dhe të licensuara nga Ministria e Punëve të Brendshme – Departamentit për Riadhesim.

Vlenë të thuhet se të gjithë personat dhe familjet e lajmëruar në zyrën tonë, janë pritur dhe janë informuar në detaje lidhur me procesin e riadhesimit dhe mënyrën e përfitimit. Përfitimi më konkret është lajmërimi

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

në Entin e Punësimit – Rahovec për arsye se ky institucion ka një memorandum të mirëkuptimit me UNDP-në dhe organizatën gjermane GIZ për t'ju ndihmuar në punësim familjeve dhe personave të riatdhesuar.

## Njësia e Personelit

### Rekrutimet

Gjatë kësaj periudhe janë shpallur 24 konkurse publike . Në shërbimin civil 17 konkurse–rekrutime të personelit ; 2 konkurse publike për stafin mbështetës –teknik, 2 konkurse publike për angazhim të stafit për kontratë për punë dhe detyra specifike dhe 3 konkurse publike për angazhim të stafit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta.

### Pushimet vjetore

Deri me 30.06.2018 janë shfrytëzuar ditët e mbetura të pushimit vjetor 2017, ndërsa nga data 01.07.2018 punëtorët i kanë shfrytëzuar ditët nga pushimi vjetor të vitit 2018.

### Lëshimi i akteve administrative

Njësia e Personelit gjatë kësaj periudhe ka hartuar gjithsej 205 shkresa administrative si në vijim: vërtetime, vendime, draft-vendime, propozime , akt emërimi, informata, kontrata pune, përgjigje në ankesa, rekomandime, njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa të tjera si dhe ka dërguar mbi 350 emaille zyrtare.

### Tabelat statistikore

Të dhënat statistikore të personelit, Njësia e Personelit tani i procedon drejtpërdrejt në programin elektronik SIMBNJ, sipas kërkesës së MAP/DASHC-së, që bëhet rregullisht. Njësia e personelit të dhënat statistikore për sektorët e arsimit dhe shëndetësisë i ka siguruar nga zyrtarët e atyre dy sektorëve.

### Vlerësimi i punës provuese

Gjatë kësaj periudhe kohore është bërë vlerësimi i punës provuese të 7 punëtorëve të drejtorive të ndryshme komunale. Njësia e personelit me kohë i ka dërguar formularët për vlerësim dhe materialin e nevojshëm për vlerësim të punës provuese të eprorët e punëtorëve, si dhe ka lëshuar njoftimet për punëtorët që iu është vlerësuar puna provuese.

Sistemi i vlerësimit vjetor të punës së punëtorëve për vitin 2018 është kështu:

14,6 % janë vlerësuar shkëlqyeshëm ndërsa kriteri i formulës është 5%

50% janë vlerësuar shumë mirë ndërsa kriteri i formulës është 15%

34,6% janë vlerësuar mirë ndërsa kriteri i formulës është 30%

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## Numri i punëtorëve në administratën e Komunës së Rahovecit

Numri i punëtorëve gjithsej është: 162

Prej tyre 28 janë femra dhe 134 meshkuj

Sipas përkatësisë etnike :

- Shqiptar- 151
- Serb -9
- Egjiptas -1
- Malazez-1

2 femra në pozitat menaxheriale .

Nga gjithsej 17 të emëruar politikë në postet drejtuese femra janë 2 ndërsa meshkuj janë 10, ndërsa si staf mbështetës janë emëruar edhe 2 femra, dhe 3 meshkuj.

Çdo punëtor i ri që punësohet vendosët në SIMBNJ pasi që është përfshirë në listat e pagave .

Gjithsej 7 punëtorë të rinjtë janë punësuar për vitin 2018

## Vijueshmëria e punëtorëve në punë

- Është riaktivizuar sistemi i mbikëqyrjes së vijueshmërisë së punëtorëve në punë-SMVP.
- Janë lëshuar kartela të reja të SMVP-së për të gjithë punëtorët
- Me email zyrtar kemi njoftuar gjithsecilin punëtor dhe epror që kartelat e vijueshmërisë duhet të përdoren sipas udhëzimeve.
- Gjatë kësaj periudhe ka pasur një transferim të brendshëm të një punëtori brenda drejtorisë për administratë, pozita e të cilit i është aprovuar me katalogun e vendeve të punës.
- Gjithashtu, ka pasur një avancim brenda Drejtorisë për Administratë, duke respektuar procedurat ligjore të shërbimit civil -avancimet .

## Komisioni disiplinor

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur vetëm dy raste për ndjekje disiplinore.

- Komisioni Disiplinor në njërin rast ka shqyrtuar lëndën disiplinore dhe ka konstatuar shkelje të lehtë disiplinore për një punëtor.
- Komisioni Disiplinor në një rast ka shqyrtuar lëndën disiplinore dhe ka konstatuar shkelje të rëndë disiplinore dhe ka shqiptuar masën disiplinore ndërprerje të marrëdhënies së punës.

## Menaxhimi i burimeve njerëzore sipas programit "SIMBNJ".

Është krijuar moduli i ri në programin SIMBNJ dhe nga ky vit do të krijohet në mënyrë elektronike Plani Individual i Personelit të institucionit punëdhënës-komunë.

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

Në vazhdimësi njësia e personelit menaxhon me këtë program duke e populluar dhe freskuar me të dhëna sipas kërkesave që parashtron MAP-ja. Ky program është i dizajnuar për menaxhimin elektronik të burimeve njerëzore dhe ka hyrë si prioritet i reformës së administratës shtetërore të Qeverisë së Kosovës.

## Zyra për përfaqësim ligjor

Avokatura Komunale ka kryer të gjitha veprimet juridike të përfaqësimit në emër dhe në llogari të Komunës në procedura administrative, gjyqësore, jo gjyqësore dhe të arbitrazhit. Avokatura Komunale ka dhënë mendime me shkrim për sektorët e administratës komunale, në veçanti për të iniciuar, për të kundërshtuar apo për të tërhequr çështjet në gjykim.

Avokatura Komunale ka mbajtur gjashtë (6) regjistra, në të cilat regjistrohen lëndë sipas procedurave që zhvillohen nëpër gjykata të ndryshme:

- Regjistri për lëndë (procedure) kontestimore civile "C";
- Regjistri për lëndë (procedurë) përmbartimore "E";
- Regjistri për lëndë (procedurë) administrative dhe konfliktet administrative "A" dhe "KA";
- Regjistri për lëndë (procedurë) të ndryshme (jo kontestimore) "Nd";
- Regjistri për lëndë (procedurë) at-hezionit (Penale) "P" dhe
- Regjistri për lëndë të brendshme administrative "ZPL".


Pasqyra tabelare (si më poshtë) për të gjithë Regjistrat, paraqet lëndë në punë, të pranuar, të kryera, të pakryera dhe lëndë të mbetura si dhe pasqyra për aktivitetet e ndërmarra.

PASQYRA TABELARE E LËNDËVE SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE

|   | Sipas regjistrave të ZPL         | Civile | Përmbartimore | Proc. Administrative | Ndryshme | Proc. At. hezionit | Gjohat Mandatore | Avokatura | Gjithsej: |
|---|----------------------------------|--------|---------------|----------------------|----------|--------------------|------------------|-----------|-----------|
| 1 | Lëndë të pa zgjidhura-të bartura | 779    | 37            | 4                    | 26       | 9                  | 0                | 0         | 855       |
| 2 | Lëndë të pranuar                 | 27     | 10            | 1                    | 1        | 0                  | 0                | 0         | 39        |
| 3 | Të gjitha lëndë në punë          | 806    | 47            | 5                    | 27       | 9                  | 0                | 0         | 894       |
| 4 | Lëndë të zgjidhura               | 11     | 8             | 0                    | 0        | 4                  | 0                | 0         | 23        |
| 5 | Lëndë të mbetura                 | 795    | 39            | 5                    | 27       | 5                  | 0                | 0         | 871       |

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

Pasqyra e lëndëve në numër dhe përqindje



Aktivitetet

| Sipas regjistrave të ZPL            |                                            | Civile     | Përmbartore | Administrative | Ndryshme | Proc.At. hezbonit | Globat Mandatore | ZPL      | Gjithsej   |
|-------------------------------------|--------------------------------------------|------------|-------------|----------------|----------|-------------------|------------------|----------|------------|
| <b>Gjithsej shkresat e pranuar</b>  |                                            | <b>121</b> | <b>29</b>   | <b>6</b>       | <b>2</b> | <b>1</b>          | <b>0</b>         | <b>1</b> | <b>160</b> |
| 1                                   | Vendimet e shk.I-rë                        | 34         | 7           | 3              | 1        | 1                 |                  | 1        | 46         |
| 2                                   | Vendimet e shk.II-të                       | 7          | 1           |                |          |                   |                  |          | 8          |
| 3                                   | Vendimet e shk.III-të                      | 0          |             |                |          |                   |                  |          | 0          |
| 4                                   | Urdhër Përmbartimor                        | 0          | 13          |                |          |                   |                  |          | 13         |
| 5                                   | Aktvendim për 180 ditë (pezullim i lëndës) | 17         |             |                |          |                   |                  |          | 17         |
| 6                                   | Padia me aktvendim për përgjigje           | 19         |             |                |          |                   |                  |          | 19         |
| 7                                   | Precizimi i padisë të paditësit            | 5          |             |                |          |                   |                  |          | 5          |
| 8                                   | Parashtresat tjera të pranuar              | 32         | 9           | 4              | 1        | 0                 |                  | 1        | 48         |
| <b>Gjithsej shkresat e dërguara</b> |                                            | <b>43</b>  | <b>8</b>    | <b>1</b>       | <b>1</b> |                   |                  | <b>1</b> | <b>53</b>  |
| 1                                   | Ankesat                                    | 15         |             |                |          |                   |                  |          | 15         |
| 2                                   | Përgjigje në ankesë                        | 2          |             | 1              |          |                   |                  |          | 3          |
| 3                                   | Përgjigje në Padi                          | 19         |             |                |          |                   |                  |          | 19         |
| 4                                   | Mbrojtje në Padi Gj.Supreme                | 1          |             |                |          |                   |                  |          | 1          |
| 5                                   | Revizionet                                 | 2          |             |                |          |                   |                  |          | 2          |
| 6                                   | Përgjigje në revizion                      | 1          |             |                |          |                   |                  |          | 1          |

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

|    |                                       |   |   |  |  |  |   |
|----|---------------------------------------|---|---|--|--|--|---|
| 7  | Kërkesat për mbrojtjen e Ligjshmërisë | 1 |   |  |  |  | 1 |
| 8  | Përgjigje në mbrojtje të Ligjshmërisë | 0 |   |  |  |  |   |
| 9  | Prapësimet                            |   | 8 |  |  |  | 8 |
| 10 | Ushtrimi i padisë                     |   |   |  |  |  |   |
| 11 | Ushtrimi i propozimit për përbarim    |   |   |  |  |  |   |
| 12 | Parashtresat tjera të dërguara        | 4 | 1 |  |  |  | 5 |

Vlera ( Kontigjente) e të gjitha kontesteve ( komuna e paditur / debitore)

|   | Sipas regjistrave të Avokaturës | €uro                   | Dinarë                    | Shpenzime t procedural e | Shpenzim et e përfaqësi mit | Shpenzi met tjera |
|---|---------------------------------|------------------------|---------------------------|--------------------------|-----------------------------|-------------------|
| 1 | Civile                          | 32,468,294.61          | 13,962,341.00             | 470.00                   | 0.00                        | 0.00              |
| 2 | Përbarimore                     | 105,576.79             | 0.00                      | 1,643.00                 | 0.00                        | 0.00              |
|   | Të përbarueshme                 | 22,431.35              |                           |                          |                             |                   |
| 3 | Proc.Administrative             | 0.00                   | 0.00                      | 0.00                     | 0.00                        | 0.00              |
| 4 | Ndryshme                        | 0.00                   | 0.00                      | 0.00                     | 0.00                        | 0.00              |
| 5 | Proc.At_hezionit                | 0.00                   | 0.00                      | 0.00                     | 0.00                        | 0.00              |
| 6 | ZPL                             | 0.00                   | 0.00                      | 0.00                     | 0.00                        | 0.00              |
|   | <b>Gjithsej:</b>                | <b>32,499,129.36 €</b> | <b>13,962,341.00 din.</b> | <b>2,113.00 €</b>        | <b>- €</b>                  | <b>- €</b>        |

## Lëndë në Procedurën Civile (Regjistri "C")

Sipas regjistrit të lëndëve civile, Komuna është **paditëse në 14 lëndë**, ndërsa Komuna është **e paditur në 792 lëndë**.

| Nr. | Llojet e padive/kontestet, regjistri "C" | Nr. i lëndëve |
|-----|------------------------------------------|---------------|
| 1   | Vërtetim i pronësisë                     | 323           |
| 2   | Kompensim dëmi                           | 227           |
| 3   | Anulim i kont. për falje                 | 84            |
| 4   | Kompensim i pagave pas pensionimit       | 33            |
| 5   | Kontest pune                             | 31            |
| 6   | Kompensim i paluajtshmërisë              | 27            |
| 7   | Anulim i kont. për ndërrim               | 22            |
| 8   | Dorëzim i paluajtshmërisë                | 12            |
| 9   | Borxh                                    | 12            |
| 10  | Pasurim i pa bazë                        | 8             |
| 11  | Anulim i Aktvendimit                     | 6             |
| 12  | Uzurpim i paluajtshmërisë                | 3             |

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

|    |                                                      |   |
|----|------------------------------------------------------|---|
| 13 | Pengim posedimi                                      | 3 |
| 14 | Anulim i kontr. për banesë                           | 2 |
| 15 | Mos përmbushja e obligimit                           | 2 |
| 16 | Vërtetim i servitutit                                | 2 |
| 17 | Lirimi i banesës                                     | 2 |
| 18 | Vërtetim i pronësisë në bazë të mbajtjes             | 1 |
| 19 | Anulim i kontr. për shitblerje                       | 1 |
| 20 | Kthimi i pasurisë                                    | 1 |
| 21 | Zgjidhja e kontratës                                 | 1 |
| 22 | Realizimi i kontratës për ndërrim të paluajtshmërisë | 1 |
| 23 | Vërtetim i pronësisë në bazë të ndërtimit            | 1 |
| 24 | Kompensim dëmi në bazë të ndërtimit                  | 1 |
| 25 | Zgjidhjen e kontratës për menaxhim                   | 1 |
| 26 | Kthimi i mjeteve nga kontrate nule                   | 1 |

## Shënime Statistike Plotësuese:

Nga 212 lëndë për kompensimin e dëmit (gjatë luftës dhe periudha pas luftës), të ngritura nga komuniteti serb, vlera e përgjithshme e kontesteve është 31,031,277.00 EURO. Në këto lëndë të paditur janë: Komuna e Rahovecit, Qeveria e Përkohshme e Kosovës, UNMIK-u dhe KFOR. Pas nënshkrimit të Marrëveshjeve Kolektive, kemi një valë të padive, (deri më tani rreth 33 padi), nga punëtorë të pensionuar në emër të pensionimit dhe shpërbërimit jubilar, ku vlera e padive arrinë në 117,418.33 EUR. E paditur është Komuna e Rahovecit si punëdhënësi i fundit.

## Lëndë në Procedurën Përmbartimore (Regjistri "E")

Komuna në këtë regjistrë paraqitet kreditore në 16 lëndë, ndërsa debitorë në 22 lëndë. Vlera e borxhit në lëndë të cilat është debitorë, është rreth 105.576,00 EUR. Prej tyre 22,431.35 EUR janë të ekzekutueshme, pjesa tjetër është në procedurë të rregullt të kontestimit.

|   |                    | Euro               | Komuna Kreditore   | Shpenzimet procedurale | Shpenzimet e përfaqësimit | Shpenzime t tjera |
|---|--------------------|--------------------|--------------------|------------------------|---------------------------|-------------------|
| 1 | (E)- Përmbartimore | 105,576.79         | 0.00               | 1,643.00               | 0.00                      | 0.00              |
| 2 | Të përmbartueshme  | 22,431.35          | 24,000.00          |                        |                           |                   |
|   | <b>Gjithsej:</b>   | <b>22,431.35 €</b> | <b>24,000.00 €</b> | <b>2,113.00 €</b>      | <b>- €</b>                | <b>- €</b>        |

## Lëndë në procedurën/konfliktet administrative (Regjistri "ND")

Në këtë kategori veçohet lënda e procedurës së shpronësimit të hapjes së rrugës përgjatë fabrikës së plastikës. Lënda është ankuar dhe gjendet në shqyrtim nga Gjykata Themelore Prishtinë – Departamenti Administrativ. Lidhur me këtë lëndë, pas kalimit e të gjitha afateve ligjore për të vendosur, Gjykata dërgon Aktvendim të paditurës për përgjigje në padi, edhe pse kjo përgjigje gjendet në shkresat e lëndës.

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

**Seancat e caktuara nga kontestet civile dhe kontestet tjera nga gjykatat për periudhën raportuese:**

Sipas regjistrimit të seancave gjyqësore, gjatë periudhës raportuese janë mbajtur gjithsej 77 seanca gjyqësore, ku Komuna e Rahovecit është paraqitur si palë nga të gjitha procedurat gjyqësore.

**Lëndë të kryera gjatë periudhës raportuese:**

Në procedurën kontestimore civile janë kryer gjithsej 12 lëndë, prej tyre Komuna del me rezultat pozitiv në 11 lëndë, ndërsa konstatohet me rezultat negativ një (1) lëndë. Në procedurën përmbartimore nga tetë (8) lëndë të kryera, shtatë (7) lëndë dalin me rezultat negativ, ndërsa një (1) lëndë me rezultat pozitiv.

## DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme në bazë të kompetencave ka bërë ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera komunale dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Rahovecit, në kuadër të kompetencave të veta apo të deleguara ligjore gjatë vitit kalendarik 2018.

### Aktivitetet e realizuara nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

DAP ka kryer shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera të kësaj drejtorie duke i përfshirë;

- Ofrimin i shërbimeve dhe kryerjen e punëve administrative mbështetëse për punët e Kuvendit të Komunës, të drejtorëve të drejtorive, të administratës komunale, të trupave punues (komiteteve) të Kuvendit Komunal.
- Përpilimin e ftesave dhe të vendimeve që dalin nga mbledhjet e caktuara, përpilimin dhe lekturimin profesional të materialeve në gjuhët zyrtare në Komunën e Rahovecit
- Pranimin dhe procedimin e materialeve për shpërndarjen e materialeve për anëtarët e asamblesë komunale nga zyrat e gjendjes civile të komunës së Rahovecit.
- Ka bërë propozimet (hartimet) e projekt rregulloreve dhe propozim vendimeve të përgjithshme administrative, si dhe propozime për ndryshimin dhe plotësimin e akteve të përgjithshme nënligjore në fuqi (në juridiksionin komunal).
- Ka bërë dhe bën regjistrimin dhe mbajtjen e evidencës së materialit zyrtar që pranohet dhe dorëzohet nga zyra e arkivit të administratës së Komunës, si dhe arkivimin e lëndës arkivore dhe kujdeset për ruajtjen e saj, për ruajtjen e akteve materiale të administratës (librat amë, kartotekat, protokollet, regjistrat, etj)
- Kemi bërë të gjitha format e shërbimeve dhe të ndihmës juridike për qytetarët duke regjistruar të gjitha kërkesat dhe parashtresat e tyre, kemi bërë raportimin për kryerjen e lëndëve administrative në suaza të afateve ligjore dhe zyrtare sipas LPA dhe ligjeve të tjera të veçanta dhe akteve nënligjore në fuqi.
- Jemi kujdesur dhe kemi zbatuar me efikasitet të lartë dhe të shërbimet postare për nevojat e organeve komunale dhe organeve të administratës komunale.

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

- Kemi menaxhuar me racionalitet të plotë dhe të domosdoshëm me fushën e logjistikës, ku përfshihet menaxhimi i automjeteve, titullar pronësore e të cilave është Komuna e Rahovecit, duke ushtruar në permanencë mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, servisimin, sigurimin dhe regjistrimin e tyre, furnizimin transparent me derivate.
- Kemi bërë organizimin dhe kujdesin për mirëmbajtjen e objektit të administratës komunale si dhe organizimin e shërbimeve të sigurimit për këto objekte duke i vendosur kamerat e sigurisë.
- DAP është fokusuar në të gjitha punët rreth përkujdesjes dhe mirëmbajtjes së teknologjisë informative dhe avancimit të saj për nevoja zyrtare .
- Është bërë hapja dhe funksionalizimi i zyrave të gjendjes civile në Krushë të Madhe dhe në Çifllak ( janë pajisur me inventar )
- Të gjitha objektet e Z.GJ.C-së, janë furnizuar me lëndë djegëse.
- Është bërë ndërrimi i bombolave të gazit në objektet e Komunës.
- Kemi bërë koordinimin me KEDS-in për zhvendosjen e trafostacionit të vjetër nga oborri i komunës.
- Janë pajisur i gjithë stafi i komunës me ID dhe është bërë përditësimi i numrave të telefonit në regjistrin e MAPL-së; mirëmbajtja e rrjetit, llogarive, aplikacioneve, konfigurimi i kompjuterëve të rinj;.
- Janë asistuar të gjitha rastet e të ri-atdhesuarve
- Kemi bërë organizimin e zgjedhjes së këshillave lokalë të fshatrave dhe lagjeve urbane të komunës së Rahovecit
- Shërbimet e gjendjes civile ,të cilat përshijnë rregullimin juridiko-ligjor të statusit personal dhe familjar të qytetarëve të komunës së Rahovecit në kuadër të kompetencave të deleguara;
- Lëshimin e certifikatave që dëshmojnë statusin e gjendjes civile për qytetarët, duke përfshirë edhe certifikatat e vendbanimit dhe të ndërrimit të emrit personal si dhe procedurat e lirimt nga shtetësia si kompetencë e deleguar inicuese për ministritë përkatëse.
- Vërtetimin e origjinalitetit të dokumenteve të ndryshme si dhe deklarata, vërtetime dhe parashtrësia të tjera, për nevojat e qytetarëve, duke u bazuar gjithmonë në dispozitat ligjore gjatë lëshimit të tyre.

Drejtoria e administratës ka kryer edhe punë të tjera administrative të cilat janë deleguar nga organet qendrore të pushtetit të Republikës së Kosovës si dhe punë tjera administrative të autorizuar dhe të urdhëruara nga Kryetari Komunës si:

- Rregullimi dhe sistemimi punëtorëve në sportelet përkatëse, që shërbimi për qytetarë të jetë më në nivel.
- Rregullimi i sportelit për mërgimtarë
- Lehtësimin e procedurave për marrjen e dokumenteve dhe shërbimeve të tjera të nevojshme në kohën e pushimeve për mërgatën.
- Zgjatja e orarit të punës nga Zyra e Gjendjes Civile për muajin e mërgatës.
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme në muajin e mërgatës
- Rregullimi i sallës për kurorëzime.

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET

Raporti i kësaj drejtorie mungon pasi që akoma nuk është i përfunduar. Arsyeja e mospërfundimit qëndron sepse ende nuk është bërë barazimi me Ministrinë e Financave.

Në momentin e përfundimit dhe harmonizimit me Ministrinë, raporti nga kjo drejtori do të jetë si pjesë shtesë dhe do të publikohet si i veçantë.

## DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Raporti vjetor i punës për vitin 2018 i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Rahovec, paraqet punën, zhvillimin dhe të arriturat kryesore të Drejtorisë dhe stafit të saj. Përmes këtij raporti, DSHMS, paraqet detyrat dhe të arriturat drejt realizimit të planit të punës si dhe detyrat tjera që dalin sipas detyrës zyrtare për të ofruar shërbime sa më cilësore për qytetarët e komunës së Rahovecit. Caktimi i prioriteteve të punës dhe përcjelljen e nevojave sociale, shërbimeve shëndetësore ka qenë punë e përditshme e DSHMS-së dhe stafit të saj.

### Aktivitetet e DSHMS-së për periudhën raportuese janë:

- Konsultimet dhe takimet e rregullta me stafin, Drejtorinë e QPS-së dhe QKMF-së në Rahovec,
- Përpilimi i raporteve mujore të punës për vitin 2018,
- Angazhimi rreth përmirësimit të kushteve për punë të nëpunësve dhe stafit në përgjithësi në kuadër të DSHMS-së,
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve, si dhe të atyre për ndihmë momentale-financiare,
- Pjesëmarrja aktive në kolegjiun e drejtorëve të DSHMS-së, në cilësinë e anëtarit të kryesisë në kuadër të Asociacionit të Komunave.

### Të arriturat e drejtorisë janë:

- Ofrimi i shërbimeve mjekësore në dy ndërrime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe Rakoc.
- Vaksinimi permanent në QMF në Opterushë, ku gravitonjë popullata e fshatrave Zaqisht, Reti, dhe Reti e Ulët.
- Nënshkrimi i marrëveshjes me Caritas Kosova, për ofrimin e shërbimit të kujdesit shtëpiak "Home Care" për persona në regjim shtrati. Numri i të punësuarve me këtë marrëveshje është 43 punëtorë shëndetësorë.
- Ndërtimi i objektit të qendrës kryesore të mjekësisë familjare dhe emergjenca faza e parë, si dhe renovimi i objekteve shëndetësore në komunën e Rahovecit.
- Spërkatja kundër rriqrave pasi Rahoveci njihet si një zonë endemike.
- Vizitat sistematike mjekësore të nxënësve në shkollat e komunës së Rahovecit.
- Drejtoria e shëndetësisë në vitin 2018 ka marrë donacione, një autoambulancë, pajisje mjekësore nga kompania telefonike "IPKO" për nevojat e repartit të gjinokologjisë, si dhe donacione nga organizatat ndërkombëtare siç është AQH-ja. Poashtu, kemi marrë donacion edhe barnat për QMF, në Opterushë nga mërgimtarët për furnizim me barna për nevojat e QMF-së,
- 200 pacientë me probleme me sy janë pajisur me syze sipas nevojës.

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## DREJTORIA PËR ARSIM

Në këtë raport të shkruar janë paraqitur synimet, qëllimet, punët, projektet dhe aktivitetet kryesore që kanë karakterizuar DKA-në gjatë gjithë vitit 2018.

Drejtoria Komunale për Arsim me aktivitetet e saja gjatë gjithë vitit kalendarik 2018 kishte synim të përgjithshëm:

Përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë në arsim në të gjitha nivelet e sistemit edukativo arsimor në komunën tonë.

### Qëllime kryesore patëm:

- Ngritjen e cilësisë së procesit edukativo-arsimor në shkollat fillore të mesme të ulëta, të mesme të larta dhe profesionale të Komunës së Rahovecit,
- Përmirësimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme të institucioneve edukativo arsimore,
- Zhvillimin e aktiviteteve të shumta kurrikulare dhe jashtëkurrikulare,
- Funksionimin sa më të mirë të organeve drejtuese të shkollave,
- Ngritjen dhe zhvillimin profesional të kuadrit arsimor.

### Objektivat tona të përhershme, që karakterizuan edhe vitin 2018, janë:

- Përmirësimi i nivelit të mësimdhënies dhe të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Rahovecit,
- Zvogëlimi deri në minimum i mungesave të pa arsyeshme të nxënësve dhe mësimdhënësve,
- Ndërtimi i objekteve të reja shkollore dhe objekteve parashkollore (çerdheve)
- Riparimet e objekteve shkollore,
- Rregullimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollës,
- Zhvillimi i aktiviteteve të shumta jashtëkurrikulare në nivel shkolle dhe komune,
- Futja në procesin e implementimit të KB dhe KKK për të gjitha shkollat e komunës
- Bashkëpunimi me komunitetin dhe me OJQ-të,
- Integrimi në procesin edukativo-arsimor i të gjithë fëmijëve të të gjitha komuniteteve pa dallim
- Ngritja e nivelit të vetëdijësimin për detyrat dhe përgjegjësitë dhe llogaridhënia (në veçanti tek drejtuesit e shkollave)

### Aktivitetet

Drejtoria për Arsim që në fillim të punës dhe gjatë gjithë vitit ka filluar dhe ka realizuar shumë aktivitete. Si rezultat i këtyre aktiviteteve, gjendja në arsim në komunën tonë, ka filluar të përmirësohet. Aktivitetet e shumta të DKA-së të kësaj periudhe mund t'i përfshijmë në këto pika kryesore:

- Në fillim të punës, në muajin janar kemi mbajtur takim me të gjithë drejtorët e shkollave, në të cilin jemi njohur për gjendjen e vijueshmërisë së nxënësve dhe suksesit të përgjithshëm të nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017/2018.
- Gjatë muajit janar dhe shkurt, kemi vizituar të gjitha shkollat dhe me ekipin e inxhinierëve të komunës kemi inçizuar gjendjen infrastrukture dhe fizike të të gjitha shkollave. Pas inçizimit të

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

gjendjes fizike të shkollave kemi përpiluar një raport detal të gjendjes infrastrukturore të shkollave dhe kemi adresuar disa kërkesa për riparime në shkolla drejtuar Ministrisë së Arsimit.

- Në këtë periudhë kemi kërkuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik ridestinimin e projektit të eficiencës së energjisë nga SHFMU "Liria" në Fortesë, në SHFMU "Vëllezërit Frashëri" në Drenoc. Kjo kërkesë jona është aprovuar.
- Me datë 22 shkurt Drejtori i DKA-së ishte në një takim me kolegjiun e Arsimit në Prishtinë, të thirrur nga Asociacioni i Komunave të Kosovës
- Me datë 23 shkurt kemi realizuar një mbledhje të përbashkët ndërmjet DKA-së, Kryesisë së Këshillit Komunal të Prindërve dhe Kryesisë së Sindikatës së Bashkuar të Arsimit të Komunës së Rahovecit. Në këtë mbledhje ftuam edhe të gjithë drejtorët e shkollave. Në këtë takim apeluan tek Sindikata e Arsimit që të ndërpritet greva e thirrur nga ta.
- Me datë 26 shkurt themeluan Këshillin Organizativ për shënimin e 7 Marsit - Ditës së Mësuesit, Këshill ky që numëroi 9 anëtarë dhe kishte për detyrë të bëjë organizimin sa më të mirë të këtij aktiviteti. Këtij këshilli i priu drejtori i DKA-së.
- Në muajt në vazhdim kemi identifikuar problemet e mbarëvajtjes së procesit edukativo arsimor dhe kemi marrë masa adekuate, që vijueshmëria e nxënësve në shkolla të përmirësohet. Kemi themeluar dhe riaktivizuar Këshillat e shkollave, Këshillat e prindërve dhe Këshillat e nxënësve në shumicën e shkollave.
- Kemi marrë vendim të ndihmojmë në transportin e nxënësve në dy linja udhëtimi: Linja Gur i Kuq – Kramovik dhe Linja Reti e Poshtme - Piranë. Këto dy linja udhëtimi tashmë janë funksionale.
- Në muajt mars, prill, maj, kemi mbajtur disa aktivitete kulturore dhe artistike, aksione vullnetare dhe gara të ndryshme me nxënës. Përmes këtyre garave dhe aktiviteteve kemi rritur interesimin e nxënësve dhe mësimdhënësve, gjë që u dëshmuar edhe me pjesëmarrjen massive të tyre.
- Në katër shkolla të komunës sonë, duke filluar nga ky vit, me insistimin dhe angazhimin tonë morëm konfirmimin nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik se në këto shkolla të komunës sonë do të zbatohen masat e eficiencës së energjisë, ndërsa 12 shkolla kanë përfutur grante zhvillimore nga projektet e Bankës Botërore dhe Ministrisë së Arsimit.
- Pas 3 vitesh pauzë në qeverisjen e kaluar, me qeverisjen tonë kemi rifilluar traditën e ndarjes së bursave dhe për këtë vit qeverisja jonë ndau bursa për 63 studentë të komunës sonë.
- Poashtu kemi evidencuar të gjitha të dhënat për situacionet e riparimeve që kanë ndodhur dhe që pritet të ndodhin gjatë vitit në 12 shkolla të komunës sonë nga operatori që ka kontratë dy vjeçare me komunën.
- Gjatë muajve korrik dhe gusht janë mbajtur trajnime kurrikulare për mësimdhënësit, të cilëve u mungonin këto trajnime.
- Në fund të muajit gusht, nga Ministria e Arsimit kemi pranuar të gjitha librat/tekstet shkollore për klasat 1 deri 9, të cilat fillimisht i kemi vendosur në pikën grumbulluese dhe pastaj brenda javës së parë të muajit shtator i kemi shpërndarë në të gjitha shkollat fillore të komunës sonë. Fillimi i Vitit të Ri Shkollor si në mbarë Kosovën, edhe tek ne ishte më 3 shtator, ditë e hënë, dhe që në fillim, të gjitha SHFMU-të e komunës sonë ishin të pajisura me tekste shkollore, mirëpo ishin disa tekste të lëndës së gjuhës gjermane për klasat e 6-ta dhe të 7-ta, të cilat Ministria e Arsimit i pati vonuar dhe ato u shpërndanë më vonë.
- DKA ka grumbulluar të gjitha kërkesat e shkollave për lëndë djegëse që do të përdoren për ngrohje gjatë muajve të dimrit, por me vendimin e Ministrisë së Arsimit të datës 20 korrik 2018, është ndaluar përdorimi i thëngjillit në të gjitha institucionet edukativo arsimore. Me hyrjen në fuqi të këtij

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

vendimi, DKA ka kërkuar nga Zyra e Prokurimit që të ndalojë procedurat e prokurimit për thëngjill si lëndë djegëse.

- Gjatë muajit shtator kemi hapur tenderin për ndërtimin e shkollës së re në Hoçë të Vogël /Brestoc dhe jemi kujdesur që të përgatisim projektin e ri për ndërtimin e shkollës së re në fshatin Reti, tenderin e të cilit e kemi hapur në muajin tetor.
- Prej fillimit të vitit të ri shkollor 2018/2019 dhe në vazhdimësi, drejtori i arsimit ka mbajtur takime të njëpasnjëshme me këshillat e arsimtarëve të çdo shkolle, në të cilat ka bashkëbiseduar me të gjithë mësimdhënësit për mbarëvajtjen e procesit edukativo arsimor.
- Në fillim të muajit tetor kanë filluar trajnimet e grupit të pare të mësimdhënësve për udhëheqje dhe menaxhim të shkollave.
- Gjatë muajit tetor dhe deri para fillimit të sezonit dimëror të ngrohjes më 15 nëntor 2018, në të gjitha shkollat është bërë furnizimi me dru dhe lëndë tjera djegëse për ngrohje.
- Në muajin nëntor kemi nënshkruar kontratat për fillimin e punimeve për ndërtimin e Çerdhes për Fëmijë në fshatin Ratkoc dhe për ndërtimin e objektit të shkollës së re në Hoçë të Vogël/Brestoc. Më 27 nëntor 2018 është vënë gurthemeli i fillimit të punimeve të këtyre dy projekteve.
- Me datë 28 nëntor, në bashkëpunim me DKRS-në, Drejtoria e Arsimit ka organizuar një varg aktivitetesh për shënimin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit.
- Gjatë muajve nëntor dhe dhjetor është bërë kontroll dhe verifikim i procesit të vlerësimit të nxënësve nga ana e mësimdhënësve në të gjitha shkollat dhe poashtu janë marrë masa adekuate, të cilat kanë dhënë rezultate në zvogëlimin e numrit të mungesave të nxënësve dhe mësimdhënësve.

## Synimet kryesore e DKA-së për vitin në vazhdim janë:

- Themelimi dhe funksionalizimi i Ekipit Profesional Vlerësues në kuadër të DKA-së,
- Funksionalizimi i plotë i Ekipëve Profesionale Vlerësuese në secilën shkollë,
- Zgjerimi i stafit të DKA-së me kuadrin e nevojshëm të pedagogëve dhe psikologëve,
- Riparimet dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore,
- Investimi në ndërtimin e 3 çerdheve për fëmijë,
- Vazhdimi i projekteve për ndërtimin e shkollave të reja të filluara nga viti 2018,
- Ndërtimi i shkollave të reja,
- Furnizimi i shkollave me libra, pajisja me laboratorë dhe teknologji informative,

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm gjatë vitit 2018 është angazhuar në modernizimin e tregut në sektorin privat, shërbimet efikase për të gjitha bizneset e komunës sonë, po ashtu në ofrimin e kushteve në të bërit biznes me një klimë më të përshtatshme për të gjithë bizneset e komunës. Veprimtaria e saj është e bazuar në planin e punës për vitin 2018.

Për herë të parë që nga viti 2000 është bërë regjistrimi i aseteve komunale, në të gjithë administratën komunale në QKMF, AMF, shkolla dhe institucione të tjera për asetet nën vlerën 1,000€. Këto asete janë regjistruar në programin E-Pasuria.

Janë regjistruar të gjitha investimet kapitale, parcela të tokave dhe është duke u punuar në përfundimin dhe vlerësimin e të gjitha tokave të komunës së Rahovecit.

Formimi i Këshillit të Bizneseve dhe bartja e Zyrës për Turizëm të Shtëpia e Verës, si dhe funksionalizimi i kësaj zyreje mund të themi se është një ndër sukseset e radhës të drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm. Në bazë të një hulumtimi dhe anketimi që ju është bërë bizneseve në Kosovë nga INDEKSI I KONKURRUESHMERISË SË KOMUNAVE, ky indeks e rendit Rahovecin me zyrën e Regjistrimit të bizneseve (ARBK-në), të parën për shërbime të shpejta dhe efikase.

Duke u bazuar në buxhetin e planifikuar të vitit 2018, si dhe planin e punës, kjo është ecuria e implementimit të projekteve kapitale.

- Investime në Zonën Ekonomike në Opterushë, ku është bërë rrafshimi dhe nivelizimi i një hapësire të zonës ekonomike: 7.200 m<sup>2</sup>.
- Shtegu i ecjes të Maja e Shkodranit në Rahovec – Pikë Turistike, projekt i fituar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në vlerë 125.000.00€, me një rëndësi të veçantë për qytetarët e Komunës së Rahovecit.

## Zyra për zhvillim ekonomik

Të hyrat dhe ngarkesat në sektorin për zhvillim ekonomik.

Tabela me përshkrimin e të hyrave:

| Nr | Përshkrimi i të hyrave | Vlera €    |
|----|------------------------|------------|
| 1  | Të hyrat nga qiraja    | 75,689.66€ |
| 2  | Saldoja e mbetur       | 38,487.13€ |

## Zyra e regjistrimit të bizneseve

Për periudhën raportuese, në Zyrën e Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve (QKRB) janë të regjistruara në protokoll biznese të reja dhe janë shqyrtuar, gjithsej lëndë:

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

| Nr.      | PËRSHKRIMI                     | Viti 2017 | Viti 2018 |
|----------|--------------------------------|-----------|-----------|
| 1        | Biznese të reja                | 124       | 165       |
| 2        | Shuarje biznesi                | 41        | 39        |
| 3        | Informatë biznesi              | 48        | 100       |
| 4        | Ndryshim biznesi               | 47        | 82        |
| 5        | Duplikat certifikatë           | 10        | 12        |
| 6        | Çertifikatë UNMIK-RKS          | 15        | 9         |
| 7        | Vërtetime                      | 6         | 2         |
| 8        | Konfirmime                     | 17        | 15        |
| 9        | Çertifikatë e re, pas dëmtimit | 0         | 4         |
| 10       | Numri fiskal                   | 0         | 0         |
| 11       | Konsultime + Korigjime         | X         | x         |
| Gjithsej |                                | 308       | 428       |

## Zyra për taksa afariste komunale

Gjatë kësaj periudhe të punës fokusi kryesor ka qenë:

- Të rriten të hyrat dhe inkasimi i borxheve të trashëguara.
- Është bërë regjistrimi i të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2017 dhe regjistrimi në librin e ri të vitit 2018;
- Është bërë regjistrimi dhe kalkulimi i ngarkesave për vitin 2018, në formë elektronike;
- Verifikimi i bizneseve aktuale, të cilat nuk kanë mundur të verifikohen në vitin 2017 dhe regjistrimi i bizneseve të reja;
- Është bërë shpërndarja e aktvendimeve në të gjitha bizneset.

## Tabelar me të hyra nga taksat afariste komunale

| NR | MUJTI  | VITI 2017 | OBJEKTIVI 2018                                                                      | VITI 2018 | DIFER, 2017-2018 |
|----|--------|-----------|-------------------------------------------------------------------------------------|-----------|------------------|
|    |        | SHUMA     |  | SHUMA     |                  |
| 1  | JANAR  | 1,825,00  |                                                                                     | 2.192,00  | 367,00           |
| 2  | SHKURT | 3.470,00  |                                                                                     | 5.271,00  | 1.801,00         |
| 3  | MARS   | 8.866,00  |                                                                                     | 13.398,00 | 4.532,00         |
| 4  | PRILL  | 7.374,00  |                                                                                     | 13.993,00 | 6.619,00         |
| 5  | MAJ    | 1.0952,00 |                                                                                     | 9.856,00  | - 1.096,00       |
| 6  | QESHOR | 7.179,00  |                                                                                     | 7.677,00  | 498,00           |
| 7  | KORRIK | 7.031,00  |                                                                                     | 6.228,00  | - 803,00         |

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

|    |         |           |                                    |            |           |
|----|---------|-----------|------------------------------------|------------|-----------|
| 8  | GUSHT   | 3.874,00  |                                    | 12.967,00  | 9.093,00  |
| 9  | SHTATOR | 3.232,00  |                                    | 9.774,00   | 6.542,00  |
| 10 | TETOR   | 3.425,00  |                                    | 15.305,00  | 11.880,00 |
| 11 | NENTOR  | 2.819,00  |                                    | 3.275,00   | 456,00    |
| 12 | DHJETOR | 5.075,00  |                                    | 6,160.00   | - 925,00  |
|    | TOTALI  | 65.122,00 | Totali i objektivit<br>80,000.00 € | 106.096,00 | 40,974.00 |

Totali i të hyrave në bazë të planifikimit është tejkaluar për 26,096.00 €

## Regjistrimi i pasurisë komunale

Komisioni i formuar me vendim të Kryetarit ka bërë shpërndarjen e bar-kodeve nëpër administratë komunale, institucione arsimore, shëndetësi etj. Për herë të parë në Komunën e Rahovecit është bërë regjistrimi i komplet i aseteve jo financiare.

| Regjistrimet e pasurisë mbi 1000€ | Regjistrimet e pasurisë nën 1000€ | Regjistrimi i ngastrave të tokës | Vlera e përgjithshme e regjistrimeve në € |
|-----------------------------------|-----------------------------------|----------------------------------|-------------------------------------------|
| 147                               | 237                               | 360                              |                                           |
| Vlera në €                        | Vlera në €                        | Vlera në €                       | Vlera në €                                |
| 4,935.430€                        | 23,851.97€                        | 10,821.783€                      | 15,781.064€                               |

## Zyra për informacione turistike (ZIT-TIC)

Zyra për Informacione Turistike, në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm i ka zbatuar detyrat dhe obligimet e përcaktuara:

- Pritjen dhe informimin e të gjithë turistëve që kanë frekuentuar komunën tonë gjatë kësaj periudhe;
- Takimet me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që lidhen me sektorin e turizmit,
- Kemi organizuar disa takime me grupet e bizneseve dhe janë informuar lidhur me skemën e granteve nga ministritë përkatëse.
- Pjesë përbërëse e këshillit organizativ për panairin "100% Rahovec".

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## DREJTORIA E URBANIZMIT, PLANIFIKIMIT DHE MJEDISIT

Gjatë këtij viti në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit janë kryer punët të cilat janë paraparë, në bazë të Planit të Punës për vitin 2018. Kërkesat e palëve në këtë sektor janë shqyrtuar në afatin ligjor.

Gjithsej, në periudhën raportuese janë shqyrtuar 276 kërkesa të qytetarëve. 201 janë aprovuar, 41 janë refuzuar, 9 janë ceduar, ndërsa 22 kërkesa janë në shqyrtim dhe 2 dy lëndë kanë qenë të trashëguara nga viti 2017.

Nga këto kërkesa janë lëshuar: kushte ndërtimore, leje ndërtimore, leje rrënimi, pëlqime, leje përdorimi, ndërrim-destinimi, vërtetime urbanistike, vendime, referenca, njoftime dhe shkresa të tjera.

Realizimi i të hyrave nga Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit gjatë vitit 2018 është: 18.125.86 €.

Në pjesën e Planifikimit Hapësinor, është lidhur kontrata për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe është shpallur tenderi si konkurs projektimi për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit.

Për ecurinë dhe punën e Komitetit Drejtues për hartimin e PZHK-se është informuar edhe Kuvendi i Komunës së Rahovecit. Janë mbajtur takime me qytetarë në dëgjimet publike, në qendrën urbane në Rahovec si dhe në gjashtë nën qendrat, të cilat janë caktuar edhe me PZHK, në Krushë të Madhe, Xërxë, Ratkoc, Çifllak, Drenoc dhe Opterushë.

## Projektet kapitale:

Në fushën e projekteve kapitale, Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka trashëguar disa projekte të cilat kanë qenë në vazhdim. Projektet janë verifikuar dhe analizuar, punimet në këto projekte kanë vazhduar dhe disa prej tyre janë përfunduar. Po ashtu, janë shpallur tenderë edhe në projekte të reja.

- Kanë përfunduar punimet në rregullimin e shtratit të lumit në fshatin Zoqisht, kanë vazhduar punimet në rregullimin e disa pozicioneve në shtratin e lumit Duhlllo në Rahovec, po ashtu kanë vazhduar edhe punët në rregullimin e disa pjesëve të shtratit të lumit Rimnik në Fortesë.
- Kanë vazhduar punët në Ndërtesën për Banim Social në Rahovec, projekt i trashëguar, të cilin synojmë që në vitin 2019 të përfundojë.
- Është lidhur kontrata për rregullimin e shtratit të lumit ndërmjet fshatrave Krushë e Madhe dhe Celinë, i cili është projekti më i madh i nisur në vitin 2018 nga Komuna e Rahovecit, me të cilin synojmë t'i japim zgjidhje problemeve me vërshime në këto vendbanime.
- Është lidhur kontrata në projektin për krijimin e hapësirave të gjelbëruara dhe mbjellja e drunjëve dekorativ. Vendbanimet të cilat kanë përfituar nga mbjellja e drunjëve janë: Rahoveci – janë mbjellë drunjë në rrugët kryesore dhe në vendet ku kanë munguar. Në dy dalje të qytetit, rrugës për Malishevë dhe rrugës për Suharekë, Fortesa, Opterusha, Zoqishti, Brestoci, Hoça e Vogël, Krusha e Madhe, Drenoci, Xërxë, rruga kryesore nga fshati Gexhe, Radoste, Ratkoc dhe deri afër fshatit Dejnë, dhe do të vazhdojë në vitin 2019 deri në Kramovik mbjellja e drunjëve. Në këtë projekt në tërësi janë mbjellë 3,500 drunjë.
- Është rregulluar oborri i shkollës fillore në fshatin Senoc dhe do të mbillen edhe aty drunjë dekorativ.
- Ka filluar ndërtimi i parkut në fshatin Gexhë dhe së shpejti do të përmbyllet edhe ky projekt.

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

- Është punuar busti për dëshmorin Mustafë Ibishi, të cilin do ta vendosim në oborrin e shkollës fillore në Kramovik, që mban emrin e këtij dëshmori. Është riparuar pllaka përkujtimore e dëshmorëve dhe martirëve në fshatin Potoqan i Poshtëm.
- Është ndërtuar muri mbrojtës në Qendrën Rinore në Rahovec, në të cilën është zgjeruar edhe trotuari në këtë pjesë, që do të shfrytëzohet nga qytetarët dhe nxënësit e dy shkollave të mesme në qytet.
- Është lidhur kontrata dhe kanë vazhduar punimet në renovimin dhe fasadimin e objektit kolektiv të banimit në rrugën Xhelal Hajda – Toni në Rahovec.
- Gjatë kësaj periudhe janë hartuar edhe projekte të reja në bazë të planifikimit të buxhetit për projektet investuese kapitale për vitin 2018. Janë hartuar projekte për drejtoritë tjera komunale nga kompania projektuese e kontraktuar nga Komuna e Rahovecit, si asfaltimi i rrugëve, objekteve shkollore dhe projekte për riparimin e tyre, projekti për shtegun e ecjes, projekti për renovimin dhe fasadimin e objekteve publike, projekti për sallën e sportit në Krushë të Madhe, projekti për kanalizimet në komunën Rahovecit dhe projekte tjera të investimeve kapitale.
- Është lidhur kontrata për mbikëqyrjen e projekteve kapitale në Komunën e Rahovecit, me të cilën kemi intensifikuar një mbikëqyrje shumë më efektive në përmirësimin e cilësisë së punimeve në projektet komunale.
- Kemi kërkuar nga ministria e linjës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me kërkesa për mbështetje financiare për disa projekte të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së mjedisit, si rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave në komunën e Rahovecit. Disa kërkesa tona janë përfshirë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2019.

Në kuadër të sektorit të mjedisit janë shqyrtuar kërkesat nga qytetarët për Leje Mjedisore Komunale si dhe janë kryer aktivitete të tjera rreth mbrojtjes së mjedisit.

- Gjatë kësaj periudhe, në këtë sektor janë lëshuar 54 Leje Mjedisore Komunale dhe janë realizuar të hyra në vlerë **7,737.90 €**.
- Poashtu, në kuadër të këtij sektori janë shënuar edhe disa aktivitete në fushën e mjedisit si: shënimi i ditës botërore të pyjeve, ditës botërore të ujit, ditës botërore të tokës dhe ditës botërore të mjedisit.
- Në bashkëpunim me Drejtorinë për Shërbime Publike janë identifikuar deponitë ilegale në të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit. Janë realizuar aktivitete të përbashkëta me drejtoritë tjera në pastrimin e deponive ilegale dhe aksione për pastrimin e ambientit.

## Të hyrat e përgjithshme gjatë vitit 2018

|                                        |             |
|----------------------------------------|-------------|
| Spektori i Urbanizmit dhe Planifikimit | 18,125.86 € |
| Spektori i Mjedisit                    | 7,737.90 €  |
| Totali i të hyraave                    | 25,863,76   |

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Fillimi i vitit të ri, ka filluar me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak. Prioriteti kryesor gjatë kësaj periudhe, ka qenë i fokusuar në shërbime cilësore në përputhje me afatet kohore dhe të unifikuara ligjërisht.

Në fillim të vitit 2018 janë riorganizuar të tre sektorët e drejtorisë për arsye të fluksit të madh të qytetarëve për nxjerrjen e fletave poseduese dhe kopje plani për aplikim për subvencione. Këtë sektor e kemi mbështetur edhe me staf plotësues dhe ishim në shërbim të qytetarëve në kohë reale. Qytetarët më nuk kishin nevojë që të presin me orë nëpër koridore, ashtu siç kanë pritur viteve të kaluara.

- Kemi përgatitur raport në lidhje me pronat e uzurpuara komunale në nivel Komune, ku janë mbi 230 prona.
- Jemi në proces të përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me evidentimin e pronave si ato komunale dhe ato private që janë vend rëniat e dëshmorëve të kombit, me qëllim që këto parcela t'i shpallim zona me interes të veçantë. Kjo mbetet sfida që të përfundohet deri në fund të vitit 2019.
- Kemi inqizuar gjendjen faktike të rrugës tranzite dhe kemi përgatitur elaborate të të gjitha pronave private për shpronësim. Gjithashtu, kemi mbajtur takimin e parë me të gjithë pronarët privatë, të cilët kufizohen me rrugën tranzite dhe pronarë, të cilëve u merret një pjesë e pronës për rrugën tranzite dhe e njejta është në procedurë të shpronësimit.
- Në muajt e parë të qeverisjes me zyrën e kryetarit kemi zgjidhur disa konteste pronësore.

Gjatë kësaj kohe nuk ka munguar edhe qasja ndaj detyrave të tjera, si në sektorin e gjeodezisë ashtu edhe në atë të kadastrës dhe pronës, ku vlen të përmenden:

- Propozim vendimet për seancat e Kuvendit Komunal
- Punët e gjeodezisë e inxhinierisë për nevojat e Kuvendit Komunal dhe palëve të tjera
- Matjet kadastrale për vërtetimin e uzurpimeve arbitrare
- Përgatitja e Aktvendimeve për uzurpimet arbitrare

Me propozim të Kryetarit të Komunës, drejtuar Kuvendit të Komunës, është bërë shpallja e interesit të përgjithshëm të pronave komunale:

- Prona komunale në Z.K. Kramovik, me qëllim të ngritjes së impiantit për pastrimin e ujërave të zeza.
- Prona komunale në Z.K. Krushë e Madhe me qëllim të ndërtimit të palestrës sportive.
- Prona private në Z.K. Ratkoc për këmbimin e pronës private me pronë komunale në interes të përgjithshëm, në raport një me një, për projektimin e fushës së sportit.

### Aktivitetet e drejtorisë gjatë këtij viti, ishin:

- Përgatitja e akteve ndaj uzurpatorëve si: Rahovec, Bërnjak, Vrajak etj.
- Dalja në terren e shërbimit pronësor-juridik, me kërkesë të drejtorisë për inspeksion,
- Dalja e gjeodetëve në terren për matjen e rrugëve: Rahovec-Tranzit, kemi kufizuar lumin – përroin, i cili kalon nëpër fshatrat Nagavc, Krushë e Madhe, Celinë dhe derdhjet në Drinin e Bardhë,

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

përgatitje e dokumentacionit për rrugën Krushë e Madhe – Randobravë, rruga Rahovec – Therandë, kufizimi i Zonës Ekonomike Z.K. Opterushë, kufizimi i 7 ha për kompleks sportiv në Z.K. Rahovec, kufizimi i lumit – prrocka niveleta në fshatin Celinë deri në Drinin e Bardhë.

- Kemi përgatitur dokumentacion detal në lidhje me të gjitha pronat në nivel komune, të cilat janë nën menaxhim të AKP-së dhe kemi kërkuar prej agjencionit të AKP-së që ta pezullojë procesin e privatizimit të këtyre pronave dhe gjithashtu kemi kërkuar prej Qeverisë së Republikës së Kosovës, që të marrë vendim dhe të na i kthejë këto prona në pronësi të komunës ku janë mbi 50 ha.
- Është kryer inventarizimi i dokumentacionit të arkivës dhe është përgatitur për skenim nga Agjencioni Kadastral i Kosovës.
- Kemi përgatitur dokumentacion të nevojshëm në lidhje me fillimin e procedurave ligjore për shpronësim të pronave private, siç është shtëpia e Masakrës në Krushë të Madhe dhe dy prona private në qytetin e Rahovecit për hapjen e rrugës.

## DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

### Aktivitetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike gjatë vitit 2018

- Është bërë ndërhyrje në rregullimin e rrugës me zhavorr në Polluzhë,
- Kemi rregulluar kanalin për ujëra atmosferike në Gexhë, si dhe zhbllokimin e ujërave fekale.
- Janë mirëmbajtur të gjitha rrugët e komunës sonë pas reshjeve të borës, periudha janar-shkurt 2018,
- Kemi bërë intervenime emergjente në disa segmente rrugore në disa prej vendbanimeve të komunës, sipas kërkesës së banorëve, si në fshatin Gur i Kuq; një në lumin Rimnik për të zhbllokuar kanalizimin fekal në Fortesë, pastrimin dhe heqjen e mbeturinave të ngurta në rrugën Rahovec - Krushë e Madhe te vendi i quajtur "Babindol", në fshatin Xërxë është bërë hapja e kanalit të ujërave të mbledhur, si dhe në rregullimin e një rruge me zhavorr, ndërhyrje në shkollën e Sapniqit, në fshatin Pataqan i Poshtëm, në dy segmente rrugore në fshatin Drenoc, hapja e rrugës Rahovec – Drenoc tek ura ku është bërë edhe pastrimi nga balta, rregullimi i rrugës në Pastasel etj.
- Janë bërë marrëveshjet e bashkëfinancimit nga Ministria e Infrastrukturës me komunën e Rahovecit për të investuar në disa projekte që kapin shifrën mbi 1.7 milion €.
  1. Rruga tranzite në Rahovec, Rruga Krushë e Madhe në drejtim të Randobravës,
  2. Rehabilitimi i rrugës Sapniq, Rahovec-Sarosh, Zatriq si dhe,
  3. Rrugë të tjera që janë në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës, si rruga Rahovec-Suhareke, ku janë kërkuar zgjerimet dhe trotualet tek varrezat e qytetit.
- Takime me pronarë të tokave ku kalon rruga qarkore. Nga viti 2013 ky projekt ka qenë pengesë për shkak të problemeve pronësore, prandaj janë identifikuar të gjithë pronarët e pronave kah kalon rruga dhe për të vazhduar më tutje me këtë projekt.
- Ka filluar të ndërtohet rruga (asfaltimi i rrugës) Krushë e Madhe - Randobravë, projekt që tashmë i plotëson të gjitha kriteret, i mbështetur financiarisht nga Ministria e Infrastrukturës, i cili përfundon në pranverën e vitit 2019,
- Projekti i ndërtimit të rrugëve në qytetin e Rahovecit, përfshin ndërtimin e 39 segmenteve rrugore, ku ndërtimi është bërë me elemente betoni (kubëza). Nga muaji prill 2018 janë ndërtuar 14 segmente rrugore dhe po ecim drejt fazës finale të përmbylljes së projektit.
- Gjatë muajit prill, janë evidentuar 47 deponi, dhe gjatë vitit janë hequr mbi 30 deponi ilegale,
- Është bërë asfaltimi i rreth-rrotullimit në rrugën Rahovec-Malishevë.
- Është caktuar lokacioni për hedhjen e mbeturinave inerte dhe atyre të demoluara.
- Është ndërtuar kanalizimi fekal në një lagje në Çifllak,
- Është funksionalizuar rrjeti dhe është përruruar uji i pijshëm për fshatrat Polluzhë dhe Guri i Kuq

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

- Ka filluar puna e mirëmbajtjes së hapësirave publike përmes punësimit sezonal sipas punëve të parapara për të mirëmbajtur ambientin. Me këtë rast 30 punëtorë sezonalë kanë punuar në afat prej 3 muajsh, projekt ky i mbështetur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Është përfunduar ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujerave të zeza në fshatin Kramovik, projekt i mbështetur nga UNDP. Kostoja e projektit është 100,000.00 €,
- Është dorëzuar elaborati për shpronësimin e pronave private për rrugën tranzite në Rahovec si dhe kërkesa për kategorizimin e kësaj rruge në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës për vlerësim.
- Po ashtu, ka nisur puna në meremetimin e rrugëve në 3 lloto, një për rregullim të pusetave dhe me asfalt, një të kubëzave dhe nivelizimit të pusetave, pastrim të rrugëve, zgjerim, prerje të shkurreve si dhe për muret mbrojtëse.
- Ka përfunduar asfaltimi në rrugën Drenoc-Zatriq,
- Janë ridërguar kërkesat për mbështetje financiare dhe kërkesat për planifikimin e ri të rrugëve, urave dhe trotuareve në Ministrinë e Infrastrukturës, si dhe kërkesa për zgjerim të rrugës Rahovec-Suharekë.
- Gjatë muajit shtator përveç ekipit të drejtorisë dhe stafit tjetër që janë marrë me të dhënat në sistemin PIP, jemi marrë edhe me përgatitjen e KAB-it komunal 2019-2021,
- Është përfunduar një segment rrugor në fshatin Malësi e Vogël,
- Prej datës 15 shtator, grupi punues i komunës së Rahovecit ka mbajtur takime dhe ka ndarë disa detyra, kemi filluar disa aksione për heqjen e mbeturinave në disa rrugë, kanë filluar edhe të behën përditësimet në web faqen e GIZ-it për heqjen e pikave të zeza.
- Është aprovuar rregullorja për shërbime publike.
- Ka përfunduar projekti i murit mbrojtës tek shkolla Isa Boletini,
- Është duke vazhduar projekti i rrugëve në Drenoc, Lagjia e Berishëve dhe rruga e varrezave,
- Ka fillu meremetimi i ndriçimit publik në disa fshatra dhe lagje të qytetit,
- Ka filluar projekti i ndërtimit të rrugës tranzite në Rahovec,
- Është përfunduar segmenti i parë i rrugës prej 2 km të ndriçimit publik në Xërxë,
- Kanë filluar të trajtohen disa rrugë që janë me prioritet të lartë si në qytet, edhe në fshatrat e komunës sonë, kemi filluar me ndërtimin e rrugës në Pastasel, Polluzhë, Xërxë, Rahovec, Zoqisht e në shumë vende tjera.
- Kanë filluar të trajtohen me kujdes ndërtimi i trotuareve në disa prej vendeve që janë prioritet i lartë, si në rrugën kryesore në Rahovec, Drenoc, Fortesë, Malësi të Vogël e shumë vendbanime të tjera.
- Ka filluar projekti i trajtimit të kanalizimit në komunën tonë dhe deri më tani janë përfshirë projekti më i madh që prin me qytetin e Rahovecit, pastaj edhe në 16 vendbanime tjera.
- 31 projekte infrastrukturore kanë qenë për vitin 2017-2018, ku nga këto 31 projekte në vazhdim, ndërsa 8 projekte janë të reja për vitin 2018.

## Drejtoria e shërbimeve publike, prioritet ka:

- Rrugët,
- Trotualet,
- Rrjetin e kanalizimeve,
- Ujin e pijshëm,
- Ndriçimin publik,
- Mirëmbajtjen e hapësirave publike,

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

- Mirëmbajtjen e rrugëve,
- Eficiencën e energjisë në të gjitha institucionet
- Mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese, pastrimi i varrezave, lapidareve, shesheve, parqeve dhe hapësirave tjera publike, kontrata e ndare ne tre kompani ne vlere prej, 54,000.00 euro
- Mirëmbajtjen e ndriçimit publik
- Mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror, sivjet për herë të parë do të jemi me të përgatitur, sepse operojmë në teren me dy kompani.

## Sfidat e drejtorisë së Shërbimeve Publike për vitin 2019 do të jenë:

- Kemi kërkesa të mëdha për rrugë lokale dhe për të përfunduar rrugë dytësore dhe të pa kategorizuara, ka me qindra kërkesa, por mundësitë buxhetore janë te limituara dhe si drejtori kemi pak mundësi për realizimin e tyre,
- Sfidë e vazhdueshme do të jetë edhe çështja e kanalizimeve dhe ujërave atmosferikë,
- Mirëmbajtja e përroskave dhe kanaleve që gjenden në vendbanime dhe në lagjet urbane,
- Kërkesa të vazhdueshme për ndriçim publik,
- Kërkesa të mëdha për ndërtim të trotuareve,
- Sfidë e radhës që vazhdimisht na ka percjellur gjatë vitit 2018 janë mbeturinat që hidhen kudo, vend dhe pa vend.

## DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Bujqësia dhe diversifikimi rural janë sektorë që ofrojnë mundësi reale për zbutjen e varfërisë, gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe për krijimin e të ardhurave për banorët e komunës së Rahovecit.

Komuna e Rahovecit përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

## Aktivitetet

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitete. Ndër më kryesoret do të paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Pranim i aplikacioneve për subvencionim të qumështit – MBPZHR hap thirrjen në baza 3 mujore, Drejtoria e BPZHR-se pranon aplikacionet dhe te njëjtat i dorëzon ne Ministri per pagesë.
- Analizimi i projekteve të vjetra ( të trashëguara ) të cilat nuk janë përfunduar, dalje në terren së bashku me inxhinierët e Komunës, ku janë përpiluar raporte dhe janë nxjerr përfundime lidhur me këto projekte.
- Pranimi dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

- DBPZHR ka ndërmarr masat dhe është përgatitur me kohë për hapjen e thirrjeve nga MBPZHR për pagesa direkte (jemi kujdesur që të furnizohemi me material administrativ për të përballuar fluksin e madh të fermerëve),
- Poashtu jemi përgatitur dhe kanë përfunduar me kohë procedurat për rritje të stafit në drejtori për pagesa direkte (janë pranuar 5 zyrtarë të rinj me kontratë për punë specifike si dhe dy të tjerë nga drejtoritë e tjera),
- Me 15 shkurt ka filluar faza e aplikimit të pagesave direkte (ky proces është zhvilluar me mjaft sukses, falë përkushtimit të zyrtarëve në DBPZHR),
- Janë plotësuar procedurat për plotësimin e vendit të lirë të punës në pozitën “Roje Pylli” (është pranuar një punëtor në sektorin e pylltarisë), i janë dhënë detyrat dhe i është përcaktuar terreni në të cilin do të operojë,
- Në bashkëpunim me Qendrën Grumbulluese “Agrocelina” është organizuar takim me fermerë të fshatit Ratkoc dhe fshatit Krushë e Madhe, në këto takime është paraqitur planifikimi i QG “Agrocelina” për vitin 2018 dhe u është prezantuar fermerëve në mënyrë që të lidhen kontratat me këto qendra grumbulluese. Si rezultat i këtyre takimeve QG Agrocelina ka rritur te eksportoj me sukses prodhimet bujqësore të komunës sonë.
- Dita Ndërkombëtare Pyjeve - Në bashkëpunim me Asociacionin e Pronarëve Privat të Pyjeve është organizuar Dita Ndërkombëtare e Pyjeve, janë siguruar 1,000 fidane për komunën e Rahovecit të cilat janë mbjellur në lokacione të ndryshme,
- Në bashkëpunim me drejtorinë për Urbanizëm është shënuar “Dita e Tokës” janë zhvilluar një sërë aktivitetesh lidhur me këtë eveniment
- Janë projektuar dhe është plotësuar dokumentacioni për aplikim të granteve të projekteve me bashkëfinancim (GLV) dhe janë dorëzuar në MBPZHR,  
Si rezultat i këtij aplikimi Komuna e Rahovecit ka arritur te jetë përfituese e 3 projekteve
  1. Varrezat e dëshmorëve dhe platoja në fshatin Nagac,
  2. Rrethimi i hapësirës në zonën turistike, në magjistralen Rahovec-Malishevë,
  3. Ulëse të parqeve nëpër qytet dhe fshatra.
- Janë organizuar dy trajnime për fermerë, njëri në sektorin e Blegtorisë dhe tjetri në atë të Bletarisë në kuadër të shërbimeve këshillimore,
- Formim i komisionit për vlerësim të dëmeve në bujqësi, në kuadër të këtij komisioni janë formuar tre grupe punuese dhe vazhdimisht për rreth 10 ditë zyrtarët kanë qenë në terren duke kontrolluar çdo parcelë dhe duke grumbulluar shënime lidhur me dëmet e shkaktuara nga breshëri dhe vërshimet,
- Pas përfundimit të vizitave në terren ka filluar faza e grumbullimit dhe analizimi i të dhënave për dëmet e shkaktuara, ku është përpiluar edhe raporti për dëmet nga breshëri dhe vërshimet,
- Kërkesë dhe takim me Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vizitë Komunës sonë dhe zonave të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore.

Padyshim se muaji mars dhe prill kanë qenë muaj me vëllim më të shtuar të punëve, pasi mbi 3,000 fermerë kanë kryer fazën e aplikimit dhe për secilin është dashur të kryhet digjitalizimi i parcelave.

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

Tabela 1. Lista me të dhënat për pagesa direkte – subvencione

| Nr. | Lloji i kulturës   | Sasia          | Njësia    | Kultura         |
|-----|--------------------|----------------|-----------|-----------------|
| 1   | Grurë              | 1600.94        | Ha        | Drithëra        |
| 2   | Misër              | 1245.82        | Ha        | Drithëra        |
| 3   | Elb                | 12.7           | Ha        | Drithëra        |
|     | <b>Gjithsej</b>    | <b>2859.46</b> | <b>Ha</b> | <b>Drithëra</b> |
| 4   | <b>Vreshta</b>     | <b>2509.33</b> | <b>Ha</b> | <b>Vreshta</b>  |
| 5   | Specë              | 723.76         | Ha        | Perime          |
| 6   | Domate             | 12.33          | Ha        | Perime          |
| 7   | Qepë               | 159.28         | Ha        | Perime          |
| 8   | Hudhër             | 43.78          | Ha        | Perime          |
| 9   | Patate             | 194.9          | Ha        | Perime          |
| 10  | Tranguj            | 93.1           | Ha        | Perime          |
| 11  | Karota             | 19.03          | Ha        | Perime          |
| 12  | Rrepkë             | 2.84           | Ha        | Perime          |
| 13  | Lakër              | 56.85          | Ha        | Perime          |
| 14  | Lulelakër          | 3.77           | Ha        | Perime          |
| 16  | Presh              | 3.5            | Ha        | Perime          |
|     | <b>Gjithsej</b>    | <b>1313.14</b> | <b>Ha</b> | <b>Perime</b>   |
| 17  | Shalqinj           | 174.08         | Ha        | Shalqinj        |
| 18  | Pjepër             | 57.67          | Ha        | Pjepër          |
| 19  | Kunguj             | 305.06         | Ha        | Kungullore      |
|     | <b>Gjithsej</b>    | <b>536.81</b>  | <b>Ha</b> | <b>Perime</b>   |
| 21  | Dardhë             | 1.2            | Ha        | Pemë            |
| 22  | Dredhëz            | 4.99           | Ha        | Pemë            |
| 23  | Kumbull            | 34.74          | Ha        | Pemë            |
| 25  | Mollë              | 11.61          | Ha        | Pemë            |
| 26  | Arra               | 2.48           | Ha        | Pemë            |
|     | <b>Gjithsej</b>    | <b>55.02</b>   | <b>Ha</b> | <b>Pemë</b>     |
| 27  | Fidane të hardhisë | 146000         | copë      | Fidane          |
| 28  | Bletë              | 5960           | shoqëri   | Bletë           |
| 29  | Lopë               | 1929           | krerë     | Bagëti          |
| 30  | Dhi                | 342            | krerë     | Bagëti          |
| 31  | Dele               | 9613           | krerë     | Bagëti          |
| 32  | Pula vojëse        | 61400          | copë      | Shpezëtari      |

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## Projektet e investimeve kapitale

Gjatë këtij viti janë implementuar këto projekte:

- Ndërtimi i Serave me Participim – Pas mbylljes së thirrjes për aplikim dhe formimit të komisionit janë shpallur rezultatet e përfitueseve. Për dallim nga vitet e mëparshme kemi paraqitur dy ndryshime në të mirë të fermerëve
  1. Participimi është ulur nga 25% në 20% nga fermeret, dhe
  2. Rritja e sipërfaqes në tre lloje, 1.5 ari, 3 ari dhe 5 ari  
Gjithsej përfitues në kontratën e lidhur për vitin 2018 janë 117 ( 60 copë x1.5 ari, 53 copë x 3 ari dhe 16 copë x 5 ari).
- Me ndryshimet që i janë bërë projektit “ Ulja e Niveletës së përroit në fshatin Celin” ka filluar ndërtimi i këtij kanali i cili njëherë e përgjithmonë eleminon problemin e fermerëve, ku për cdo vit tokat e tyre vërshoheshin nga dalja prej shtratit e këtij përroi. Ky projekt kap vlerën 178,068€ dhe trajton 1,237m kanal të hapur. Projekti pritet të përfundojë në pranverën e vitit 2019
- “Ndërtimi i infrastrukturës për festivalin dhe tregun e rrushit” pa dyshim që është njëri ndër projektet me rëndësi të madhe për sektorin e bujqësisë së Komunës sonë. Kanë vazhduar punimet sipas projektit, ne kemi rritur buxhetin për vitin 2018 në mënyrë që të përfundohet i tërë projekti, duke u nisur nga fakti se nëse këtë lokacion gjatë 3 netëve të Festës së vjeljes së rrushit frekuentohet nga më shumëse 60 mijë vizitorë si nga vendi ashtu edhe ndërkombëtar.
- Kanali i kullimit të tokave Bujqësore në fshatrat Xërxë-Fortesë” Edhe ky projekt ka pësuar ndryshime në të mirë të qytetarëve të Komunës sonë e konkretisht banorëve të fshatit Xërxë, pasi është shtuar edhe një segment prej 850m që do të trajtojë ujërat atmosferik bashkë me projektin ekzistues prej 1,635m. Ne kemi shtyer këtë projekt me të vetmin qëllim që tokat e punës përball Ndërmarrjes Sillosi që i kemi parë të vërshuara tani e 20 vite do të kullohen në kanali e hapur që po e ndërton Komuna e Rahovecit.
- Kanali i Kullimit të tokave bujqësore në fshatrat: Ratkoc, Malësi e Vogël dhe Gexhë – ky projekt i harruar për më shumë se 4 vite ka rifilluar të implementohet. Me ridestinimin që ka ndodhur në muajin tetor, janë ndarë mjete dhe kanë filluar punimet.
- Punimet në projektin “ Pastrim i përrrenjve në komunën e Rahovecit” ky projekt ka qenë në vazhdim është vazhduar me dy pozicione të mbetura dhe është përfunduar.

Poashtu kemi mbajtur raporte të mira me organizatat që operojnë në Kosovë në sektorin e bujqësisë, vlen të përmendet se kemi nënshkruar edhe memorandume të bashkëpunimit.

Një i tillë është me organizatën IADK, ku qysh në këtë vit, nga Komuna e Rahovecit kanë arritur të përfitojnë 5 fermer në sektorin e “Bimëve Mjekësore Aromatike”

Memorandumi tjetër i nënshkruar me këtë organizatë do të trajtojë qështjen e të Riatdhesuarve që fokus e kanë sektorin e bujqësisë. Nga ky projekt do të përfitojnë 105 fermerë dhe ne do të qëndrojmë shumë afër tyre.

Me 7,8 dhe 9 shtator është organizuar “Festa e Vjeljes së Rrushit” Ku DBPZHR ka qenë bartëse e këtij aktiviteti. Në bazë të matjeve të organizatave të ndryshme ky ka qenë vit rekord për nga numri i vizitorëve, e poashtu nga kritikët është vlerësuar ndër vitet më të suksesshme rreth organizimit.

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

Poashtu pjesë aktive e festës së perimeve në Krushë të Madhe “ Agro-festa” edhe përkundër faktit që ky vit nuk ka qenë më i miri për sektorin e perimekulturës, përshkak të kushteve të pa-volitshme klimatike që mbretëruan këtë vit në vendin tonë.

Një situatë e cila pritet që të i jepet zgjidhje gjatë vitit 2019 është “ Menaxhimi i Vendgjahishtës – Dafina”. Ka zhvillime pozitive për këtë temë, e cila llogaritet ndër më të vështirat dhe do të konsiderohet sfidë e vitit të ardhshëm.

Assesi nuk mund të mos paraqitet në këtë raport përmbledhës pika kryesore në vitin 2018, e që për shumë skeptikë dhe pesimistë ka qenë e pamundur, planifikimi dhe ndarja e buxhetit për investime kapitale në vitin 2019 të arrijë në 1 milionë euro. Kjo shifër tanimë është aprovuar nga Kuvendi Komunal dhe Ministria e Financave, ku Drejtoria e BPZHR-së për vitin 2019 do të ketë buxhet: **1,028,000€**

## DREJTORIA PËR PUNËT INSPEKTUESE

Gjatë vitit 2018, drejtoria për punët inspektuese, ka planifikuar të realizojë detyrat e punës sipas planit të punës.

Qellim i këtij planifikimi është mbrojtja sa me efikase e interesave të qytetareve të komunës së Rahovecit, në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit si: institucionet shtetërore, organet komunale, komuniteti i biznesit, qytetarët.

## Drejtori i drejtorisë

- Ka menaxhuar punët e drejtorisë për punë inspektuese
- Është kujdesur për mbarëvajtjen e punëve brenda drejtorisë në përgjithësi dhe sipas sektorëve në veçanti;
- Ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me Kryetarin e KK Rahovec;
- Ka marrë pjesë në takimet e Qeverisë Komunale;
- Ka mbajtur takime të rregullta javore dhe periodike me inspektorët;
- Ka përgatitur raportet mujore të punës për vitin 2018.
- Ka përgatitur planin e punës për vitin 2018.

## Tabelari i punës për inspektorë

Janar - Dhjetor / 2018

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

| Nr. | Inspektori<br>emri & mbiemri | inspektimet<br>të planifikuara | procesverbale<br>të realizuara    | Aktvedimet  | fletparaqitjet | denim<br>mandator   | njoftimet<br>kërkesat<br>raporte | ftesat<br>kërkesat<br>konkluzat | fletparaqitjet<br>të ekzekutuara<br>nr. i fletp.&shuma | tërheqja e<br>lëndve | pushim<br>vjetor<br>ditë:     | puna jasht<br>orarit |
|-----|------------------------------|--------------------------------|-----------------------------------|-------------|----------------|---------------------|----------------------------------|---------------------------------|--------------------------------------------------------|----------------------|-------------------------------|----------------------|
|     | Nezir Thaqi                  | 378                            | 425                               | 27          | 6              | 0                   | 20                               | ftesat- 00                      | 0                                                      | 0                    | 28 push. V.<br>3ditë p.mj.    | 0                    |
| 2   | Hasan Eminazeri              | Ndërtim 211<br>Kom. 211        | Ndërtim 494<br>Komunik. 323       | 72<br>0     | 43<br>1        | 2<br>0              | 20<br>0                          | 0<br>0                          | 16+1vlëra 13315<br>1 vlëra 100 e                       | 0                    | 5 push. Vj.<br>vitit parap.   | 1<br>0               |
| 3   | Fehmi Shehu                  | 449                            | procesv.- 772<br>insp.-           | 0           | 0              | 0                   | 153                              | 0                               | konfisk- vlëra-<br>622.83euro                          | 0                    | 37 push vjet.<br>3.d.pu.mjek  |                      |
| 4   | Mehdi Shehu                  | 488                            | 434<br>insp.-                     | 2           | 0              | 0                   | 0                                | p.pune- 72<br>p. sanit. 6       | 0                                                      | 0                    | 27 push. Vj.<br>këtij viti    | 5. ditë              |
| 5   | Milazim Elshani              | 336                            | 294<br>insp.                      | 2           | 4              | 0                   | 5                                | 0                               | 1                                                      | 0                    | 13.push. Vj.<br>22. push. mj  |                      |
| 6   | Masar Vuqitërna              | 442                            | 374                               | 21          | 6              | 0                   | 1                                | 0                               | 0                                                      | 0                    | 12.push. Vj.                  | 2 ditë               |
| 7   | Metush Isma                  | 455                            | ambientit-225<br>pylltarisë - 221 | 56          | 29             | 9                   | 34                               | 0                               | 1-220euro                                              | 0                    | 16.push. Vj.<br>5 p.mjeksor   |                      |
| 8   | Valon Hoti                   | 405                            | 397<br>proc.pun. 62               | 11          | 0              | 0                   | 3                                | 0                               | 0                                                      | 0                    | 17 push. Vje<br>3. pu. Lindje | 5 ditë               |
| 9   | Shaqir Berisha               | 346                            | 384<br>insp. 13                   | 32          | 3              | 0                   | 0                                | 3                               | vlëra 300 euro<br>vklë. konfis.230e                    | 0                    | 16.push. Vj.                  | 0                    |
| 10  | Sherafedin Shehu             | 331                            | 348<br>pel.pune24                 | 14          | 1              | 0                   | 24                               | 2                               | 0                                                      | 0                    | 5 push. Vjet.                 | 2                    |
| 11  | Sabahajdin Qeska             | 438                            | 576                               | 172         | 33             | mall.konf<br>924 kg | 13                               | 0                               | 8 lënd të ekzek.<br>vlëra: 440.00Eu                    | 1                    | 21 push. Vje                  | 8. ditë              |
|     | gjithsej:                    | insp. Pl. 4490                 | procesv.:5342                     | Aktiv.: 425 | fletparaq.:132 | dën.man.11          | Nj.Kër.:273                      | Ftesë: 83                       | vlëra tot.15227.83e                                    | 1                    | ditë:233                      | ditë 23              |

## Rezultatet e inspektorëve për fushat e caktuara

### Inspektori Veterinar

- Në periudhën njëvjeçare të inspektimeve të rregullta janë konfiskuar dhe asgjësuar : 170.70 kg ushqim (produkte ushqimore me prejardhje shtazore) në vlerë prej 622.83 Eur
- Janë therur 86 krerë gjedhe, lëshuar 86 Certifikata të therjes
- Janë marrë: 4 mostra dhe 7 strisho për analiza në bashkëpunim me inspektorët regional si dhe monitorimi i fermave
- Është mbajtur seminar 7 ditor në lëmin e veterinarisë
- Janë kryer disa inspektime të përbashkëta me inspektorin regional veterinarë nëpër Thertore të Licencuara në territorin e komunës së Rahovecit lidhur me nivelin e kushteve higjienike dhe mbajtjes së librave të regjistrimit të therjeve të gjedheve, mbajtja e evidencës dhe raportimet e therjeve në AUV-së,
- Me kërkesë të kompanisë EURO-IDA e të AUV-s janë Asgjësuar 7.650 kg mish MDM me afat të skaduar në vlerë 4960 euro.
- Sipas kërkesës janë kryer 3 inspektime me polici, me leje të Prokurorit në 3 lokacione shtëpi private me rastin e therjeve ilegale
- Është përcjellë kapja e qenve endacakë, trajtimin dhe eliminimin e tyre Eutanzion, ku gjithsej janë eliminuar 52 Qenë e hedhur në Gropë septike.
- Bletarët pa Leje të KK-Rahovec janë larguar nga territori i komunës së Rahovecit

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## Inspektori Sanitar

- Me IKSHPK-së ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm në lëmin e Sanitarisë.
- Është kryer Inspektimi i artikujve ushqimor me rastin e festës në Pataqan të Ulët dhe Denjë si dhe festivalit të muzikës e folklorit në Dejnë,
- Në këtë periudhë ka pasur gjithsej **273 kërkesa** të ndryshme që kanë kërkuar zgjidhje dhe të njëjtat kryesisht janë të zgjidhura nga inspektorët përkatës të lëmive të ndryshme.
- Kemi mbyllur perkohësisht objektin e postës në Krushë të Madhe, objekt i cili nuk i ka përmbushur as për së afërmi kushtet higjieniko sanitare.

## Inspektorët e Tregut

- Kanë kryer aksionet e kontrollit të furrave të bukës,
- Kontrollin e subjekteve afariste të pa regjistruara në MTI-së si dhe i kanë obliguar të pajisen me pëlqime pune për ushtrim të veprimtarisë,
- Kanë marr pjesë në Trajnime-Seminare të organizuara nga MTI-ja
- Gjatë këtij viti Inspektorët e Tregut kanë punuar edhe jashtë orarit të punës në inspektime të jashtëzakonshme,
- Kanë zbatuar urdhëresën e MTI për ndalesën e shitjes së alkoolit dhe cigareve për personat nën moshën 18 vjeçare,
- Kanë zbatuar urdhëresën për largimin e të gjitha atyre produkteve që kanë banderola fyese me mbishkrimet si: Kosova Metohi, Kosovo Unmik, rezoluta 1244 etj.

## Inspektorët e Ndërtimit

- Kanë kryer inspektime nëpër objekte ndërtimore me Leje ndërtimore dhe ato pa leje ndërtimore, ku pronarët e objekteve janë obliguar që të pajisen me leje përkatëse,
- Kanë inspektuar objekte të perkohshme në territorin e Komunës Rahovec, rrugët dhe trotualet, kanalizime, vendosjen e ormane dhe rrjetit nga ana e KEDS-sit,
- Rrënimi i objekteve pa leje dhe objekteve të vjetra në komunën e Rahovecit,
- Rrënimi i objektit të shkollës Mustafë Ibishi në fshatin Kramovik
- Rrënimi i objektit të ish shkollës së mesme dhe objekti i zjarrëfiksive në fshatin Ratkoc
- Rrënimi i ish stacionit të policisë në Ratkoc
- Rrënimi i objektit të shkollës së vjetër në fshatin Opterushë
- Rrënimi i objektit me rrezikshmëri të lartë në fshatin Zoqisht

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pylltarisë

- Ka kryer inspektime në subjektet afariste dhe i ka obliguar në lidhjen e kontratave për grumbullim të mbeturinave me kompanitë e "AMBIENTIT" dhe "EKO Drinia"
- Ka mbajtur nën vëzhgim vendin ku hidhen mbeturina të ngurta dhe në tërë komunën tonë
- Ka shqiptuar 11 dënime mandatore

## Inspektori i Bujqësisë

- Ka pasur inspektime në tokat bujqësore ku bëhet ndërtimi i objekteve ndërtimore afariste dhe banuese,
- Ka qenë i angazhuar në komisionin për Korrje- Shirje
- Me drejtorinë e bujqësisë kemi pasur bashkëpunim të mirë

## Inspektori i Komunikacionit

- Ka pasur kërkesa për vazhdim të pëlqimeve të punës së Auto Taksive, që veprojnë në komunën tonë.
- Ka bërë kontroll të vazhdueshëm të transportit të udhëtareve në transportin urban dhe ndër urban (Linja të Autobusëve edhe Kombibusëve),
- Ka punuar në projektin Sinjalizimi Vertikal dhe Horizontal i rrugëve në komunën tonë ku në 95% të rrugëve të qytetit janë shtruar zebrat për herë të parë në dy komponente, në të kuqe dhe të bardhë,
- Janë vendosur pasqyra dhe pengesa në rrugë varësisht nga kërkesat e qytetarëve, po ashtu edhe vija e bardhë në qytet.

## Inspektori i çështjeve komunale

- Ka qenë i angazhuar në kontrollin e shfrytëzimit të të gjitha sipërfaqeve publike në territorin e komunës, kanalizimet (bllokimi dhe zhblokimi i tyre, rrjedhat e ujërave të zeza në sipërfaqe publike, prerja e asfaltit-groposjet e rrugëve pa leje, mirëmbajtja dhe larja e Rrugëve të Qytetit, etj) .
- Mall i konfiskuar 924 kg nga aksioni për lirim të trotuareve me asistencën e policisë.

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Personeli i DKRS-së ka qenë i angazhuar që të gjitha aktivitetet të përmbushen me sukses. Në raport të punës janë të përfshira të gjitha aktivitetet të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.

Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe është realizuar me sukses në disa prej aktiviteteve të gjatë vitit 2018.

### Aktivitetet

- Është realizuar takimi me sportdashës dhe udhëheqësit e kaluar të klubit të futbollit “Rahoveci” ku është bërë zgjedhja e kryesisë së përkohshme të klubit, pas një krize të gjatë që e ka përcjellë këtë klub.
- Thirrja publike në konkursin e artit letrar dhe pamor, për nder të manifestimit përkujtimor dhe kulturor “Flaka e Janarit”.
- Përgatitjet e manifestimit tradicional “Flaka e Janarit 2018” .
- Vlerësimi i punimeve letrare – artistike të Flakës së Janarit 2018.
- Manifestimi “Flaka e Janarit” u mbajt në kushte optimale dhe të gjitha përgatitjet ishin në nivel.
- Shqyrtimi i aplikacioneve të OJQ- ve kulturore, sportive dhe rinore. Aplikacione të pranuar dhe të shqyrtuara ishin 36.
- Përgatitjet për festën tradicionale të vjeljes së rrushit “HardhFest
- Shfaqja e filmave vizatimor në Shtëpinë e Kulturës në Qytet, ka rezultuar me sukses, me rreth 300 fëmijë në qytet. Në Shtëpinë e Kulturës në Ratkoc, rreth 150 fëmijë, ndërsa në Krushë të Madhe rreth 60 fëmijë.
- Më 28 nëntor 2018, shënimi i rikthimit të Skënderbeut në Krujë, Dita e Flamurit, dalja e UÇK-së, ditëlindja e Adem Jasharit,
- Organizimi i Tryezës shkencore për Skënderbeun dhe ditëlindjen e shkrimtarit Sulejman Krasniqi
- Shpallja e sportistit më të mirë të vitit.

# RAPORTI VJETOR I PUNËS TË KRYETARIT TË KOMUNËS

## DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Gjatë kësaj periudhe kohore në këtë drejtori drejtori janë zhvilluar aktivitete si më poshtë:

- Zhvillimi i aktiviteteve propagandistike në edukimin dhe vetëdijimin e popullatës për Zjarret Malore- Fushore. (Konform Planit të punës së Drejtorisë)
- Kemi aplikuar në zyrën japoneze në Prishtinë për donacion për blerjen e një kamioni të zjarrfikësve dhe jemi në pritje të përgjigjes nga ana e tyre.
- Dalja në terren, ku është bërë identifikimi i lokacioneve të cilat mund të jenë të rrezikuara nga vërshimet në komunën e Rahovecit. (Konform Planit të punës së Drejtorisë)
- Kemi pritur në takim zjarrfikësat nga Franca përkatësisht nga Saone et Loire. Në këtë takim kemi marrë konfirmimin se kemi fituar donacion nga ta një(1) kamion të zjarrfikësve me të gjitha mjetet tjera përcjellëse të kamionit, si dhe një(1) kombi për transportimin e zjarrfikësve. Ky donacion po ashtu përfshin edhe uniforma të kompletuara të zjarrfikësve dhe planifikohet që në fund të këtij viti ose eventalisht në fillim të vitit 2019 të arrijë donacioni.
- Është bërë servisimi i të gjitha Aparateve për shuarjen e zjarreve.
- Kemi blerë uniforma dhe mjete të punës për stafin e zjarrfikësve.
- Ka filluar ndërtimi i garazhës mbrapa objektit aktual të zjarrfikësve. Ky aneks objekt po ndërtohet me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës së nevojshme për zjarrfikësit dhe që ata të jenë sa më të kompletuar në çdo aspekt.
- Inspektimi i rregullt i objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve.
- Pjesë e shtabit të krizës të formuar nga kryetari i komunës për shkak të situatës emergjente të krijuar si pasojë e reshjeve të rrëmbyeshme të shiut dhe breshërit prej datës 14.06-16.06.2018

| Viti    | Zjarre në objekte private |               |                   |                   |        |           |                    | Zjarre në objekte eko. |                 |                     |                | Zjarre në pajisje |                    |             |          | Zjarre në sipërfaqe |             |                     |          | Zjarr në Auto       | Gjith.             |     |
|---------|---------------------------|---------------|-------------------|-------------------|--------|-----------|--------------------|------------------------|-----------------|---------------------|----------------|-------------------|--------------------|-------------|----------|---------------------|-------------|---------------------|----------|---------------------|--------------------|-----|
| Muaji   |                           |               |                   |                   |        |           |                    |                        |                 |                     |                |                   |                    |             |          |                     |             |                     |          |                     |                    |     |
| 2018    | Banesa / shtëpi           | Objektë kumse | Plevica - Shtalla | Objekte kolektive | Oxhaqe | Mbeturina | Zjarre të rrejshme | Publike                | Objekte Biznesi | Objekte industriale | ushqim bagtije | Pajisje elektrike | Paisjetshpërndarse | Gjeneratora | Sherbime | Mali                | Bari i that | Sipërfaqe bujqësore | Vershime | Intervenime Teknike | Automjete Motorike |     |
| Janar   | 2                         |               |                   |                   |        |           |                    |                        |                 |                     |                | 1                 |                    |             |          |                     |             |                     |          |                     | 1                  | 4   |
| Shkurt  | 1                         |               | 1                 |                   | 1      | 1         |                    |                        |                 |                     |                |                   |                    |             |          |                     |             |                     | 6        | 2                   | 1                  | 7   |
| Mars    |                           |               |                   |                   |        |           |                    |                        |                 |                     |                |                   |                    |             |          |                     |             |                     |          |                     |                    | 6   |
| Prill   | 2                         |               |                   |                   |        | 1         | 1                  |                        |                 |                     |                |                   |                    |             |          | 2                   |             |                     |          | 2                   | 1                  | 9   |
| Maj     |                           |               |                   |                   |        | 1         |                    |                        |                 |                     |                |                   |                    |             |          |                     | 1           |                     | 1        | 7                   |                    | 10  |
| Qershor | 1                         |               |                   |                   |        | 3         |                    |                        |                 |                     |                |                   |                    |             |          | 1                   | 1           |                     | 15       | 3                   |                    | 24  |
| Korrik  |                           |               |                   |                   | 1      | 1         |                    |                        |                 |                     |                |                   |                    |             |          |                     | 1           |                     | 1        | 2                   |                    | 6   |
| Gusht   | 1                         |               |                   |                   |        | 1         |                    | 1                      |                 |                     |                |                   |                    |             |          |                     | 1           |                     | 2        | 6                   |                    | 12  |
| Shtator | 1                         |               | 1                 |                   |        | 2         |                    |                        |                 |                     |                |                   |                    |             |          | 5                   | 9           |                     | 1        | 1                   |                    | 20  |
| Tetor   |                           |               |                   |                   |        | 4         | 2                  |                        |                 |                     |                |                   |                    |             |          | 4                   | 19          |                     |          | 2                   |                    | 31  |
| Nëntor  | 1                         |               |                   |                   |        | 1         |                    |                        | 1               | 1                   |                |                   |                    |             |          |                     | 2           |                     |          | 1                   |                    | 7   |
| Dhjetor | 1                         | 0             | 1                 | 0                 | 1      | 3         | 1                  |                        |                 |                     |                | 2                 |                    |             |          | 1                   |             |                     |          | 2                   | 1                  | 13  |
| Total   | 10                        | 0             | 2                 | 0                 | 2      | 18        | 3                  | 1                      | 1               | 1                   | 0              | 1                 | 0                  | 0           | 0        | 12                  | 34          | 0                   | 26       | 28                  | 3                  | 149 |

## PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese. Dihet se planifikimi i buxhetit ishte bërë nga qeveria e kaluar. Ne e realizuam në përpikëri si dhe arritëm që të kemi ndryshime thelbësore në të mirë të qytetarëve të komunës sonë.

Padyshim se viti 2018 ishte vit i vështirë sidomos për sektorin e bujqësisë pasi jemi përballur me fatëkeqësi natyrore prej më të ndryshmeve, por ne jemi munduar që bashkërisht ta përballojmë situatën e krijuar.

Një bashkëpunim i mirë ka ndodhur edhe me nivelin qendror, sepse si rezultat i këtij bashkëpunimi kanë arritur të gjejnë zgjidhje shumë tema si: Palestra e sporteve në qytet, Zona Ekonomike në Opterushë, Zona turistike e shumë probleme të tjera me rëndësi për komunën tonë.

Kontakti me qytetarët dhe me grupet e interesit për të trajtuar dhe zgjidhur së bashku kërkesa, nevoja dhe interesa të tyre, ka qenë i përhershëm.

Raportet e mira me OJQ-të, por dhe me organizatat mbikëqyrëse, na kanë ndihmuar shumë.

Kemi kultivuar dhe promovuar raporte funksionale të komunikimit dhe bashkëpunimit me institucionet vendimmarrëse, si Kuvendi Komunal, poashtu, policinë e Kosovës si dhe me mekanizmat lokal e qendror, me të gjithë ata që fushëveprim të tyre kanë ligjshmërinë, transparencën, llogaridhënien, konsolidimin e vazhdueshëm demokratik të qeverisjes lokale, e që secili nga ta kanë peshën e vet të madhe për mbarëvajtjen dhe ecurinë normale të proceseve në komunën tonë.

Raporti i punës për vitin 2018 është dëshmi e respektit ndaj ligjit mbi vetëqeverisjen lokale dhe i dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.

Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë përditë e më mirë punën tonë.

14.01.2019  
ahovec

